

HEJZA

Berat DAKAJ

PROPAGANDA DHE LETËRSIA, MOTRA

SFIDA E KRIJIMIT

Çdo shkrimtar që krijon është një gënjeshtar, letërsia është gënjeshtëri; por nga kjo gënjeshtëri del një rikrijim i realitetit; por, rikrijimi i realitetit është një nga parimet themelore të krijimit



Juan RULFO

Për fat të keq, mua nuk pati kush të më rrëfente tregime; në fshatin tonë njerëzit janë të mbyllur, vërtet, plotësisht të mbyllur, secili është si një huaj aty. Gjithsesi, ata flasin mbrëmjeve, të ulur mbi trastat e tyre dhe tregojnë histori apo këso gjërash; por, me të mbërritur dikush, e mbyllin gojën ose fillojnë e flasin për motin: "Sot duket se do prishet koha, ja tek po mblidhen retë..." Kështu që, unë nuk e pata atë fat për të dëgjuar më të mëdhenjtë, duke treguar histori; prandaj kam qenë i detyruar t'i sajoj vetë dhe besoj se, pikërisht, një nga parimet e krijimit letrar është sajesa, imagjinata. Jemi gënjeshtarë; çdo shkrimtar që krijon është një gënjeshtar, letërsia është gënjeshtëri; por nga kjo gënjeshtëri del një rikrijim i realitetit; por, rikrijimi i realitetit është një nga parimet themelore të krijimit.

Konsideroj se janë tre hapa: së pari, të krijosh personazhin; së dyti, të krijosh ambientin ku personazhi do të lëvizë e do të veprojë; dhe së treti, është se si ky personazh do të flasë, do të shprehë. Këto tri pika janë gjithçka kërkohet për të treguar një histori: tani unë e kam tmerr fletën e bardhë dhe, mbi të gjitha, lapsin, sepse unë shkruaj me dorë; por, pak a shumë, dua të them se kjo është procedura ime në këtë punë, në një formë shumë perso-

nale. Unë, kur filloj të shkruaj, nuk besoj te frymëzimi, asnjëherë nuk kam krijuar me frymëzim, çështja e të shkruarit është çështje pune; të vihesh për të shkruar, pa lëre çfarë do dalë dhe të mbushësh faqe e faqe, derisa papritur të duket një fjalë, e cila na jep çelësin për atë që duhet bërë, se si duhet të jetë krijimi. Nganjëherë, ndodh që shkruaj pesë, gjashtë apo dhjetë faqe dhe nuk shfaqet personazhi që unë dua, ai personazh i gjallë që duhet të lëvizë vetvetiu. Por, papritur, shfaqet, del dhe, atëherë, unë shkrimtari shkoj pas tij, e ndjek. Ndërkohë që personazhi merr jetë, shkrimtari mund të shkojë, përmes rrugësh që nuk i njeh, por që, duke qenë i gjallë, drejt një realiteti, ose një irliteti, atje ku duhet. Në të njëjtën kohë, arrihet të krijohet ajo që mund të thuhet, gjë që, në fund të fundit, duket se ka ndodhur, që mund të ketë ndodhur ose që mundi të ndodhë, por që kurrë nuk ka ndodhur. Kështu që unë mendoj se, në çështjen e krijimit, themelore është të mendosh se çfarë di krijuesi, çfarë gënjeshtresh do të thotë; të mendosh që, nëse dikush hyn tek e vërteta, te realiteti i gjërave të njohura, tek ato që ai ka parë e ka dëgjuar, atëherë, është duke bërë histori, reportazh.

Mua më kanë kritikuar shumë bashkëshatarët e mi se tregoj gënjeshtër, se nuk bëj histori, apo se gjithçka që them e që shkruaj, thonë ata, nuk ka

ndodhur kurrë dhe kanë të drejtë. Për mua, kryesorja është imagjinata; brenda atyre tri pikave bazë që folëm më lart vërtitet imagjinata; imagjinata është e pafund, nuk ka kufij, dhe duhet prishur aty ku mbyll qarkun; ka një derë, duhet të ketë një derë ikjeje, dhe andej duhet larguar, duhet ikur. Këtu na del diçka tjetër që quhet intuitë: intuita të bën të mendosh diçka që nuk ka ndodhur, por që ndodh në të shkruar. Për ta konkretizuar këtë, punohet me: imagjinatë, intuitë dhe një të vërtetë të rreme. Po të arrihet kjo, atëherë është arritur te historia që do ta bësh të njohur: puna bëhet në vetmi të plotë, në letërsi nuk mund merret me mend puna kolektive; dhe kjo vetmi të shpie deri atje sa të kthehesh në një lloj mediumi gjërash, sa as ti vetë nuk i njeh, ama, pa ditur se vetëm pavetëdija apo intuita të shpien drejt krijimit dhe ti vazhdon të krijosh. Besoj se kjo është, në parim, baza e çdo tregimi, e çdo historie që do të tregosh. Tani, ka një element tjetër, tjetër gjë po ashtu shumë të rëndësishme, që është dëshira për të treguar diçka mbi disa tema; e dimë mirë se nuk ekzistojnë më shumë se tri tema themelore: dashuria, jeta dhe vdekja. Nuk ka më, nuk ka më tema, kështu është se, për të kuptuar zhvillimin e saj normal, duhet të dish si ta trajtosh, ç'formë do t'i japësh; nuk duhet përsëritur ajo që kanë thënë të tjerët. Atëherë, trajtimi që i bëhet një tregimi na çon, edhe sikur tema të jetë trajtuar pafundësisht, tek të thënë e gjërave ndryshe; jemi duke treguar të njëjtën gjë të treguar që nga Virgjili e nuk e di se nga kush tjetër, kinezët apo kushdo qoftë. Por duhet kërkuar themeli, forma për të trajtuar temën, dhe besoj se brenda krijimit letrar, forma - e quajmë forma letrare - është ajo që drejton, ajo që bën që një histori të ketë interes dhe që tërheq vëmendjen e të tjerëve.

Sapo publikohet një tregim apo një libër, ky libër ka vdekur; autori nuk kthehet më të mendojë për të. Përkundrazi, më përpara, nëse nuk ka mbaruar përfundimisht, libri, vazhdimisht, i vjen vërdallë në kokë autorit: tema vazhdon të vërtitet derisa ai, nga përvoja e vet, e kupton se nuk është i përfunduar, se diçka nuk qëndron; atëherë, duhet kthyer, përsëri, në fillim të historisë, duhet parë se ku është e meta, duhet parë se cili është personazhi që nuk ka lëvizur vetë. Në rastin tim personal, kam vetinë të përjashtohem nga historia, nuk tregoj kurrë një tregim ku të ketë përvoja personale apo që të ketë diçka autobiografike, ose që unë ta kem parë apo ta kem dëgjuar; gjithnjë duhet ta imagjinoj apo ta rikrijoj, në rast se ka një pikëmbështetje. Ai është misteri, krijimi letrar është i mistershëm, dhe arrihet në përfundimin se, po nuk funksionoi personazhi dhe autori duhet ta ndihmojë për të mbijetuar; atëherë dështon, menjëherë. Po flas për gjëra elementare, duhet të më falni për këtë, por këto janë përvojat e mia, kurrë nuk kam treguar diçka që të ketë ndodhur vërtet; baza ime është intuita dhe brenda kësaj ka dalë ajo që është larg autorit. Siç ju thashë edhe më lart,

çështja është të gjesh temën, personazhin, çfarë do të thotë dhe çfarë do të bëjë ky personazh, si do ta fitojë jetën. Nëse personazhi sforcohet prej autorit, ai, menjëherë, do të futet në një rrugë pa krye.

Një nga gjërat më të vështira që më është dashur të bëj, është pikërisht shmangja e autorit, të eliminoj vetveten. Unë i lë personazhet të funksionojnë vetë, jo me pjesëmarrjen time, sepse atëherë futem në sorollatjen e gjedhes, në rragim; dikush arrin deri edhe të futë idetë e tij e, në fund, të ndihet filozof; dikush mundohet të të bëjë të besosh tek ideologjia e tij, te mënyra e tij e të menduarit për jetën apo për botën, për qeniet njerëzore, deri edhe te parimi që lëviz veprimet e njeriut. Kur ndodh kjo, atëherë ai kthehet në eseist. Njohim plot romane-ese, vepra letrare që janë romane-ese; por, si rregull i përgjithshëm, gjinia që i afrohet më pak kësaj është tregimi. Për mua, tregimi është një gjini realisht më e rëndësishme nga romani, sepse në pak faqe duhen thënë shumë gjëra, duhet sintetizuar, duhet përmbajtur; në tregim prozatori duket sikur i ngjan pak një poeti, një poeti të mirë. Poeti gjithnjë duhet t'ia mbajë vrapin kalit, duke i shtrënguar frerën; nëse lëshohet revan dhe shkruan sa për të shkruar, fjalët do t'i dalin njëra pas tjetrës dhe, atëherë, thjesht ka dështuar. Thelbësore është pikërisht të përmbahesh, të mos ia japësh vrapit, të mos zbrazesh; kjo është veçoria e tregimit; unë preferoj tregimin, përpara romanit, sepse romani i pranon më shumë këto rragime.

Thonë se romani është një gjini që përfshin gjithçka, është thes ku mund të futet çdo gjë, futet tregimi, teatri apo aksioni, eseja filozofike apo jofilozofike, futen një sërë temash, me të cilat mbushet ai thes; përkundrazi, në tregim duhet kursyer, duhet sintetizuar dhe, në pak fjalë, duhet thënë apo duhet treguar një histori që dikush tjetër mund ta tregojë me dyqind faqe; kjo është, pak a shumë, ideja që unë kam mbi krijimin, mbi parimin e krijimit letrar; është e qartë se nuk mund të jetë një shpjegim brilant ajo që po them, veç po ju flas në mënyrën më të thjeshtë, sepse unë i kam shumë frikë teoricienët, prandaj përpiqem t'u shmangem, kur shoh një teoricien, marr kthesën menjëherë; unë mendoj se shkrimtari duhet të jetë më pak teoricien se çdo mendimtar, sepse idetë dhe mendimet e tij janë gjëra shumë personale dhe nuk kanë pse ndikojnë tek të tjerët e as duhet që të tjerët të bëjnë atë që do ai; kur arrihet në këtë përfundim, kur mbërrihet në këtë pikë, po të doni quajeni fund, atëherë, njeriu kupton se diçka ka fituar.

Siç e dini të gjithë, nuk ka asnjë shkrimtar që shkruan gjithçka ai mendon, është shumë e vështirë ta kalosh mendimin te shkrimi, besoj se askush nuk e bën dot, askush nuk e ka bërë, veç se, thjesht, ka plot gjëra që sa zhvillohen humbasin.

(Në shqip: Bajram Karabollu)

VIZIONI PËR KULTURËN ELITARE

Elita politike e shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut duhet të ketë të qartë se ka ardhur koha edhe për një elitë kulturore shqiptare. Bashkëjetesa e këtyre dy elitave si dhe bashkërendimi i veprimeve të tyre do të fliste për një pjekuri dhe për një perspektivë të bujshme kombëtare



Nga Avni Halimi

Secili komb në secilin shtet ka figurat e veta emblematike, institucionet e veta që me të drejtë konsiderohen si simbole të krenarisë kombëtare. Natyrisht, në të shumtën e rasteve, këto figura e institucione i përkasin sferës kulturore. Jo rrallë fjala, qëndrimi, sugjerimi, vlerësimi i tyre bëhen vendimtare për të mirën e shtetit dhe të kombit, bëhen ligj i patejkalueshëm, madje edhe për organet drejtuese më të larta të vendit. Kjo është forca e një kombi para së cilës përkulen "zeusët politikë", "herkulët partiakë".

Në ato shoqëri ku në çdo hap e në çdo kohë gëlojnë aktivitetet dhe veprimtaritë jo humane, në ato shoqëri me një demokraci të pazhvilluar e skajshmërisht të brishtë, jo

që nuk dëgjohej asgjëkund ai zë emblematik, por, fatkeqësisht, artikulesit e këtij zëri janë të ngulfatur deri në shuarje. Kështu zë fill dhe vazhdon sa më gjatë jeta e pseudoverave kombëtare. Hiç vlera e kombit rritet me mynxyrat e kulturës kombëtare tek jep shpirt.

Një komb sa më larg kulturës të qëndrojnë aq më afër injorancës politike do të jetë dhe, sa injorant politik që të jetë aq më të lehtë e ka shpërfytyrimin në qenie me vlera primitive. Kultura është ajo që i ushqen vizionet, idealët kombëtare që i jep kuptim politikës.

Në Maqedoninë e Veriut të gjithë shqiptarët duan të merren me kulturë, të gjithë mendojnë se të merresh me kulturë do të thotë të kapësh shansin e përfitimeve të majme, të gjithë mendojnë se kultura është një tezgë gjigante ku mund të shiten dhe të

blihen deri edhe kalbësirat më kutërbuese. Të gjithë i përcjellin aktivitetet limonadë që shiten për kulturë, por sa herë që shprehet nevoja për ta ndihmuar kulturën kombëtare, për të nxjerrë në pah personalitete kompetentë që të shprehin brengë dhe vizion për kulturë, të gjithë i rruhin krahet, të gjithë shprehen si me grahamën e fundit të jetës së tyre duke u arsyetuar me "nuk është koha tani për kulturë"! Strategji e gjetur kjo e të gjithë atyre që kanë interes ta nënshtrijnë një popull dhe të luajnë pa dhimbje mbi kurrizin e tij.

Të marrësh një post ministror, apo të arrish që ta bindësh partnerin qeveritar që ta ndihmojë kulturën shqiptare në Maqedoninë e Veriut, është ngjashëm sikur t'ia mbash dikujt shpirtin gjallë duke i dhënë ujë me bisht të lugës. Të shprehësh kënaqësinë për disa aktivitete kulturore do të thotë të vetë-pajtohesh për të qëndruar miliona kilometra larg botës së profesionalizimit dhe institucionalizimit të jetës së mirëfilltë kulturore.

Pra, kultura shqiptare në Maqedoni nuk ka nevojë për ndihma prej institucioneve përkatëse shtetërore por, ka nevojë për një strategji kombëtare, për një plan zhvillimor si dhe për buxhet konkret shtetëror. Këto tri elemente shumë shpejt do të bëhen digë për lumin e politikave diskriminuese maqedonase, sepse elementët kulturorë janë në rritje e sipër, fakulteti i arteve pranë USHT-së tash e sa kohë është duke prodhuar kuadro kulturore, po ashtu edhe fakultetet e tjera shoqërore. Potenciali kreativ kulturor shqiptar është në rritje e sipër përkundër thellimit të hendekut në mes të tyre të subjekteve politike e shtetërore. Shtimi i këtij potenciali në njërin anë dhe, rritja e moskokëçarjes politike në anën tjetër, do të jenë shkaktare të shkëndijave të zhvillimeve dualiste të

paevitueshëm që do t'i ushqejnë problemet ndëretnik në Maqedoninë e Veriut. Do të nisë si një "revolucion kulturor" i cili, në historinë e njerëzimit, gjithnjë ka hasur në simpati, në përkrahje dhe në madhërim nga shoqëritë e civilizuar.

Subjektet tona politike janë të themeluar dhe duhet të funksionojnë ekskluzivisht në mbrojtje të të gjitha tipareve që e përbëjnë identitetin kombëtar. Identiteti kulturor është dhe duhet të jetë bazë e veprimtarisë së tyre kombëtare. Le të merren të gjithë me kulturë, le të prodhojë të gjithë kulturë, le të kënaqen të gjithë me kulturë, ngjashëm si në sport: një komb sa më masivisht që merret me sport aq më i shëndetshëm do të jetë por, megjithatë, trupat reprezentative, pra përfaqësuesit e kombëtares, flasin për seriozitetin e kombit në këtë sferë. Edhe në kulturë, populli duhet t'i ketë përfaqësuesit e vetë reprezentativë, qofshin këta institucione apo individë profesionistë që me dinjitet dinë t'i mbrojnë dhe t'i artikulojnë vlerat kulturore kombëtare dhe jo vetëm. Veprimet amatore në kulturë janë si ato sporte që zhvillohen në rrugë: ndonëse kanë atraktivitetin e vet nuk flasin për kurrfarë vlerë sportive kombëtare.

Elita politike e shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut duhet të ketë të qartë se ka ardhur koha edhe për një elitë kulturore shqiptare. Bashkëjetesa e këtyre dy elitave si dhe bashkërendimi i veprimeve të tyre do të fliste për një pjekuri dhe për një perspektivë të bujshme kombëtare. Elita kulturore shqiptare në vend gjithnjë do të ishte pararojë e çështjeve kombëtare ndërsa do të ishte edhe rrufe mbi të gjithë ata që mundohen të na e shesin sapunin për djathë. Në suaza të interesave kombëtare, elita kulturore perceptohet si legjislativi ndërsa elita politike si ekzekutivi kombëtar.

Udhëkryqi art - politikë

NXITJE PËR REFLEKTIME POZITIVE

Artistët figurativë në Maqedoninë e Veriut në përgjithësi shumë pak lexojnë, shumë pak flasin, shumë pak dëgjojnë, shumë pak reflektojnë, shumë pak e njohin artin e vërtetë

Burhan AHMETI

Jetojmë në një shtet në të cilin nuk ka rend të qëndrueshëm shoqëror, artistik apo kulturor, por mbi të gjitha as laramani ngjarjesh. Ka vetëm imitime, kopje apo improvizime. Edhe pse çdo prurje e re që ekspozohet nga artistët për shoqërinë duket si risi, por në realitet nuk është gjë tjetër përpos një kopje e shëmtuar e artistëve të mëhershëm që kanë lënë gjurmë në historinë e artit. Artistët figurativë në Maqedoninë e Veriut në përgjithësi shumë pak lexojnë, shumë pak flasin, shumë pak dëgjojnë, shumë pak reflektojnë, shumë pak e njohin artin e vërtetë apo atë që po e bëjnë edhe vet. Duket se më tepër aktojnë kinse po bëjnë art por në realitet improvizojnë dhe e mashtrojnë veten.

Në anën tjetër, mungojnë dhe gazetarët e rubrikave të kulturës, mungojnë debatet, mungojnë përkrahjet e sinqerta institucionale, mungon dhe kolegjaliteti pasi që është sfiduar nga rivaliteti. Edhe ata pak artistë të kompletuar që mund të themi se ekzistojnë duket se po treten, pasi që dialogun më të sinqertë e bëjnë me veten apo me artin e tyre. Me fjalë të tjera,

nëna e të gjitha profesioneve këtu te ne është politika. Çdo e "mirë" dhe e keqe që na vjen dihet se e kemi po nga ajo "nënë". Artistët në Maqedoninë e Veriut gati se aspak nuk reagojnë në situata të ndryshme, apo nuk e përdorin artin e tyre për t'iu rezistuar institucioneve shtetërore apo politikës së gabuar, nuk i dalin para "nënës". Ata, edhe pse shpesh përfshihen në politikë, prapëseprapë nuk arrijnë që t'i ndryshojnë gjërat parësore në favor të tyre apo të komunitetit të artistëve.

Biles, disa nga ata artistë që e llogarisin veten si të "mëdhenj", nëpër evenimente artistike, ekspozita, koloni arti po e minimizojnë edhe veten e tyre, duke i promovuar më shumë ata që janë në pushtet sesa artin e tyre apo aktivitetin për të cilën arsye janë mbledhur. E politizojnë artin apo aktivitetin për interesa të vogla personale apo për famë duke iu ndenjur stoik ministrave, deputetëve, kryeparlamentarit dhe duke bërë selfie me apo pa vetëdije.

Dihej se ku shkojnë politikanët i ndjellin edhe mediat. Zhurmë shumë për kurrjë hiç! Ka dhe të tillë artistë që janë distancuar dhe nganjëherë e përdorin artin e tyre për të minuar në mënyrë

eksplicite gjendjen kaotike që na ka kapluar apo politikën e qeveritare me të cilat ata nuk pajtohen. Arti mund të paraqitet dhe interpretohet në mënyra të ndryshme. Artistët kanë mundësi të shumta që në mënyra të ndryshme të reagojnë përmes fotografisë, performancës, simbolikës dhe semiotikës, pikturës, skulpturës madje edhe përmes reagimeve me shkrim. Nganjëherë kot edhe se reagohej kur duket se nuk vërehen ndryshime. E rëndësishmja të mos heshtim! Edhe pse këto qasje mund të duken se janë eksplicite ose subversive, nëse bëhen në kohën dhe momentin e duhur, me shumë lehtësi mund ta sfidojnë çdo dukuri negative që i servohet kësaj shoqërie. Me art mund t'iu përgjigjemi me shumë lehtësi ngjarjeve politike apo çështjeve sociale në mënyra të ndryshme për mospajtimin me politikën e gabuara ose nevojën për ndryshime shoqërore.

Këto lloj shushuritjesh, duke i vënë në dyshim politikën sociale janë bërë edhe më herët nga artistë shumë të njohur, si Francisko Goya, Pablo Picasso apo Jenny Holzer etj. Në Maqedoninë e Veriut shihet qartë se si artistët shqiptarë, kuratorët,

gjithashtu edhe kritikët e artit (të cilët pothuajse nuk ekzistojnë fare), po sfidohen me lehtësi nga politika, pasi që ato pak qindarka që i marrin sa për një koktej i kanë dhuratë nga të përzgjedhurit e tyre. Ka edhe nga ata artistë që kanë aftësi për ta mjetë çdo qeveri, por si produkt me dekada e krijojnë "kosin" (artin) e njëjtë të thartuar që e shesin si bakllava.

Artistët duhet të krijojnë vepra arti të një niveli më të lartë, në mënyrë që zgjidhja e çdo barriere të mundet të trajtohet edhe në mënyrë krijuese figurative. Pra, përmes artit mund të ofrojmë edhe kontekst, kuptim apo vazhdimësi. Krijuesi figurativ mund të jetë i heshtur, por arti i tij duhet të jetë i zhurmshëm apo të gjejë mënyra për të krijuar situata që do të nxisnin refleksime pozitive e të vërteta në shoqëri. Është pak sa e vështirë që të rezultojë kjo menjëherë pasi që për shumicën e popullatës do ishte si absurde apo e pakuptimtë. Mbetemi me shpresë se gjërat gradualisht do mund t'i ndryshojmë bashkërisht për të mirë, duke edukuar dhe arsimuar gjenerata të reja me profesionalizëm pa improvizime dhe pa hatër.

Intervistë: Berat Dakaj, botues

PROPAGANDA DHE LETËRSIA, MOTRA

Nuk ka redaksi botuese më që ta kthen dorëshkrimin. Natyrisht, nëse ia paguan mundin. Nëse nuk ia paguan, dy fjalë s'i ndërron me ty. Edhe nëse dorëshkrimi i librit nuk është i botueshëm, nuk ka vlera, botuesit do ta bindin autorin se është i botueshëm. Do ta bëjnë të botueshëm edhe nëse nuk është



Shkëlzen HALIMI

Berat Dakaj është drejtues i Shtëpisë Botuese "Armagedoni" nga Prishtina, shtëpi kjo, viteve të fundit, ndër më produktivet në lëmin e botimeve. Berati nuk është vetëm botues, por edhe poet e prozator, fanatik i përdorimit të drejtë të gjuhës shqipe, kritik ndaj dukurive negative në shumë segmente të shoqërisë shqiptare, duke u mbështetur në argumente të qëndrueshme. Me Beratin bisedojmë për shumë çështje që gjithsesi do ta tërheqin vëmendjen e lexuesve të HEJZËS...

HEJZA: Berat Dakaj (alias Armagedoni), gazetar, publicist, studiues, botues. Nëse harrojmë edhe ndonjë profesion tjetër tuajin, na kujtoni.

B. DAKAJ: Që në fillim e di pse po i renditni këto profesione të miat. Ju dëshironi që në këtë intervistë të bisedojmë për gazetarinë, për publicistikën, për studimet dhe për botimet. Ndoshta, ndërkohë, edhe për tema të tjera. Nëse ju keni hapësirë të mjaftueshme në revistën "Hejza", unë më me qejf shkruaj sesa flas. Gazetaria shqiptare sot është e njëllotë si në Kosovë, si në Shqipëri, si në Maqedoninë e Veriut, si në Mal të Zi. Bëhet punë kopi past. Nuk është gazetari e mirë por, kështu si është, kështu si bëhet, kështu si shkruhet, më mirë është të jetë e pranishme në jetën tonë dhe në jetën e saj sesa po mos të kishite fare. Ndonjëherë, ndonjë ditë, në ndonjë medie, e shohim pushtetin e katërt.

Ndonjëherë, ndonjë ditë, në ndonjë medie, shohim avokaten e pushtetit. Këso natyre është gazetaria e sotme shqiptare. Një medie të përkëdhelë paradite, një tjetër të sulmon në mesditë, një tjetër të mbron në mbrëmje. Pra, ka disa medie që i shërbejnë pushtetit ashtu siç ka disa medie që u shërbejnë qytetarëve. Ka medie që e përkrahin pozitën ashtu siç ka medie që e përkrahin opozitën. Fatmirësisht, sot, pas zhvillimit të teknologjisë dhe themelimit të shumë medieve online, më shumë ka medie që u shërbejnë qytetarëve. Megjithatë, gazetaria në këto lloje të medieve nuk është profesionale. Mungojnë parimet themelore në shumicën e tyre. Ata dhe ato që shkruajnë dhe publikojnë njoftime në medie mund ta kenë përfunduar fakultetin e gazetarisë, të letërsisë, të gjuhës, të shkencës politike e ku di tjetër, pra të kenë një diplomë fakulteti, por nuk japin dëshmi se dinë të raportojnë sipas rregullave të gazetarisë dhe ta shkruajnë korrekt gjuhën shqipe. Etikën e gjuhës dhe të gazetarisë e shkelin orë e çast. Inspektore të tyre nuk janë më asociacionet, institucionet dhe shoqatat, por individët, të cilët, ndonjëherë, me komentet që bëjnë në vjeggëzat e lajmeve të shpërndara në rrjete sociale, përpos që bëjnë lajm, edhe e argumentojnë lajmin e vërtetë ose e përgënjeshtrojnë duke ofruar dëshmi. Ata japin lajm të mirë dhe lajm të keq. Këtë bashkëpunim medie-qytetarë nuk e ka pasur shtypi fizik, të cilin te ne që një dekadë ia ka zënë vendin modeli elektronik. Fatkeqësisht, për dallim prej shteteve të tjera që i

përmenda më parë, në Kosovë sot nuk botohet asnjë gazetë fizike. Ne kemi çfarë të ruajmë, por nuk kemi letër, bojë dhe para. As shteti, as institucionet e tij, askush nuk shpreh interesim për përkrahje financiare të botimit të gazetave. Kushdo që ka pasur dhe ka një gazetë mund të të flasë më mirë se unë për shpenzimet që bëhen vetëm për shtypin e gazetës. Mund t'ju flas edhe unë pasi që edhe dy vjet më bëhen dy dekada punë në gazetën "Epoka e re". Shtypi fizik i gazetës i ka gjunjëzuar edhe bosët e mëdhenj. Edhe pse kanë dëshirë ta vazhdojnë traditën e shtypshkrimit për shkak të rrezikut që e ndiejnë, nuk kanë guxim t'ia fillojnë. Dhe nuk do t'ia fillojë askush po që se nuk i ofron përkrahje dikush.

HEJZA: Opinione, kolumne, shkrime publicistike, kujtime, shkruani shpesh. Ato që i shprehni për dhe kundër, a po i merr kush parasysh?

B. DAKAJ: Unë flas dhe shkruaj që të tjerët të më dëgjojnë. Kush ka vesh dhe sy, më dëgjon dhe më përkrah. Kush bëhet se i ka, më shikon, më dëgjon dhe hesht. Heshtja është pranim i diçkaje që, ashtu sikurse mua, të shqetëson edhe ty por, për ndonjë qëllim personal, nuk e mbështet publikisht. Tinëzisht, fort. Një njeri i mençur, në vitin 2005, më pati thënë: "Kurrë mos i mësho njeriut që është i rrëzuar për tokë. Atij, po t'u dha mundësia, jepi mbështetje". Ai që m'i ka thënë këto fjalë është Muhamet Mavraj, jo një ndër botuesit më parimor në

Kosovë, por më parimori. Ka përfunduar studimet në tre fakultete. Po doktoron për gazetari. Më mirë se askush tjetër e di ku u dhemb pushtetarëve. Më mirë se askush tjetër e di çfarë ndikimi kanë mediet. Që prej themelimit, herë me gjoks, herë tjetër me mend dhe me miq, po e mban gjallë gazetën "Epoka e re", pa ia shtrirë dorën kurrë pushtetit. Ai, më shumë se profesorët e mi të tre fakulteteve, më ka mësuar të "bluaj" butë dhe egër. Të shkruaj për ata që janë në majë të pozitave e t'i lë mënjanë ata që janë poshtë e që mezi lëvizin vendi. Ky është mësim i madh, të cilin, nëpërmjet reagimeve që shpreh për ndodhi të ndryshme në Kosovë, thuajse për çdo ditë, përpiqem t'ua mësoj të tjerëve sipas mënyrës sime.

HEJZA: Institucionet e kulturës i goditni shpesh, sidomos udhëheqësit e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës.

B. DAKAJ: Kam bërë studime për letërsi, për dramaturgji dhe për gazetari në Universitetin e Prishtinës. Po të studioja për ekonomi ose mjekësi do të shprehja shqetësime të tjera. Kështu që, sa të mundem e të më lënë, do të rri para kive të mi, sidomos para Bibliotekës Kombëtare të Kosovës. Pse më shqetëson gjendja në këtë institucion? Sepse, si asnjëherë tjetër, kurrë më e keqe nuk ka qenë dhe, shpresoj shumë, as nuk do të bëhet. Kushdo tjetër, kurdo që të emërohet drejtor, do t'i vërejë ato që i kam shprehur herë shkurt e herë gjatë për këtë institucion në rrjete sociale, në

medie dhe në prani të ministrave. Ndiej dhimbje për të si për një familje të lënë pas dore. Ditët më të mira të jetës sime, kur kam qenë student, i kam plakur në të. Ende pa e hapur derën e saj shkoja para derës së saj. Në mbrëmje punonjësit e saj mezi më nxirrmin jashtë. Çdo ditë lexoja libra në të. Disa punonjëse të saj, të cilat atëkohë, në vitin 2003, 2004, 2005, 2006, më shërbenin libra për lexim, më thoshin se librat po i gëlltitë. Njëmend ma ushqenin trurin. Më mësonin për të shkruarën, të tashmen dhe të ardhmen. Për gabimet dhe për sukseset. Për dëshitimet dhe për përparimet. Lexoja jo vetëm libra të përmendur e të bërë zhul nga leximi, por edhe të tjerë që ishin harruar nga lexuesit. Biblioteka Kombëtare në ato vite, edhe para atyre viteve, ishte institucion për marrjen dhe për dhënien e dijes. Po sot si është? Në dhjetët vjetët e fundit, institucion vetëm për përrurim librash, për organizime shoqërore dhe politike, për shkrepje të fotografive të fejesave dhe të martesave e për hiçgjë tjetër! Harrova të them, edhe për vizita koti, nga një grup i ngushtë njerëzish brenda saj, jashtë vendit. Ky ministri i Kulturës i Kosovës, Hajrulla Çeku, emëroi një Këshill të ri Drejtues të kësaj biblioteke, mori sugjerimet e anëtarëve të këtij Këshilli për këtë institucion edhe publikisht dhe, çuditërisht, edhe më tutje po vazhdon të heshtë. Është e vërtetë se investimet në infrastrukturën e objektit po i vazhdon. Megjithatë, vetëm fasadat e brendshme dhe të jashtme aty nuk mjaftojnë. Bashkëpunimi me Shqipëri dhe me shtete të tjera evropiane është ndërprerë. Janë shkruar dhe nënshkruar disa herë kalendarë të përbashkët kulturorë. Në ditët e atyre kalendarëve nuk janë organizuar ngjarjet që i kanë zënë ngoje dhe i kanë shkruar në letër. Është tërhequr Shqipëria, është tërhequr edhe Kosova. Një punë të mirë që vazhdon ta bëjë Kosova kurrë s'e ka bërë Shqipëria. S'e ka bërë as s'e bën Maqedonia e Veriut. S'e bën as Mali i Zi. Çfarë është ajo punë? Biblioteka Kombëtare e Kosovës, bibliotekat komunale, shkollore, të specializuara, ato të institucioneve qendrore, të fakulteteve, çdo vit pajisen me libra të rinj nga botuesit e Shqipërisë, të Maqedonisë së Veriut, të Malit të Zi. Mijëra euro çdo vit institucionet e Kosovës blejnë libra nga botuesit e këtyre tri shteteve e institucionet e këtyre tri shteteve një ekzemplar nuk e blejnë nga botuesit e Kosovës. Për çdo ditë e vizitohet uebfaqet e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, të Maqedonisë së Veriut, të Malit të Zi, edhe uebfaqet e bibliotekave kombëtare evropiane. I kërkoj në to titujt e librave të rinj të botuesve të Kosovës. Asnjë s'e gjej. Nuk blejnë. Presin vetëm dhurime, se as për shkëmbime nuk janë të interesuara. Kanë premtuar ministrat e Kulturës, të Kosovës dhe të Shqipërisë, njëri pas tjetrit, se kësaj gjendjeje do t'i japin fund, se aq sa blejnë libra nga botuesit e Shqipërisë institucionet e Kosovës, aq do të blejnë institucionet e Shqipërisë nga botuesit e Kosovës. Na kanë mashtruar jo këta të Kosovës, por ata të Shqipërisë. S'e kanë mbajtur fjalën asnjëri. As ai që ka qenë burrë kulture, as ajo që ka qenë grua kulture. As ai që ka qenë ministër, as ajo që është bërë ministër. Këtë shqetësim që po shpreh këtu ia kam shprehur edhe drejtorit të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, Piro Mishës, në Pallatin e Kongreseve në Shqipëri. Ai, para dyzet burrave dhe grave, më tha: "Biblioteka jonë Kombëtare s'mund të blejë libra nga botuesit e Kosovës sepse Ministria jonë e Kulturës nuk na ndan buxhet. Pastaj janë disa procedura të hapjes dhe mbylljes së tenderëve të cilat s'janë lehtë të realizueshme". Këto procedura që ai i pati përmendur në Shqipëri, realizohen shumë thjesht në Kosovë, kudo në botë dhe do të realizoheshin po kaq lehtë edhe



në Shqipëri po qe se shteti atje vendos t'i pasurojë, përpos Bibliotekën Kombëtare, edhe ato komunale dhe shkollore me botimet e Kosovës. Dhe këtu, në Kosovë, nuk botohet pak. Për një vit, nëse mos më shumë, botohen mbi 2 200 tituj të rinj. Prej gjithë këtij numri librash, ata të Shqipërisë s'i njohin as njëzet tituj të Kosovës. Mosnjohurinë, veçanërisht për letërsinë e Kosovës, për poezinë, e shpërfaqën kohën e fundit me një antologji të hartuar, mbase, në ndonjë bunker të Enver Hoxhës!

HEJZA: Kaq shumë, sa shprehët qëndrim kritik për Shqipërinë në fushën e kulturës, nuk bën të shprehni për Maqedoninë e Veriut.

B. DAKAJ: Nëse shpreh kaq shumë gaboj shumë. Edhe mund të shpreh shumë e ju t'i jepni kundërgjendjet tuaja po qe se i keni të qëndrueshme. E përcjell gjendjen edhe te ju, po jo sa në Shqipëri. Dhe e di mirë se as në Maqedoninë e Veriut nuk është gjendja më e mirë se në Shqipëri. Interesim, nga institucionet e kulturës maqedonase, për blerjen e librit shqip të botuar në Kosovë, nuk ka. Ministria e Kulturës e Maqedonisë ka shkurtuar edhe subvencionet për shqiptarët për botim të librit dhe të zhvillimit të veprimtarive kulturore. Interesimin më të madh dhe përkrahjen më të madhe po e shpreh dhe po e jep për maqedonasit. Pavarësisht këtij nacionalizmi që shpreh edhe në kulturë, më vjen mirë që ajo po angazhohet për përkthimin e letërsisë maqedonase në gjuhë të huaj. Disa vjet më parë përkthymet dhe botuam në gjuhën shqipe "Mrekullinë e tetë" të Jordan Pllavneshit, "Grabitja e Evropës" të Ivan Xheparovskit, "Asht kryqi" të Natasha Sarxhoskës. Veprat e tyre i botoi shtëpia që udhëheq unë, "Armagedoni". Kam plan që letërsinë maqedonase edhe në vitet e ardhshme t'ua paraqes lexuesve shqiptarë. Nuk duhet të vijmë ne deri në Shkup për të parë dhe për të bërë dhe maqedonasit në Kosovë për të njëjtën punë, por edhe për të diskutuar dhe për ta promovuar letërsinë që krijojmë. Bashkëpunimin më të mirë kombëtar dhe shtetëror mund ta bëjnë nëpërmjet fushës së kulturës. E kanë bërë një herë e një kohë "Rilindja" e Kosovës dhe "Flaka e vëllazërimit" e Shkupit. Tash duhet ta bëjnë të tjerët. Ta bëjmë ne qoftë me e qoftë pa mbështetje të institucioneve.

HEJZA: E përmendët që keni studiuar për letërsi, gazetari dhe dramaturgj. Shkruani më shpesh poezi, tregime, romane, studime, kolumne, drama, skenarë apo...?

B. DAKAJ: Shkruaj çdo lloj shkrimi. Në vitin 2005 pata përgatitur për botim librin me poezi me titull "Vrima e artë" e me nëntitull "69 poezi shkruar për 69 ditë". Poezi erotike dhe, aty-këtu, edhe ndonjë pornografike. E shkrova edhe parathënien e saj prej njëzet faqesh, edhe mora leje për përdorim të pamjes së pikturës së Zake Prelvukajt për kapakun e librit. Librin dhe aventurën seksuale i lashë mënjanë për pak kohë. Ndërkohë u dashurova me një studente të letërsisë dhe, pas një viti bashkëjetese me të, pasi një ditë a një natë e hodha farën në arën e saj, na lindi Pomena. Sot, kur e rilevoj, më vjen turp ta publikoj. Kështu që, "Vrima e artë" do të mbetet vrimë e mbyllur përgjithmonë. Megjithatë, nga poezia nuk kam hequr dorë. Kam përgatitur për botim librin me poezi "Shëtitje nëpër Drenicë". Këtë do ta botoj. Titulli është i përafërt me atë të shkrimtarit boshnjak Faruk Shehiq, "Shëtitje nëpër Srebrenicë". Edhe temat e poezive i kemi të njëjta. Ai shkruan për ndodhitë e luftës në Srebrenicë, unë për ndodhitë e luftës në Drenicë. Letërsia me temë luftën më pëlqen qoftë edhe nëse është ditar, udhëpërshkrim, kujtim. Më pyetët nëse më shpesh shkruaj tregime, romane, studime, kolumne. Tregime shkruaj çdo javë. Tri përmbledhje i kam bërë gati. Edhe dy novela i kam shkruar po s'i kam përfunduar. Po i qëndis stilistikisht. Dramë kam filluar të shkruaj këtë muaj, ndërsa kolumne dhe kujtime çdo ditë. Studime më s'do të shkruaj. Detyrat e fakultetit, edhe fakultetet, i kam përfunduar. Desh harrova, shënime në ditar mbaj çdo natë. Nuk kam qejf vëllimet e tij t'i publikoj sa jam gjallë. Ndoshta bijat e mia, Pomena ose Poliana, nëse vyen gjë edhe im bir Priari, do të përkujdesen për botimin e ditarit. Amanet do t'ua lë.

HEJZA: Shtëpinë botuese "Armagedoni" kur e keni themeluar dhe sa tituj keni botuar deri më tani?

B. DAKAJ: Dhjetë vjet më parë. Numrin e saktë të botimeve nuk e di. Kur më pyesin autorët ose botuesit për numrin e botimeve, u them prit ta shoh barkodin e

fundit që kam marrë nga biblioteka për librin. Mbi 250 tituj, po.

HEJZA: Pse e pagëzuar "Armagedoni"?

B. DAKAJ: Për të zgjedhur mbiemrin tim artistik Armagedoni. Ju e dini që unë nuk jam nga fusha e Palestinës, por nga një fshat i vogël i Klinës. Armagedoni për shumë njerëz ka shumë kuptime. Për shumicën prej tyre ka kuptim kiametin, apokalipsin. Kur i shohin variantet e filmave të "Armageddon"-it, mezi më shohin me sy. Po për mua ka kuptim katarsisin. Armagedoni është gjyq para Zotit. Është vlerësim për punët e bëra mirë dhe për punët e bëra keq. Është vlerësim dhe është ndëshkim. Mohim, assesi.

HEJZA: Çfarë po botohet më së shumti sot në gjithë hapësirën shqipfolëse?

B. DAKAJ: Gjithçka, dhe kurrë më lehtë e më lirë nuk ka kushtuar përgatitja dhe botimi i librit. Nuk ka redaksi botuese më që ta kthen dorëshkrimin. Natyrisht, nëse ia paguan mundin. Nëse nuk ia paguan, dy fjalë s'i ndërron me ty. Edhe nëse dorëshkrimi i librit nuk është i botueshëm, nuk ka vlera, botuesit do ta bindin autorin se është i botueshëm. Do ta bëjnë të botueshëm edhe nëse nuk është. Përditë më kalojnë nëpër duar nga njëzet tituj të librave të botuara në Kosovë, Shqipëri, Maqedoni të Veriut, Mal të Zi, Evropë. Cilësia e shtypit e njëjtë kudo. E vlerave, e dallueshme seku.

HEJZA: Një libër, sa copë shtypet?

B. DAKAJ: Për këtë pyetje më duhet do t'ju jap përgjigje të gjatë për dy raste. Para shtatë vjetësh një shkrimtar mesatar më shkroi në "Facebook". Kishte një dorëshkrim libri me poezi. Më pyeti për kushtet e botimit të atij libri. Fillimisht ia kërkova dorëshkrimin. Ma nisi. E mora, e lexova, e korrektova, e lekturova, e redaktova dhe ia ktheva në formatin PDF. "E paske kreh mirë", më shkroi të nesërmen dhe më pyeti për kushtet e tjera, tash materiale. I bëra me dije se dyqind ekzemplarë mund të t'i botoj pa pagesë. "Kaq pak?!", më pyeti me shprehje të habitshme. "Pak të duken?!", me shprehje të habitshme ia ktheva unë. "Po unë i kam pesëqind miq që duan ta kenë librin tim". Nisi të më bëj nervoz diskutimi me të për



tirazhin e librit derisa dikur, kur veç doja t'i thosha botoje ku të duash, sa të duash, tek unë jo, më tha: "Unë nuk kam ndër mend vetëm ta shes librin, por edhe ta jap falas". "E nëse ti ke para të paguash libra e të japësh falas, unë ofsetin një javë do ta lë në punë për ty. Fol sa po do?". I porositi një mijë copë. Ndërkohë erdhi i mori nja shtatëqind prej tyre dhe nisi t'i shpërndajë te njerëzit e njohur dhe tek të panjohurit, tek ata që lexojnë poezi dhe tek ata që dëgjin libra me poezi. Kujtonte se ato treqind copë që m'i la do t'i shitëshin brenda tre muajve e pas tre muajve do të shtypte ekzemplarë të tjerë. Shkuan shpejt ata tre muaj e interesimi për librin e tij nuk ishte i madh. Ai i kishte bërë vetes dhe librit një dëm të madh. U kishte dhuruar shumë njerëzve dhe ata që ende s'e kishin marrë, pritnin ta merrnin falas prej tij e jo ta blinin në librari.

Rasti i dytë është ky. Një autore nga Mitrovica, Antigona Behrami, një natë më shkroi në "Facebook". Kishte një dorëshkrim libri nga fusha e meditimit dhe motivacionit. Dromca biografike në të plot. Përtova ta merrja për botim. Gjatë bisedës më la përshtypje të mirë. Me njëfarë energjie të hasur rrallë te njerëzit e zakonshëm, disi më bëri për vete. I thashë dërgoma ta lexoj. E mora, e lexova, e korrektova, e lekturova, e redaktova, e faqosa, e punuam kapakun e librit me disenjatorin dhe ia dërgova për lexim para shtypit. Pas orës dy të natës, kur ende isha zgjuar, më shkroi: "Ju lumshin duart për punën që keni bërë! Kështu e kam paramenduar. Ju lutem, shtypmini një mijë copë". Ev, thashë, që doli edhe një tjetër, sikurse ai poeti, që nuk përton të paguajë letër e të shpërndajë falas. "Pse një mijë?! Dyqind copë, meqë në të ka pjesë të biografisë suaj, të

sakrificës në kohë lufte, jua bëj pa pagesë". "Shaka po bëni a?!", më pyeti, gjithashtu si poeti, me shprehje të habitshme. "Jo, tybe, shaka jo, po përnjëmend", i thashë. "Jo bre zotni, unë po mendoj a me i shtyp përnjëherë dy mijë copë, a më mirë një herë një mijë e herën tjetër një mijë". S'dija gjë për të. As sa ishte e njohur, as kush ishte, as çfarë bënte, as sa miq dhe mikesh kishte. Të nesërmen fillova shtypin e një mijë ekzemplarëve. Pas nja tri ditësh ia dërgova të gjitha librat në shtëpi. Vetëm një muaj pas, e porositi botimin e dytë prej një mijë ekzemplarësh. "Çfarë u bëre atyre?! I fale, u përmbytën, u dogjën?!", përnjëmend shpreha habi. "Ha, ha, ha... u shitën, u shitën, Beratooooo!". E pamundshme më dukej. Pas ribotimit të librit "Përdore fuqinë që ke brenda" edhe tri herë të tjera, i botova edhe pesë libra të saj. Tirazhi i tyre secilën herë më i madh. Nuk ka dhe një tjetër autore shqiptare që kërkohet nga lexuesit shqiptarë më shumë se kjo. Është rast i rrallë edhe në Ballkan.

HEJZA: Merrni pjesë edhe në panairë të librave. Çfarë tituj të veprave kërkojnë lexuesit dhe sa shiten?

B. DAKAJ: Marr pjesë në panairët e librit që organizohen në Kosovë. Panairët sot nuk janë ngjarje me rëndësi të madhe siç ishin një herë e një kohë. Atë zbritje të çmimeve që ofrojnë botuesit në panairë, po atë e ofrojnë edhe kur nuk organizohen panairë. Sot njerëzit i vizitojnë panairët vetëm për shkak të çmimit më të ulët që mund të ofrojnë, se jo që një libër s'mund ta gjejnë në librari. Edhe nëse sot e kërkojnë një titull në librari e nuk e gjejnë, nëse e bëjnë

porosinë ai të nesërmen u vjen. Zbritjen që ofroj në panairë të librave për botimet e shtëpisë botuese "Armagedoni" e ofroj në çdo kohë. Nuk më çuditin vizitorët që te secili botues kërkojnë libra motivues. Libra për seks të ngadalshëm dhe të shpejtë. Për pasuri dhe për lumturi. Për kurva dhe për kurvarë. Për dashuri me dhe pa kushte. Për martesë të lumtur dhe të dështuar. Nuk duhet t'i akuzojmë pse nuk kërkojnë dhe blejnë libra të nobelistëve e të novelistëve botërorë. As nuk duhet të hatrohemi nëse një koleg yni në vend të, ta zëmë, një libri të Pamukut, zgjedh një të Daut Demakut. Atë që e pëlqen e blen. Nuk bën t'u përzihemi në shije ashtu siç ata nuk bën t'u përzihen në shije të tjerëve. Propozime edhe mund t'u japim, edhe mund të na japin. Po e bëj një digresion të shkurtër në lidhje me këtë kontekst të temës. Në vitin e parë të studimeve banoja me një student kimie, një student fizike dhe një student gjeografie. Kur na vinin shokë në banesë, me të cilët njiheshim për herë të parë, cimerët më paraqitnin kështu para tyre: "Ky studion folklor burimor krahasimtar botëror shqiptar". Talleshin me studimet e mia. Me letërsinë shqipe dhe botërore. Edhe kur i vizitonim panairët bashkë, ata u thoshin botuesve: "Këtij shitjani ndonjë libër nga folklori burimor krahasimtar botëror shqiptar" e vet blinin libra nga fusha e psikologjisë dhe e edukimit për jetën. Më vinte mirë që, përpos për profesionin e parë, interesoheshin edhe për një të dytë. Edhe prej këtyre librave njerëzit mësojnë dhe bëhen më zemërbutë dhe më mendjehapur.

HEJZA: Keni përkthyer dhe botuar në shqipe edhe libra nga gjuhët e tjera?

B. DAKAJ: Unë nuk kam përkthyer. Unë vetëm i kam botuar. Kam bashkëpunuar dhe bashkëpunoj me disa përkthyes nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi, të cilët, përpos libra, për revistën "Akademia" përkthejnë tekste të ndryshme. Është kënaqësi e madhe bashkëpunimi me Fadil Bajrajn, Agron Shalën, Granit Zelën, Daut Dautin, Verjon Fashion, Salajdin Salihun, Shkëlzen Halimin, Avni Spahiun, Majlinda Çullhajn, Meliza Krasniqin, Qerim Raqin, Leonora Buçincën, Fatijona Bajrën, Iliaz Bobajn, Majlinda Bregasin, Eris Rusin, Klodi Briçin, Fortesë Frangun, Elvi Sidherin, Lirak Karjagdiun, Ali Pajazitin, Alban Tufën, Jahja Hondozin, Nikollë Berishajn, Shpresë Mulliqin, Ismet Dacin e dhjetëra të tjerë.

HEJZA: Po për përkthimin e veprave të autorëve shqiptarë, jeni angazhuar?

B. DAKAJ: Jam interesuar dhe jam angazhuar. Kur e kam parë si funksionon, kur u kam shkruar dhe kur më kanë shkruar, nuk i kam shtyrë projektet e tilla përpara. Disa shkrimtarë të Kosovës propagandës i thonë "para-marsh!" e vet shkojnë pas saj. Paralelisht bëjnë propagandë dhe letërsi, por më shumë bëjnë propagandë për veprat e veta sesa që bëjnë letërsi të mirë. Ata lidhin marrëveshje me botues të huaj vetëm për përdorim të logos dhe të barkodit e librat i botojnë në Kosovë njëqind dhe dyqind copë. I mësuam këto punë tashmë. Përkthyesit i paguajnë vetë. Redaktorët vetë. Disenjatorët vetë. Shtypin vetë. Kjo propagandë e tyre te disa njerëz shitet, te disa të tjerë nuk shitet. Bashkëpunoj me katër-pesë shtypshkronja në Kosovë. Kur veprat e atyre shkrimtarëve shqiptarë i shoh të përkthyer në gjuhën gjermane, italiane, frënge e të shtypura në printerët "Ricon" të tyre, zgërdhijem goxha gjatë. Ka edhe shkrimtarë të tjerë që bëjnë këso propagande: botimin e parë e shtypin dyqind copë, pas dy-tre muajve i shtypin edhe dyqind të tjerë dhe e shkruajnë botimi i dytë, i tretë. Paraqiten shkrimtarë dhe botues të suksesshëm e, pavarësisht prej propagandës që bëjnë në rrjetet sociale për sukses, në medie elektronike dhe televizione, mbesin botues dhe autorë nën kuotën e TVSh-së. Suksesi ose pasuksesi i tyre mund të verifikohet në Administratën Tatimore. Me rahmetliun, poetin Xhevdet Bajraj, flisnim për këta autorë dhe për këta botues. Për këtë propagandë të tyre. Secilin titull të librit të Xhevdet Bajrajt e kam shtypur pesëqind ekzemplarë. Dy a tri herë, dy prej tyre i kam rishtypur po kaq. E pyesja a ta vëmë në kopertinë botimi i dytë, i tretë. "Jo, bjeshtë, se mos po kujtojnë njerëzit se u bëmë milionera e na qesin haraç ose na lypin pare huva e na duhen për birra dhe meze", shprehte shaka. Ai ishte shumë modest. E rëndësishme për të ishte njerëzit t'i lexonin veprat e tij, jo numrat e ribotimeve në kopertinë. Propagandën nuk e donte. Vetëm thjeshtësinë. Mua, dorën në zemër, kjo kërkesë e tij pak më bënte dëm. Botuesit krenohen kur ndodhin ribotimet e librave dhe të veprave. Unë doja të krenohesha edhe më shumë me veprën dhe suksesin e tij, po ai s'më linte të gëzohesha shumë dhe, kur iku nga kjo botë, më pikëlloi shumë.

HEJZA: Armagedon, do të donim ta vazhdonim këtë bisedë gjatë e më gjatë, po i kemi kaluar standardet e zakonshme të intervistave në revistën tonë.

B. DAKAJ: Ju paralajmërova që në fillim, se nëse ju keni hapësirë të mjaftueshme në revistën "Hejza", unë më me qejf shkruaj sesa flas. Nëse s'keni hapësirë më shumë në këtë numër, e vazhdojmë për ndonjë numër tjetër.

PROVINCIALË PËRBALLË KADARESË

Të lexosh librat e Kadaresë, do të thotë të hysh në një makth ku s'mund të banojmë, por ndiejmë se Kadare banon me ne

Richard EDER

Bota e Ismail Kadaresë është pak a shumë si antimaterie. Ajo shkatërron tonën. Me përjashtim të kësaj, ndryshe nga shembulli i grimcave elementare të fizikës, në të njëjtën kohë plotëson tonën me efektin e zymtë. Për të lexuar romanet e këtij shkrimtari të madh shqiptar, "Pallati i ëndrrave", "Piramida", "Ura me tre harqe", do të thotë të hysh në një makth ku s'mund të banojmë, por ndiejmë se ai banon me ne.

Provincializmi ynë i madh kulturor kërkon korigjues. "Shkrimtari i madh shqiptar" mund të na sjellë një gogësimë vetvetiu. Por botët e tij të vogla mbushin ato të mëdhatë: shoqëria e fshatit të Jane Austen, Misisipi me baltë të Mark Twain, Mança e dremitur e Servantesit. Për këtë shkak, "Ferri" i Dantes është i populluar nga zënkat gjakatare të disa qytet-shteteve të vogla.

Shqipëria ka jetuar e izoluar, e varfër, e shkretuar, gati si një mendim i mëvonshëm nga marshet dhe kundramarshet e Lindjes dhe Perëndimit, dhe e qëndrueshme në kokëfortësi, me kodin antik të dhunës së reprezaljeve dhe armiqësinë e gjakut. Zoti Kadare na tërheq në çuditshmërinë e saj dhe ne dalim si të çuditshëm për veten.

Gjenerali i ushtrisë së vdekur" e bën një këmbim të tillë më të qartë se veprat e fundit të zotit Kadare, të cilat e arrijnë atë përmes ndërlikimit të tmerrshëm. Këtu, në këtë përkthim të kohëve të fundit nga versioni francez, hyrja e Perëndimit të përparuar në errësirën shqiptare dhe morali i tij që çmontohet, fjalë për fjalë rrëfen vetë historinë.

Njëzet vite pas Luftës së Dytë Botërore, gjenerali italian dërgohet në Shqipëri të gjurmojë dhe të kthejë me mijëra ushtarë italianë, të vrarë nga pushtimi famëdashës dhe shkatërrues i Musolinit. Ata janë varrosur në dhjetëra vende të shpërndara dhe të paemërtuara në të gjithë fshatin e rrezikshëm.

Misioni reklamohet si nderi i kombit; gjenerali nis me siguri të tepërt në vetvete, por nuk kalon gjatë para se të ndihet i pushtuar. Ai ka vetëm shoqërinë e një prifti italian, të një eksperti shqiptar dhe një grupi pune, për të përfunduar punën e mundimshme të konsultimit të fshatarëve për të gjetur vendndodhjen e grumbujve të kockave, për t'i gërmuar ato, për t'i zgjedhur dhe për t'i futur në çanta të vogla neljoni, më pas për të kërkuar në të dhënat e zbehta për t'i identifikuar ato.

Ai ruan sigurinë e tij kryelartë. Hartat e shkëlqyera dhe listat e përgatitura mirë për të vdekurit janë shumë më superiore se mjetet e plogëta të një gjenerali shqiptar i ngarkuar me një mision të ngjashëm, dhe kaq të pasuksesshme sa shqiptarët përvetësojnë disa eshtra italiane për t'ia shtuar zbulimeve të tij të varfra.

Dhe më pas zoti Kadare përparon i sforcuar dhe pa emocione në errësirë. Besimi i lumtur i gjeneralit italian gradualisht minohet. Prifti, i cili e njeh

vendin, e paralajmëron se lopatat e punëtorëve po dhunojnë një tabu. Është hera e dytë në 20 vite që një ekspeditë e huaj ushtarake ka pushtuar Shqipërinë. Heshtja e fshatit nuk është pranim i heshtur, por kërcënim; për shekuj me radhë kodi ka kërkuar një reprezalje të vdekur për çdo ofendim ndaj nderit. "Hakmarrja e tyre është si një pjesë e kompozuar në përputhje me të gjitha ligjet e tragjedisë", paralajmëron prifti. "Natyra e tyre kërkon luftë, thërret për luftë", thotë ai. "Në paqe, shqiptarët bëhen grindavecë dhe gjysmë të gjallë, si gjarpri në dimër. Vetëm atëherë kur lufton vitaliteti është i shpalosur plotësisht".

Zoti Kadare nuk bën mesazhe; ai i sjell ato në jetën vdekjeprurëse. Një fshatar i jep zë rrymës së errët që ekspedita lëshon. Për të nxjerrë eshtrat e pushtuesve italianë dhe bashkëpunëtorëve të tyre shqiptarë, do të thotë të përforcosh armikun, ankohet ai. Ushtarët e vdekur janë ushtarë.

Gradualisht, ashtu si tek "Zemra e errësirës" së Kurtz, një frymë primitive e vendit infektion të huajin në dukje superior. Gjenerali fillon të mendojë për grumbujt e kockave ashtu si mendon edhe një fshatar. "Kam një ushtri të tërë nën komandën time tani", mendoi ai. Vetëm se në vend të uniformave kanë veshur çanta najloni. Çanta blu me dy shirita të bardhë dhe cepa të zinj, të bëra me porosi nga firma "Olimpia". Dhe, "tani na mbetet të përfundojmë regjimentet dhe divizionet". Menjëherë fillon të imagjinojë këtë ushtri, nën lidërsipin e tij, që fiton në Normandi, Kore, Vietnam. "Ai ishte një gjeneral që e dinte ç'do të thotë të komandos".

Ushtria e vdekur pushtuese është luftarake tek ai, ashtu si vendet e fshata të shpirtit shqiptar, ku edhe 20 vite më vonë lëndimet thërrasin për hakmarrje. Në të njëjtën kohë, për arsye se zoti Kadare është shkrimtar shumë i mprehtë për të ndjekur një linjë të vetme, gjenerali shkund atë që e trazon në brendësi, edhe pse ajo e trazon edhe së jashtëmi. I sigurt në arrogancë, ai insiston të marrë pjesë në një dasmë fshati i paftuar, me gjithë paralajmërimet e priftit. Vëzhgime të errëta dhe heshtja i përshëndesin ata, edhe pse kreu i shtëpisë e pret me mirësjellje. Atje s'mund të ketë kërcënim, i mburret ai priftit; shih respektin. "Vdekja urdhëron respekt", i përgjigjet prifti.

Një skenë trullësese vjen pas kësaj; drama shpërthen si një ulërimë pas heshtjes së gjatë. I turpëruar, gjenerali përballet me atë që superioriteti perëndimor kishte shpërfillur. Ka vdekje, por zoti Kadare e di se vdekja transmetohet më fuqishëm kur nuk zbulohet e tëra.

Në pjesën e fundit të librit, protagonist, misioni i tij është në përfundim, pi në një hotel me kolegun pjesërisht-perëndimor, gjeneralin shqiptar. Muhabeti është qëllimisht, topitës dhe pafundësisht i parëndësishëm. Antiklimaksi është klimaksi i fshehur. Vdekja e zotit Kadare kishte nevojë vetëm për një çast që të tregonte fytyrën e tmerrshme para se të fundosej në banalitë. /New York Times/



PLAK ASHIK DHE TOPALL – FAN NOLI

Ashtu sikurse edhe Mjeda dhe Fishta, edhe Noli për shkak të misionit fetar, u kufizua në lirikën erotike, përkundër dy të parëve të cilët nuk shkruajtën fare



Majlinda RAMA

Noli nuk u martua asnjëherë, ndonëse në vitin 1908, përpara se të shugurohej prift nga Kryepeshkopi Ortodhoks rus i New Yorkut, Platoni, Noli kishte shprehur dëshirën për t'u martuar. Kjo duket qartë edhe në letërkëmbimet e tij me miqtë e Misirit, të cilëve u kërkonte "ndonjë vajzë të mirë". Edhe studiuesi i tij, Nasho Jorgaqi, është shprehur se Noli kishte kishte pasur flirte apo histori dashurie me disa gra. "Një nga njerëzit që Nolin e ka njohur më mirë dhe më afër ka qenë At Artur Liolin. Në një nga udhëtimet e mia në Boston i pezmatuar më thotë se po ia merrnim Nolit të gjitha arkivin e tij, studimet dhe gjithçka dhe në SHBA nuk mbetet gjë. Më pas vijoi se si kishte ndër mend të bënte diçka që nuk e dinte kush. Më tha se do bënte një studim për gratë në jetën e Fan Nolit. Sipas Liolin, Fan Noli kishte patur histori dashurie dhe flirte me 7 gra në të gjithë jetën e tij. E para ishte një vajzë në fshatin e lindjes në Ibrik Tepe. Një ishte një greke kur ai u shkollua në Greqi. Madje i kërkoi të vëllait të martohej me të por kur i tha më tej se do shkonte në SHBA i vëllai e mori për aventurier dhe e kundërshtoi martesën. Një grua tjetër ishte sekretarja e tij Mary Jons. Një grua që bënte gjithçka për Nolin që nga punët e shtypshkrimeve e deri te kujdesja për shëndetin. Por sipas të dhënave ishte edhe e dashura e tij", ka zbuluar studiuesi dhe bibliografi i Nolit, Nasho Jorgaqi në një intervistë. Por sidoqoftë, ashtu sikurse edhe Mjeda dhe Fishta, edhe Noli për shkak të misionit fetar, u kufizua në lirikën erotike, përkundër dy të parëve të cilët nuk shkruajtën fare. Ai, Noli, do të

spikaste me poezinë e tij satirike "Plak topall edhe ashik", e cila ishte me tepër një reagim satirik ndaj ngacmimeve dashamirëse të miqve të tij.

Të mos harrojmë që Noli kishte përkthyer kryeveprën "Don Kishoti i Maçes" të Servantesit dhe mesa duket ishte nginjur me vargjet që kalorësi i arratisur, Don Kishot (alias Alonso Kishano), sugjestiononet për damën e tij të stisur Dylqinjën e Tobozës. Kalorësit e arratisur, galeotët, lanseloti, kalorësit e mbretit Artur, tryeza e rrumbullakët, etj., një figure poliedrike si Noli nuk kishte se si t'i shpëtonin pa një ngacmim edhe emocional. Nëse do të sjellim vargjet e poezisë "Plak topall edhe ashik", do të shohim se loja satirike e autorit nis me një beftësi trulllosëse, teksa pa bërë asnjë lloj prezantaje, ai e nis me vargun "Dale moj, se kam një fjalë", postulatit hyrës i njëj ndjenje, që këtu te Noli, duket që në start që është një ndjenje që nuk është marrë pas me të njëjtën gjatësi vale, pra nuk është e ndërsjelltë, prandaj edhe vargu hyrës duke përlutës. Pastaj edhe vargu tjetër e thekson këtë "Se më rrjedhin djersët valë".

"Dale, moj, se kam një fjalë,
Se më rrjedhin djersët valë;
Dale, moj, se s'jam më djalë
Dhe më s'ecën dot".

Noli tregon qartë se është gjendur përpara një bote krejt të re, të panjohur më parë, çka po i jep një sflitje të madhe, jashtë fuqive e kapaciteteve dhe energjive fizike të tij. Këto vargje krijojnë një përballje ashikare me njëra – tjetrën, duke vendosur në dy llogore skemën ndjenje-mundësi reale. Në të vërtetë dashuria tek kjo moshë sublimohet, është më e madhe se ajo e një të dashuruari në kohë normale, ku rinia

ia përflak faqëzat... kjo ndjenjë vjen më e mundimshme e shoqëruar diakronikisht me ecurinë e ditëve të heroit lirik. Ai mundohet deri në dyluftim me veten, aq sa gjithçka i vihet përballë dilemës, duhet, s'duhet, mirë a keq. Dihet që Noli kishte ditur të gjente mundësi dhe rrugë për të analizuar e propaganduar çështje të mëdha kombëtare, kishte ditur të kuvendonte dhe të ishte i pari ndër burra, por dukej se kishte qenë kohë e largët kjo për të, tani po "rrezikonte" të prekte fusha të pashkelura, për të cilat miqtë, jo më kot, e vinin në sedër. Dhe ja, më në fund, ai vendos të sfidojë turpin dhe trupin, sfidon vetveten dhe, si Maratonomaku, del mbi të tëra ndjenjat që e mendojnë dhe e thotë atë çfarë i ka zënë frymën. Dhe duket sikur i ka çuar në djall të tëra, rregullat, moralin, konventat e ngurta të shoqërisë. Turpin e ka mbytur dhe ja... Rrezikon!

"E arriva dhe ia thashë,
Asnjë gur pa tundur s'lashë,
Dhe mëgjunjazi i rashë..."

Ah, tani është pikërisht çasti kur botët nisin t'i rrëzohen mbi kokë, ngjyrat e ditës i fashiten. As ai vetë nuk di çfarë shpjegimi t'i japë tërë kësaj: Koha e qejflinjëve? Bota e jaranëve? Moti i ashikëve? Epoka e dashurive të vona? Ç'drejqin qenka tërë kjo potere shkulumuese së brendshmi që ia "nxiu" faqen. Por, jeta ndjek rrugine vet dhe dashuria i jep asaj kuptim. Prandaj, ia vlen mundimi, lodhja, sflitja, orët e pritjes, përlutjet, krenaria nuk ka kuptim në kësi rastesh dhe autori lesohet i tëri në krahët e Dylqinjës së vet, asaj më të mirës, më të bukurës, më përrallos në sytë e tij. Dhe beteja nuk ndalet:

"Dale, moj, se më kapite,
Më këpute, më sfilite,
Prite, moj, ashikun, prite"

S'i gjendet shpjegimi, por as zgjidhja, e cila mbetet në derë të hapur dhe varet vetëm nga një pohim, vetëm një hapje goje e palës tjetër dhe enigma merrte zgjidhje. Por, në asnjë rast, nuk do të rrezikonte nëse do ta mendonte refuzimin. Tërë ai mund, këpërcim i vetvetes, dalje përtej të zakonshmes, fiket kur një fjalë, e cila nënkuptohet në poezi, dhe ajo është përgjigja "Jo".

"Hapi gojën, dhe vajtova,
Qenkam plakur, e kuptova,
M'ardhi keq, po s'e mohova,
Syri m'u-përilot".

Kaq mjafton që bota t'i rrëzohet mbi vete, trup e mendje të kenë tani edhe më turp prej turpit që i ndodhi. Kaq duhet që lufta shpirtërore të mbizotërojë në çdo membranë qelizore të heroit lirik.

Të koritej burri në këtë moshë, ishte njësoj si të vdiste! Më mirë të vdiste! Dhe shohim se si e shpalos këtë përjetim të zhgënjimit të tij.

"Dhe nga jeta u mërzita,
Dhe nga lumi u vërvita
Që të vdes, se u korita
Dy-tri herë sot"

Nëpërmjet përjetimit, para dhe pas mohimit të kësaj dashurie, Noli na paraqet një tablo tjetër, atë të dashurisë në moshë të tretë. Ajo, e cila, shpirtër-

isht përjetohet, por vjen një çast që kthehet në 'mollë të ndaluar'. Dhe duket sikur qesëndisë veten. Plak i marrë, dashuri e marrë. Por ndonëse me nota të një satire, botës i shpaloset pyetja universale: a njeh dashuria moshë? Patjetër që jo. Vitet, jeta, të papriturat le të bërtasin, ato nuk mund t'ja marrin dot të drejtën për të vijuar. Dhe, natyrisht, cila forcë do t'ja ndalte uraganin e brendshëm. Një vajzë e re -shumë më e re se heroi lirik, e bukur -shumë më e bukur se heroi lirik, e brishtë - shumë më e brishtë heroi lirik. Jo dhe jo! Ja fati troket serish në derë dhe autori e kapërcen disfatën me një gjetje po aq të bukur: Një tjetër! Dhe ja, zemra sërisht i fërgëllon për më të mirën e sokakut:

Po ti, Zot, më ngushëllove
Pas një tjetër më lëshove,
Dhe nga mbytyja më shpëtove,
Lavdi paç, o Zot.

Dhe në fund, përsëritet rituali, të njëjtat fjalë, të njëjtat lutje, të njëjtat ndjenja. Jeta e tij vijon bashkë me dashurinë për vashën e ëndrrave, vijon deri në infinitiv e vet.

Dale, moj, se kam një fjalë,
Se më rrjedhin djersët valë;
Dale, moj, se jam i çalë
Dhe më s'ecën dot.

PLAK TOPALL DHE ASHIK

Dale, moj, se kam një fjalë,
Se më rrjedhin djersët valë;
Dale, moj, se s'jam më djalë
Dhe më s'ecën dot.

Dale, moj, se më kapite,
Më këpute, më sfilite,
Prite, moj, ashikun, prite
Që të vjen me not.

E arriva dhe ia thashë,
Asnjë gur pa tundur s'lashë,
Dhe mëgjunjazi i rashë,
Ç'u mundova kot.

Hapi gojën, dhe vajtova,
Qenkam plakur, e kuptova,
M'ardhi keq, po s'e mohova,
Syri m'u-përilot.

Dhe nga jeta u mërzita,
Dhe nga lumi u vërvita
Që të vdes, se u korita
Dy-tri herë sot.

Po ti, Zot, më ngushëllove
Pas një tjetër më lëshove,
Dhe nga mbytyja më shpëtove,
Lavdi paç, o Zot.

Dale, moj, se kam një fjalë,
Se më rrjedhin djersët valë;
Dale, moj, se jam i çalë
Dhe më s'ecën dot.

DEMOKRACIA ME SHKAS NGA NJË FOTO

Një problem gjithësi ekziston: problemi është se na kanë mësuar që të sillemi si polic me gjuhën. Ta gjykojmë komunikimin e jo ta lexojmë e t'i kuptojmë zgjedhjet

Ledi Shamku SHKRELI

Një faqe interesante online, të cilën unë e ndjek me kërkimin e sociolinguistikës pasi boton fakte gjuhësore reale dhe shumëgjyreshë - pikërisht ato që i duhen punës sonë - ka nxjerrë këtë foto duke pyetur (me të drejtë) në është shkruar gabim. Si do i përgjigjej Sociolinguistika kësaj situatë sociolinguistike? Po provoj t'i jap një përgjigje.

E para le ta ftillojmë si fjali: MOÇIT BORTHOK KTU është MO' ÇIT BORTHOK KTU ~~ MOS QIT BËRLLOK KTU – MOS HIDH MBETURINA KËTU.

Si e ftillojmë, vlen të sqarojmë domenin, pra vendin ku është shkruar dhe nga kush.

Fjalja porositive është shkruar në avllinë e jashtme (murin rrethues) të një prone private, pra me siguri nga i zoti, i cili ka gjasë të jetë bezdisur nga shndërrimi i kufirit të pronës së tij në "pikë grumbullimi" mbeturinash (bërllok / borthok) nga banorët e mikrokomunitetit të atyshëm, thënë më saktë nga fqinjët e tij e të ngjashmit me të. Sqaruar pra se domeni (vendi) nuk është publik por privat e komunitar, madje mikrokomunitar. Dhe domeni përcakton edhe "marrësit" pra kujt u drejtohet fjalja-porosi. U drejtohet fqinjëve, me të cilët ai paramendohet të ketë marrëdhënie miqësore a së paku informale, ndaj edhe kjo situatë (veç domeni jo publik) përcakton po ashtu llojin e ligjërimit.



Unë nuk kam si ta dij a din ta shkruajë shqipen standarde shkruesi i kësaj porosie, por dij dhe pohoj se po ta kishte shkruar, pra po te kishte shkruar "Mos hidhni mbeturina këtu", shkruesi do të kishte gabuar. Mesazhi i tij në kod zyrtar (pra publik e formal), shkruar në një domen privat e mikrokomunitar, drejtuar

fqinjëve me të cilët ka marrëdhënie informale e miqësore (pra presupozohet se me ta përdor komunikim informal e miqësor), do të qe zgjedhje gjuhësore e gabuar. Mesazhi i shkruar në kod formal pritet të shkruhet nga shteti si VËREJTJE BASHKIE e jo si LUTJE DASHAMIRË E NJËRIT NGA BANORËT. (Lutje të tilla gjejmë plot

të shkruara me penel a spray: Mos parko!!! Leje venin lirë!!! etj etj).

Ndaj nëse ky shkruar lutjen e tij për komshinjtë do ta kish shkruar në kodin standard, kjo zgjedhje regjistri do të kish ngjallur menjëherë tëhuajzimin e tij prej mikrokomunitetit, e për rrjedhojë ky tëhuajzim do kish çuar në cënimin e mirëkuptimit e të bashkëpunimit. Po ta kishte shkruar në standard, ai do kish thyer edhe atë që Hymes quan "Replikë e Kompromisit", e cila rri në bazë të kuptimit e mirëkuptimit komunitar përmes gjuhës. Pra di apo nuk di të shkruajë në standard, ai ka bërë mirë që nuk e ka shkruar në standard. Sociolinguistika i jep të drejtë.

Sqaruar kjo, një problem gjithësi ekziston: problemi është se na kanë mësuar që të sillemi si polic me gjuhën. Ta gjykojmë komunikimin e jo ta lexojmë e t'i kuptojmë zgjedhjet. Ta paragjykojmë e madje ta tallim shkruesin, e jo ta studiojmë e ta kuptojmë zgjedhjen e tij.

Kjo pasi te ne edukimi demokratik me zgjedhjet gjuhësore ende nuk shtrohet si çështje. Kjo analizë imja do t'i kushtohet pikërisht edukimit demokratik, i cili edukon arsyen e jo dogmën. Demokracia para së gjithash është gjuhë, ushtrohet a vritet përmes gjuhës. Ndaj për dashni të demokracisë dhe pasionit për ta mbjellë atë, ju lus të më ndjeni nëse shkrova gjatë.

(Foto nga Gjuha Shqipe - diskutime)

Autori dhe vepra

VLERË KOHE DHE DIMENSION EDUKATIV

(Rreth novelës për fëmijë "ONI S'ËSHTE MË I VOGËL..." i shkrimtarit Vath Koreshi, Sh. B. "Naim Frashëri", Tiranë, 1987)

Xhahid BUSHATI

Vath Koreshi (Lushnjë, 07.05.1936 - Romë, 03.02.2006) me krijimtarinë e tij letrare është një nga shkrimtarët më origjinalë e të talentuar të letrave shqipe. Siç thuhet me të drejtë nga kritika letrare, ai sollti një filozofi të re në prozën shqipe. Na la një krijimtari të pasur në fushën e tregimit, novelës dhe romanit, si dhe në kinematografi, ku disa filma kanë emrin e tij si skenarist. Nuk ishte më shumë se 51-vjeç, kur botoi novelën për parashkollore me titullin "Oni s'është më i vogël..." (Sh. B. "Naim Frashëri", Tiranë, 1987). Është i vetmi krijim i autorit në fushën e letërsisë shqipe për fëmijë e të rinj.

Novela "Oni s'është më i vogël..." është i konceptuar dhe i strukturuar mbi bazën e tetë kapitujve, ku çdo kapitull shënon një formulim, të cilët në përbashkësinë e tyre krijojnë një tablo të qartë të një njohjeje paraprake e të një zhvillimi fabulor në mënyrë lineare me dy personazhe: Oni dhe motra e tij Selma; më pas me veprimet, ndodhitë, e të papriturat e tyre.

Çdo tekst-kapitulli në rrëfimin e autorit ruan masën dhe ngarkesën e duhur të moshës që i drejtohet. Ndiqet me kërkim dhe e shoqëron pyetja: "Ç'po ndodh me Selmën që ka humbur? Oni, a do ta shpëtojë atë?" Lejtmotivi: "Oni nuk është më i vogël, por i madh", është një frazë që ia thotë përherë vetes. Mbi bazën e kësaj formule, ai ndërmerret gjitha veprimet për ta shpëtuar motrën dhe arrin me sukses. Nga ana e autorit është ruajtur me

kujdes e finesë kjo "rritje" e Onit, i cili edhe kur merr veprimet, i përligj ato jo vetëm nga ana moshore por realisht dhe artistikisht. Fantazia e tij shëtit mes reales dhe ireales, njohjes dhe guximtarisë, çudive e të papriturave... Përmes këtyre planeve dhe ndërthurjes së tyre ne besojmë në rritjen e Onit.

Duke u bazuar në përvojën e tij të pasur krijuese në letërsinë për të rritur e në kinematografi, shkrimtarit Vath Koreshi, edhe me këtë krijim të vetëm në fushën e letërsisë për fëmijë, tregoi që njeh psikologjinë dhe botën e fëmijës, i ofroi asaj plot ngjyra, përshkrime të befta e hapësira fantazie çudibërëse. Oni dhe Selma përshkruhen dhe vizatohen me dashuri autori. Edhe mjedisi shoqëruar me natyrë përralle e bën më jetësor rrugëtimin e peripecive të Onit "që tashmë i thotë vetes: - nuk jam më i vogël". Nga njëri kapitull në tjetrin, kurioziteti është bashkudhëtar me lexuesin e vogël, kuriozitet që të shtyn që veprën të mos e heqësh nga dora e ta lexosh me një frymë.

Ndonëse është shkruar 36-vjet më parë, novela "Oni s'është më i vogël" i shkrimtarit Vath Koreshin ruan kujtesën e një vepre se si duhet shkruar ajo për fëmijë, si duhet të jetë marrëdhënia vepër - lexues, si duhet të jetë ndërtimi dhe struktura e frazës, fjalori (numri i fjalëve), etika dhe estetika e saj. Edhe në këtë vepër për fëmijë ai ruajti tiparet e krijimtarisë së tij, na dha një novelë që ka vlerë kohe dhe dimension edukativ.



OPTIKA E DHEUT DHE THELBI POETIK I PORADDECIT

Poetit më shumë i intereson ana estetike. Po, a mund poezia të mos ketë përmbajtje, të mos pasqyrojë diçka?



Sulejman MEHAZI

Optika e dheut në poezinë e Lasgush Poradecit nuk është vetëm orvatje që vargu i tij të jetë i përsosur vetëm në pikëpamje të metrikës e ritmit, por në poezinë e këtij ka rëndësi jashtëzakonisht të madhe dhe optika e brendshme estetike. "...Jam i bindur se gjithkush e ka vënë re ose mund ta vërë re se për figurën e njeriut në përgjithësi dhe fytyrën e tij në veçanti, ndriçimi nga lart është më i dobishëm dhe ai nga poshtë më i papërshtatshëm, ndërsa për peizazhin natyror ndodh pikërisht e kundërta. Sa estetike është natyra..." (Arthur Schopenhauer, Metafizika e dashurisë) Këtë e vërejmë në vjershat PORADECI, MËNGJES, KORRIK,

MBARIM VJESHTE, DIMËR, GJAHTORI në VALLJA E DHERIT dhe DREMIT LIQERI, ZEMRA E LIQERIT në ZEMRA E DHERIT, në të cilën shfaqet impresionimi, pikturimi, preokupimi i një imagjinatë vizuale e qytetit të Pogradecit e cila është karakteristike themelore.

PORADECI

Perëndim përmi qytezë: Mbretëroj dhe moti pas.

Po përhapet dal-nga-dal një pluhurë si një hije.

Nëpër Mal e nër Lëndina fryn një këngë fshetësisje:

Frym e natës shqipëtare tej-për-tej po rreh me gas...

Pas vargjeve të lexuara duket sikur diçka na nxitë në të pamurit, na duket sikur një ekran poetik që na tërheq dhe na bën për të humbur durimin. Këto vargje kurrsesi nuk përpiqen të na ndihmojnë për të kuptuar përmbajtjen e tij, na duket sikur dëshiron të na tregojë diçka dhe që ne ta kuptojmë, na duket sikur të ketë pasur për qëllim të na tregonte diçka që ia vlen, "Nëpër Mal e nër Lëndina fryn një këngë fshetësisje".

Po kjo këngë fshetësisje mos është këngë e përparshme pleqërishte, apo kënga e trishtë: "Si breshër i thërrmuar...si lot i përvëlur". Sikur poeti na bën me dije se vepra e artit për qytetin e tij të lindjes është zhveshur nga çdo gjë e dobishme.

E kudo krahin' e gjerë më s'po qit as pipëlim:

Në Katund kërcet një portë...në Liqer një lopatë...

Një shqiponjë-e arratisur fluturon në Mal-të-Thatë-

Futet zemra djaloshare mun në fund të shpirtit t'im.

"Krahin'e gjerë" e kapluar me një mërzi, ku vetëm përkohësisht dëgjohej zhurma e "portës", dhe e "lopatës", që mbartin ulërimën ogurze të "arratisjes së shqiponjës në Mal të Thatë" shkaku i motit të pluhurosur si hije; na duket si melodi vagneriane të pambaruar, të njëjtën kohë është një përsëritje e filluar apo e humbur prej shekujsh. Mirëpo poeti në kundërshtim me shumanëshmerinë e tij të mahnitshme, ec pas një melodie të caktuar. Nuk mund të përjashtohet që poetit përgjithësisht nuk i vjen për shtati kurfarë zhurme e pakuptimtë melodie, mirëpo fjala është se poeti nuk mund t'ia dalë pa këtë zhurmë melodike, sepse këto zhurma siç janë: "kërcet një portë" në Katund, "bje një lopatë" në Liqer, zëri i "fluturimit në Mal të Thatë" i shqiponjës, duken si pamje skeletesh i asaj gjithçkaje çfarë ndodh në jetën shoqërore-shpirtërore shqiptare të kësaj "Krahin'".

Natyrisht se poetit më shumë i intereson ana estetike. Po, a mund poezia të mos ketë përmbajtje, të mos pasqyrojë diçka?

Mos vallë poeti sipas dy vargjeve të fundit: "Një shqiponjë e arratisur fluturon në mal të thatë/Futet zemra djaloshare mun në fund të shpirtit t'im", ka pasqyruar veten, sepse pikërisht për këtë shkak në këto vargje ndihet një vetmi e sinqertë, pasi ndodh një veprim që s'ka nevojë për dëshmitarë, sepse del në shesh një mungesë që i bëhet lexuesit të ndërgjegjshëm që të humbasë durimin.

Tërë fisi, tërë jeta ra...u dogj...e zuri gjumi...

Zotëroj në katër anë errësira...

Çdo gjë paraqitet si diçka e pafrymë: "Tërë fisi ra, tërë jeta ra", në vend të gjakut të nxehtë rinor, çdo gjë u "dergj...e zuri gjumi", kudo kullon njëllor gjaku i ftohtë sepse "Zotëron në katër anë errësira", duket se të gjitha ngjarjet e ndjekin njëra tjetrën të mbyllura në një farë egoizmi të akullit, të duket si një dramë me tragjedi të vogla. Në çdo çast këtu s'mund të ndjesh asgjë që ta dojë zemra, asgjë që mund të ta freskojë shpirtin apo shpresën. Ndodhitë, përkundrazi, mund t'i përcaktosh si diçka të zymtë, të frikshme, të llahtarshme, patetike, tragjike dhe ironike. Gjithçka këtu përfaqëson në vetvete një përjetim të anës së prapme të jetës, anë aq e çrregullt, saqë themelin melodik që lidh ngjarjet je i detyruar ta kërkosh me xham zmadhues.

"Po tash" ku është shpresa, shpëtimi dhe gjallëria e poetit?

Shpresa e gjithë kësaj drame është rrugëtimi i "Drinit plak" mes-për-mes Shqipërisë i cili që me kohë "mburon prej Shëndaumi".

Po tashi:

Dyke nisur udhëtimin mes-për-mes nër Shqipëri,

Drini plak e i përrallshëm po mburon prej Shëndaumit...

Ndërmjet Orientit dhe Oksidentit

POEZIA E MUHAMMED IKBALLIT

Bisedat poetike të Ikballit me majat e trashëgimisë evropiane dhe të traditës hinduse, në letërsi, filozofi dhe politikë kryejnë një lloj roli ndërmjetësues midis kulturave botërore thelbi i të cilave është takimi, dhënia dhe marrja, jo përlëshja

Metin IZETI

Mendimtari pakistanez, reformator fetar, filozof, shkencëtar, poet dhe letrar Al-lame Muhammed Ikbali (1877-1938) u bë i njohur në të gjithë Azinë, botën islame dhe në Perëndim kryesisht për poezinë e tij, të cilën e shkroi në urdu dhe persisht. Ai botoi rreth tridhjetë libra me poezi, ndër të cilët më të njohurit janë: Asrar-e Khudi (Fshehtësitë e vetvetes), Rumuz-e Bekhudi (Andikacione të vetëmohimit), Payam-e Mashriq (Mesazhi nga Lindja), Zabur-e Ajami (Psalmet Persiane), Javid-nama (Libri i

Përvetësimit), Arm-mughan-e Hijaz (Dhurata e Hixhazit), Bal-i Jibril (Krahu i Xhibrilit) dhe të tjerë. Përveç gjuhëve të përmendura, ai shkroi edhe në arabisht, anglisht dhe gjermanisht, dhe vepra e tij Ripërtëritja e mendimit fetar në Islam krahasohet me Ringjalljen e Shkencave Fetare të të famshmit Huxhxhetu'l-Islam (autoriteti i padiskutueshëm i mendimit islam) nga shekulli i 12-të Ebu Hamid Muhamed el-Gazali. Për sa i përket ndikimit të tij poetik mbi veten dhe popujt e tjerë, Ikbali krahasohet me Gëten dhe Danten dhe varri i tij imagjinar, sipas dëshirës së tij, ndodhet në Konjë - në


afërsi të varrit të Mevlana Xhelaluddin Rumit, autorit të Mesnevisë.

Poetin e zgjedh Zoti

Është e pamundur të gjejsh një poet në letërsinë botërore që ta merrte thirrjen e poetit aq seriozisht sa Ikbali, i cili i dha poezisë një synim kaq të lartë dhe i vuri një detyrë kaq të madhe. Sipas Ikballit, poetin e zgjedh Vetë Zoti, ashtu siç zgjedh profetin dhe shenjtorin e Tij; në të tria digjet shpirti i dashurisë; të tre, megjithëse mediumi i tyre është i ndryshëm, punojnë për të përmbushur vullne-

tin e Zotit në botë.

Konceptimi i Ikballit për poezinë është në përputhje me kozmologjinë e tij: në botën poetike, poezia është vetë jeta dhe jeta është poezi; si në krijimin e pafund. Poeti është filozof, mik dhe udhërrëfyes i individit dhe shoqërisë; ai i udhëzon në zhvillimin e tyre, u hap atyre pamje, njohje dhe botë të reja dhe u vë qëllime të larta etike, ashtu siç bëjnë profeti dhe shenjtorët. Poeti është prototipi i njeriut të përsosur, insan-i kamil, të cilin Zoti i Madhërishtëm e kërkon; ai është një rebel, një ikonoklast, një revolucionar, një hero i shtypjes morale, një kampion i idealeve të



larta dhe një paralajmërues i zhvillimit njerëzor. Në fund të fundit, thotë Ikbali, vetë Zoti është poeti arketip, artisti suprem që shprehet përmes krijimit të vazhdueshëm dhe që është Dashuria e pastër.

Prandaj Ikbali e dënoi poezinë, qëllimi i vetëm i së cilës është kënaqësia estetike. Një poezi e tillë - thotë ai - dobëson vullnetin për veprim dhe ndahet nga kërkesat etike. Prandaj ai kritikon konceptimin e Platonit për këtë degë të artit. Në ndryshim nga bota e ideve të Platonit dhe këndvështrimi i tij për poetin që krijon iluzione iluzionesh, një botë nostalgjive shpirtërore dhe pasiviteti moral, zëri poetik i Ikbaliit shpall botën e së ardhmes, përmirësimit dhe vazhdueshëm, evolucionin që nuk ndalet në këtë botë...

Ndaj, poezia e tij është një debat epokal me mendimin poetik dhe figurat më të mëdha historike të Perëndimit dhe Lindjes, si: Rama (një figurë e lashtë hindu që mishëron njeriun e përsosur), Ebu Bekri (kalifi i parë), Ebul-’Ala el-Me’arri (poet arab nga Siria, shekulli i 11-të), Rumi, Shekspiri, Gëte, Petefi, August Comte, Mirza Asadullah Khan Ghalib (poet indian urdu nga shekulli i 19-të), Xhemaluddin Afgani (mendimtari mysliman - modernist nga fundi i shekullit XIX), Niçe, Tolstoj, Lenini, Henri Bergson, e të tjerë. Ikbali lexonte poezi nga tradita të ndryshme të mëdha letrare në origjinal ose në përkthime, veçanërisht persisht, urdu, arabisht, anglisht dhe gjermanisht. Karakteristika themelore e poetikës së tij është sinteza e romantizmit dhe klasicizmit; ai i admironet romantikët anglezë, veçanërisht Wordsworth dhe Shelley, dhe për çështjet më të larta poetike, ai shkëmbente mendimet e tij me Miltonin (çështja e së keqes dhe roli i Satanait në botë) dhe me Danten dhe, veçanërisht, Gëten. Ikbali, në fakt, është produkt i humusit të tij kulturor islam, nga njëra anë, dhe i kulturës gjermane, nga ana tjetër. Nëse Rumi është "Danti islamik", atëherë Ikbali është "Gëteja e Lindjes Islame". Gëte shkroi Divanin e tij Perëndim-Lindje (West-Oestlicher Divan), në të cilin ai i kërkoi Perëndimit të merrte ushqim shpirtëror nga Lindja; Ikbali, veçanërisht në "Mesazhi i Lindjes" (Payam-e Mashriq), e ofroi këtë ushqim. Në kushtimin e asaj "kryevepre të letërsisë persiane" Ikbali shkruante: "Një përgjigje për Divanin e poetit gjerman". Në hyrje të koleksionit të tij, ai citon fillimisht poetin hebre nga Gjermania, Heine, i cili ka shkruar për Divanin e

Gëtes: "Kjo është një buqetë komplimente që Perëndimi i dërgon Lindjes... Ky libër dëshmon për faktin se Perëndimi, i shqetësuar për dobësinë dhe spiritualizmin e pajetë të tij, kërkon ngrohtësi dhe energji nga flladi i Lindjes..."; kështu që pak më vonë, pasi shpjegon se si dhe me çfarë entuziaste poeti dhe mendimtari më i madh gjerman e përqafoi Lindjen (d.m.th. Persinë dhe burimin e saj të pashtershëm të poezisë), Ikbali thotë: "Nuk ka nevojë të them asgjë për Payam-e Mashriq, i cili u kompozua njëqind vjet pas Divanit West-Oestlicher. Lexuesi do të zbulojë vetë se qëllimi kryesor i këtij libri tim është ringjallja e të gjitha atyre vlerave morale, fetare dhe shoqërore që lidhen drejtpërdrejt me disiplinën e brendshme të individëve dhe kombeve".

Meka e krijimit

Në vitet kur ishte në kulmin e pjekurisë së tij artistike dhe intelektuale, Ikbali hasi në tekstin e famshëm të orientalistit spanjoll Miguel Asino Palacios, La escatología Musulmana en la Divina Comedia. Interesimi i tij për Spanjën muslimane, atë "farë të Evropës" dhe lulëzimin e kulturës islame në këtë pjesë të planetit, ishte i pakufishëm: ai vizitoi Spanjën, u lut në xhaminë në Kordoba dhe u kënaq në vajtimet e tij të fundit: pse perandoritë muslimane dështojnë? Si të rikthehet lavdia e dikurshme myslimane? Në poezinë e tij më të mirë, më përkushtuese, me titull Xhamia në Kurtuba, Ikbali këndoi: O xhami në Kurtubë! / Madhështia dhe bukuria jote janë pasqyra e robit të Allahut; / ai është madhështor dhe luksoz - ti je sublim dhe i kushtueshëm! / Burimi yt rrjedh nëpër kohë, / Kolonat e tua të panumërta u ngjajnë rreshtave të palmave në oazën e Sharnit! / Shkëlqimi i luginës së Sinait përhapet nëpër vendet e tua të fshehta... / Kjo minare e jotja, e hollë si bosht - aty është vendi ku Xhibrili zbrit! / Besimtari i Islamit nuk mund të shkatërrohet - sepse thirrja e tij për adhurim zbulon sekretin e Musait dhe Ibrahimit; / sepse toka e tij nuk ka kufi, / sepse qielli i tij nuk ka fund; / sepse valët e detit të tij përhapen mbi Tigrin, Danubin dhe Nilin!

O Xhami në Kurtuba! / përmes teje zbulohet sekretin e njeriut islam, / plotësia e ditëve të tij, trishtimi i netëve të tij, / vendi i tij i nderit, mendimet e tij të larta, / gëzimi i tij, pasioni i tij, përlësia dhe përkëdhelja e tij!

O Xhami në Kurtuba! / Ti je Meka e

krijimit, pararojë e madhështisë së Islamit! / Falë teje, toka e Spanjës është bërë e shenjtë si Meka! / Ti, je një mustra e tillë që mund të lindin vetëm në zemrën e një muslimani, dhe askund tjetër! / ...Eee, këta besimtarë! / Eee, këta kalorës arabë! / Këta zotërues të 'fytirës frymëzuese', / këta pasues të besimit dhe të së vërtetës - mbretëria e tyre zbulon këtë sekret të thjeshtë / ishte shteti islam që kujdesej për të varfrit, jo për mbretërit! / Mençuria e tyre ngriti Lindjen dhe Perëndimin; / arsyeja e tyre ishte forca udhëheqëse në errësirën evropiane! / Për shkak të gjakut të tyre, madje, sot populli spanjoll është mikpritës, miqësor dhe i dashur. Në këtë vend edhe sot njerëzit duken si gazelë; / edhe sot shigjetat e vështrimeve të tyre magjepsin; / Aroma jemenite ende përzihen me erërat nga malet e tyre; / Në tingujt e tyre rrjedhin edhe sot meloditë e Hixhazit! /

O Xhami në Kurtuba! / Në sytë plot besim, toka jote vlen sa qielli! / Epo në haremim tënd nuk dëgjohej ezani prej disa shekujsh! Në këtë luginë, në këtë habitat, u shpua një karvan i gjallë me xixëllonja!...

Dhe në Vajtimitin dhe përgjigjen ndaj tij, të cilën e shkroi me rastin e luftërave ballkanike në të cilat vdiqën qindra mijëra vëllezër dhe motra të tij, Ikbali thotë:

Pse duhet të vuaj përgjithmonë për shkak të humbjes, pse nuk dua të arrij qëllimin tim! Po, me të vërtetë, ne u bëmë të njohur shumë kohë më parë për zakonet tonë të skllavërimit!

Ne ende tregojmë historinë tonë të trishtë;

nga ripi ynë dhe të informuar!

Ne e kemi mbytur lirën, se në të banon pikëllimi!

Nëse një psherëtimë largohet nga buzët tona,

askush nuk do të dijë të ankojë përsëri këngën e tyre të trishtë!

O Zot, vër veshin të dëgjosh se si ne padisim,

robërit e Tu besnikë e të singertë;

Je mësuar të dëgjosh lëvdatat e të gjitha forcave

dhe tani dëgjoni protestën tonë!

Si të lexohet sot një poet nga Azia e Lartë

Si të dilet nga kriza shumë e thellë në të cilën ka rënë bota myslimane? Si mund të bashkëpunojnë Lindja dhe Perëndimi për mirëqenien e përgjithshme të racës

njerëzore? I parashtron këta pyetje duke folur për identitetin, për veten e tij, të cilin Ikbali e quan khudî, dhe të cilit ia kushtoi mijëra mahnitjet, pyetjet dhe përgjigjet e tij. Khudî zotëron gjithçka që ekziston: Zotin, çdo njeri, çdo komb, zog, lule, planet... dhe çdo Khudî'ut Zoti i dha lirinë për t'u zhvilluar deri në përsosmërinë e tij. Nëse Khudî Hyjnor përjashtohet, asnjë Khudî nuk do ta zhvillojë i vetëm potencialin e tij, por ka mundësi ta bëjë vetëm në bekhudî, duke u përshtatur në vetëmohim në parimin unik që sundon botën. Në atë pistë, Ikbali, një poet i lirisë, shkroi opusin e tij të madh, "Libri i Përrjetësisë" / Javid-nama, një lloj Komodie Hyjnore Muslimane në të cilën udhërrëfyeti i tij i vetëm në kapjen e dijes, lirisë dhe dashurisë së pafund është Mevlana Xhelaluddin Rumi.

Ata që nuk e njohin artin letrar të këtij shkrimtari, me të drejtë do të shtrojnë pyetjet e mëposhtme: A është poezia e këtij poeti-filozof vetëm një mjet i thjeshtë për të shprehur idetë e tij, në këtë rast mjeshtëria e tij letrare sigurisht që do të vihej në dyshim? Ose: Nëse Ikbali është vetëm një poet, atëherë ai nuk ka një sistem të integruar filozofik? Cili është raporti mes poezisë dhe filozofisë së tij? Dhe, së fundi: Pse dhe si të lexohet sot një poet nga Azia e Lartë?

Ikbali është shumë më tepër se një poet i Azisë; poezia e tij e dëshmon atë si një shkrimtar i një trashëgimie kulturore mijëra vjeçare islame. "Kjo trashëgimi, - thotë Mustansir Mir, - ka një pasqyrim të fortë artistik në poezinë e Ikbaliit plot referenca dhe aludime për këtë trashëgimi. Bisedat poetike të Ikbaliit me majat e trashëgimisë evropiane dhe të traditës hinduse, në letërsi, filozofi dhe politikë kryejnë një lloj roli ndërmjetësues midis kulturave botërore thelbi i të cilave është takimi, dhënia dhe marrja, jo përlëshja. Për gjuhën e Ikbaliit, Mustansir Mir thotë: "Mesnevia e Rumiut quhej Kur'an në gjuhën perse. Thuhet shpesh se nëse Kurani do të botohej në Urdu, do të ishte botuar në Urduishten e Ikbaliit. Të thuash se gjuha e Ikbaliit është e aftë të jetë gjuha e shkrimeve të shenja do të thotë pjesërisht se gjuha e tij, ashtu si gjuha e shkrimeve të shenja, është një minierë e thellë kuptimi. Për ata që kërkojnë "një kombinim të forcës dhe elegancës, kuptimit të thellë dhe formës tërheqëse", siç shkruan Schimmel në esenë e saj Poezia Persiane e Ikbaliit, kjo është poezia e Ikbaliit. Si i tillë, Ikbali - edhe pse nuk donte ta quante veten poet, e as Rumi - shkroi përjetësisht - si çdo poet i vërtetë. Prandaj, nëse do të pyesim veten pse lexojmë sot Ikbaliin, mund të përgjigjemi: Sepse edhe sot lexojmë Danten, Shekspirin, Gëten apo Firdusin.

Çështjet e diskutuara nga Ikbali si poet-filozof: nacionalizmi territorial dhe shpirtëror, Islami dhe nacionalizmi, marrëdhënia midis individit dhe shoqërisë, marrëdhëniet midis fesë dhe politikës, "demokracia shpirtërore" islame, pakicat në shoqëritë demokratike dhe multikulturore, heroikja/hedonizmi/ dhe tipi i personalitetit mysliman në sistemin arsimor, ixhtihadi si parim dinamik i kulturës islame, vlerat dhe dobësitë e perëndimit, idhujtaria e re e Lindjes, Lindja dhe Perëndimi, liria e individëve dhe e popujve etj., dhe çështjet që ai ngriti dhe për të cilat diskutuan të tjerët (Annemarie Schimmel, Mustansir Mir, Muhammed Ma'arif, Shamsu Rahman Faruqi e të tjerë), në tekstet: Ikbali dhe tradita idealiste, Ikbali dhe filozofitë e shpirtit, Ikbali dhe filozofitë neokantiane, Ikbali dhe natyralizmi në fe, Ikbali dhe filozofitë e historisë, Ikbali dhe neorealizmi etj., pastaj Ikbali dhe urtësia Kur'anore, Ana estetike e veprave të Ikbaliit, motivet fetare të Ikbaliit, Si të lexohet Ikbali sot, Ikbali dhe trashëgimia letrare urdu, trashëgimia letrare e Ikbaliit dhe Persisë etj. - deri diku, mund të ndryshojë imazhin shpirtëror të shoqërisë sonë të sëmurë.


PARADIGMË E NJERIUT QË NDJEN, SHEH E FLET ME ZEMËR

(Xhevdet Bajraj: "Burri që lozte me engjëj", botoi Armagedoni, Prishtinë, 2021)

Zyrafete SHALA

"Burri që lozte me engjëjt" nga aspekti i kompozicionit paraqitet në trajtën e një poeme narrative me ngjyrimë të fuqishme lirike, e pangjashme me asnjë krijim tjetër të letërsisë bashkëkohore shqipe, ashtu siç është edhe tërë vepra e Bajrajt, një ishull i veçuar në ujërat e turbullta të letërsisë sonë. Shikuar në përgjithësi, elementi narrativ mund të merret si një tipar specifik i poezisë së Xhevdet Bajrajt, por jo edhe thelbësor. Lëvizja narrative, siç do ta quante Dylan Thomas këtë lloj rrëfimi, e bën poezinë të gjallë dhe të gatshme për të bartur në vete koloritin emocional dhe stilistik, i cili tërheq lexuesin drejt një bote ndryshe, mbase më superiore, duke i dhënë kështu mundësinë të reflektojë mbi dukuritë që e rrethojnë. Në anën tjetër, përmes portretizimit të personazhit dhe shpalosjes së jetës së tij, autori sjell edhe situata nga përditshmëria dhe e kaluara kosovare, duke i interpretuar ato nga një këndvështrim specifik që përkon me unën e protagonistit.

Te "Burri që lozte me engjëjt" zbulohet një univers i ngjashëm me fëmijërinë e njerëzimit, ku protagonistit shfaqet si paradigmë e njeriut që ndjen, sheh e flet me zemër, që jeton në harmoni të plotë me natyrën dhe që përjeton dhimbjet, por edhe mrekullitë e saj. Sado që i privuar nga mundësia e të folurit dhe të dëgjuarit, sado që nga të tjerët konsiderohet me mangësi, burri që lozte me engjëjt shfaqet si një version më i avancuar i njeriut; ai nuk arrinte të fliste gjuhën e bashkëvendësve, por e kuptonte gjuhën universale të njerëzimit, për më tepër ai arrinte të kuptonte edhe gjuhën e krijesave të tjera, lisave, pemëve, luleve e kafshëve që ishin pjesë e botës së tij. Mbi këtë aftësi të të kuptuarit ndërtohen edhe marrëdhëniet e tij specifike me çdo qenie. Shurdhmemecit vërtet "zogu ia hëngri fjalët", por ia dhuroi krahët që të fluturojë përtej peizazhit të populluar me njerëz që flasin; ai vërtet ishte një lumë që nuk e dëgjoji kurrë gurgullimën e vet, por në zemrën e tij kishte aq shumë dashuri, sikur aty të ishte ulur vetë Zoti. Ai nuk i dëgjonte uratat e as mallkimet e njerëzve, por i kuptonte ndjenjat që u dilnin nga zemrat, pavarësisht nga ngjyra që kishin ato. Poeti Bajraj krijon alteregon e tij përmes këtij



personazhi unik, brenda gjeografisë shpirtërore të të cilit ruhen të gjitha virtytet që njeriu posedonte përpara se të shpërfytyrohej në trajtën e tanishme.

Ashtu siç ndodh rëndom në modelet narrative të poezisë, edhe në këtë vepër, kemi të bëjmë me kombinimin dhe ndërveprimin e dy dimensioneve: radhitjen e sekuencave të rrëfimit dhe ligjërimin e ndërmjetësuesit apo narratorit, dimensione këto që qëndrojnë në varësi reciproke ndaj njëra-tjetrës. Mirëpo, këtu, sekuencat e rrëfimit nuk shfaqen thjesht si një riprodhim vepërimesh, ato përbëhen nga perceptimet specifike, imagjinata dhe përjetimet, prandaj secila sekuencë narrative, njëkohësisht, është edhe një shtresë semantike në vete. Duke e vënë protagonistin nëpër situatat e ndryshme jetësore, ekstreme apo të rëndomta, autori na ofron edhe një mënyrë të veçantë të përjetimit të tyre, një përjetim të heshitur por shumë të thellë; siç është për shembull përballja me vdekjen e nënës: "Kur i vdiq nëna / ai e varrosi në zemër / dhe për herë të

parë / e dëgjoji zërin e saj" apo me vdekjen e djalit: "Krismat e topave nuk i dëgjonte / dhe nuk e kuptonte pse i dridhej toka nën këmbë / Iu kujtua një verë / me thatësi të madhe / kur hapej varri për djalin e tij / ashtu iu pat dridhur toka nën këmbë". Krahas dhimbjes dhe tronditjes ai ka një mënyrë specifike edhe për përjetimin e gëzimit dhe lumturisë: "Kënaqej kur natën / gruaja mbështeste kokën në gjoksin e tij / apo kur fëmija i ulej në prehër / dhe ky me gëzim / ia mësonte gjuhën e zemrës/. Po aq sa shpërthimet emocionale të personazhit, rrëfimin e pasurojnë edhe ndërmjetësimet e narratorit që na udhëheqin drejt të kuptuarit të botës pa fjalë: "Sa e vështirë duhet të jetë / për një shurdhmemec / ta fusë tërë botën / apo edhe fjalët të dua / në ajër / me një a dy lëvizje dore"/.

Liria njerëzore e protagonistit që endet nëpër fushëbetëjen e jetës, padyshim se është një nga segmentet që autori trajton me kujdes brenda kësaj poeme. Përndryshe, liria njerëzore është një preokupim i kamotshëm i krijimtarisë së Xhevdet Bajrajt, krahas

keqinterpretimit dhe tejkalimit të kufijve të saj. Mirëpo, kësaj radhe, te "Burri që lozte me engjëjt" autori na ofron modelin e njeriut që jeton brenda një lirie të virgjër, i paprekur nga doktrinat, i paprekur nga historia, nga makutëria, nga tundimi për të uzurpuar, shtytja për urrejtje, nevoja për t'u fshehur pas maskave, ngarendja për të bërë emër, i çliruar nga të gjitha këto vese, personazhi i Xhevdet Bajrajt ngjan si njeri që vjen nga një epokë tjetër, që ndjek rrjedhën e kohës, viteve, stinëve pa kërkuar asgjë më shumë, pa trazuar askënd, por përkundrazi, duke ofruar sa më tepër që arrin brenda mundësive të tij. Është trajta e njeriut të padjallëzuar që, brenda realitetit në të cilin rropatemi për të mbijetuar, vjen dhe na përkuqton diçka të largët, diçka që kemi humbur shumë shekuj më parë, esencën e njerëzores. Duke e ngatërruar mirëqenien me të jetuarit e kërmijve, për qejf të vet, mbase është i vështirë identifikimi i shumëkujt me protagonistin e Bajrajt, por pavarësisht nga ky fakt, me personazhin e poemës "Burri që lozte me engjëjt" autori e ka pasuruar letërsinë bashkëkohore shqipe dhe na ka ofruar një rrëfim të pasur emocional që është unik në llojin e tij.

Në shkrimet kritike të publikuara pas botimit të këtij libri dhe pas shpërblimit të tij, shpesh i është dhënë rëndësi lidhshmërisë që ka protagonistin e këtij libri me personazhin real nga i cili autori është frymëzuar për këtë krijim. Megjithatë, qasjet e kësaj natyre jo vetëm që e kufizojnë dhe e ngushtojnë vlerën estetike e letrare të këtij libri, por edhe e dezorientojnë lexuesin, duke i vendosur barriera drejt arritjes në esencën e poemës; më tepër se dedikim për një njeri të afërt, ky libër është një himn për njeriun, për jetën dhe për lirinë, është një universalizim i dhimbjeve të NJERIUT nga goditjet që i jep realiteti. Si i tillë, ai na ofron një version të përkryer të të jetuarit në një botë ideale, pa djallëzi, pa zë, pa fjalë që vrasin, por me lëvizje që sinkretizohen me zërin e natyrës, me zërin e dashurisë.

"Burri që lozte me engjëjt" duhet të lexohet jo vetëm nga lexuesit elitare, por nga të gjithë ata që dinë të lexojnë, sepse me gjuhën e tij të thjeshtë dhe me figuracionin mjeshëtor, por të natyrshëm, ai u ofrohet të gjitha moshave dhe të gjitha llojeve të lexuesve.

Botime për fëmijë

POEZI QË FRYMËZON

(Rreth librit të Alma Zenallarit, "Një libër për yjet")

Nga Agim BAJRAMI

Të shkruash për fëmijët dhe të jesh i suksesshëm me ta, duhet patjetër që të jesh edhe vet pak i tillë, ose të rikthehesh me imagjinatë në moshën e tyre. Nuk di pse më kujtohet kjo sentencë e shkrimtarit të njohur për fëmijë, Bedri Dedja, sa herë që më bien në dorë vepra të autorëve tanë të suksesshëm si "Një libër për yjet".

Alma Zenellari edhe përkundër pozitës shoqërore dhe statusit të saj si nënë, është dhe mbetet me krijimtarinë e saj një fëmijë i përjetshëm. Duke lexuar këtë libër me një titull metaforik, kupton se cilat janë preferencat dhe dëshirat e fëmijëve të sotëm shqiptarë, problematikat dhe zhvillimet që lidhen me jetët dhe rritjen e tyre. Banore e planetit të ëndrrave, kur ja do puna, por dhe e fantazive të pafundme, krijimet e saj marrin atributet e makinës së kohës, që të çon si pa kuptuar në magjinë e moshës së bukur të fëmijërisë sonë. Është një magji që mund ta bëjë vetëm një penë e frymëzuar dhe e përkushtuar si e Almës, larg trajtimeve të njohura dhe skemave të gatshme soc-realiste që janë ende të dukshme në këtë letërsi. Është ky shkaku që sapo e ke mbyllur këtë libër, ndien se brendshmi nevojën për të qenë edhe njëherë fëmijë dhe të flakësh nga supet vitet e shumta të moshës. Personazhet e bukur që të shoqërojnë në këtë libër, kanë secili nga një ndodhi për të na treguar, por edhe për të na bërë nga një pyetje. Përgjigjet e qëlluara dhe gjuha e veçantë me të cilën komunikojnë ata me ne, flasin për një përvojë të gjatë njohëse dhe krijuese të autores në këtë fushë.

Edhe pse ky është libri i parë në këtë zhanër, pjekuria artistike dhe niveli i lartë i të shkruarit të krijojnë përshypjen se ky mund të jetë libri i saj i dhjetë. Heronjtë e këtyre poezive janë vetvetja. Ata nuk e njohin ndrojtjen e moshës dhe pasigurinë që karakterizonte fëmijët e një brezi tjetër. Shumica e tyre karakterizohen nga etja për njohje, por edhe për të qenë protagonistë në të gjithë amplitudën e përditshmërive të tyre. Që nga poezia e parë që hap librin dhe gjer tek e fundit, autorja dhe heronjtë e saj ecin dorë për dorë me njeri tjetrin, jo vetëm për të mos humbur rrugën e rrëfimeve të tyre, por edhe për të qenë sa më pranë njeri tjetrit në çdo situatë. Duke qenë në kontakt përditësor me yjet e saj fëmijët, vëmë re se mes autores dhe personazheve të saj kufijtë ndarës të moshës janë zhdukur si me magji. Të dy palët duket se njihen mirë dhe nuk kanë ndrojtje për t'i besuar njeri tjetrit sekretet dhe të pathënat e jetëve të tyre. Fëmijët e sotëm nuk janë më ata të dikurshmit, është pohimi parësor i këtij libri ndaj dhe gjuha me të cilën duhet folur me ta duhet të jetë krejt e ndryshme.

Ndryshimi i kushteve sociale dhe shoqërore, kanë sjellë një tjetër brez dhe një tjetër psikologji tek ta. Ky është një fakt që i ka shpëtuar shumë autorëve të kësaj letërsie, që vazhdojnë të sillen në krijimtarinë e tyre

njëlloj si me fëmijët e viteve 80 -90, por jo i autores në fjalë. Aftësia e saj për të vjelë ndodhi, ngjarje dhe qëndrime nga jeta e tyre, i kanë sjellë asaj në tryezë një shportë me material të bukur dhe të pasur jetësor. Në këtë kontekst, autores nuk i ka mbetur gjë tjetër përveç se të merret me artikullimin artistik të këtij materiali dhe të na i sugjerojë dhe neve për t'i lexuar.

Është një botë shumëdimensionale dhe shumëngjyrëshe që kur di, të trajtohet mirë, fiton vlera të mirëfillta artistike. Singleriteti i rrëfimeve dhe natyrshmëria me të cilën përcillen, e bëjnë këtë libër të vogël nga fletët, por të madh nga mesazhet dhe pohimet, që merr përsipër të na transmetojë. Forca e vargut, ngarkuar me krahasime të gjetur dhe simbole, është imponuese. Edhe pse autorja është e njohur në poezinë për lexuesit e rritur, ky libër i ri është treguesi aftësive të rralla vëzhguese të saj në këtë fushë. Janë krijime ku nuk mungon entuziazmi, por edhe prirja për të folur me ta me gjuhën e tyre të veçantë.

Heronjtë e këtij libri janë engjëj të zbritur nga qielli për ta bërë këtë botë më të bukur dhe më të singertë. Ata vijin mes nesh për ta na bërë edhe ne si vetja. Nisur nga ky fakt, autorja nuk kursehet t'i pikturojë ata me ngjyrat dhe figurat më të bukura që disponon

arsenali i saj poetik. Hulumton dhe mbledh nga lëndina e luleve të tyre nektarin dhe polenin më të mirë. Lexon poezinë hapëse të librit për mësuesen e parë dhe ndihesh befasisht i veshur edhe me fëmijëri dhe emocione: "S'harroj buzëqeshjen margaritar/ Dhe fjalën tënde të ngrohtë, të urtë/ Kur ti më fshive lotin e parë/ Mësuesja ime e ëmbël, shpirt butë./ Ti më mësove abc -në /Me dashuri dhe përkushtim /Dhe shkronjat bashkë fjalë i bëmë/ Mes gërmash gjeta mrekullinë/

Është një poezi që të frymëzon dhe krijon brenda teje një atmosferë të cilën mund ta injektojë në gjak vetëm figura e shenjtë e kësaj mësueseje dhe plotënia e portretit të saj artistik. Poezia nuk merr përsipër të tregojë histori, por të ndërtojë me mjetet e saj ndjenjën e mirënjohjes së përjetshme të brezave. Të njëjtat drita të ngrohta e shoqërojnë lexuesin e vogël edhe në poezinë kushtuar nënës. Ndonëse këtë herë me një tjetër strukturë vargëzimi pyetja retorike që hedh në ajër poezia, e ka me vete përgjigjen: "A e dini cili është djepi im i parë/ Që ëmbëlsisht më nanurit dhe përkundë/ Është dora e butë e nënës sime /Krahët e saj me ëmbëlsi me mbështjellin pafund". Duke hyrë në brendinë e këtyre dy poezive për këta dy njerëz të shtrenjtë, krijimi poetik del si pa ndjerë nga e zakonshmja, duke e

veshur veten me një frymë dashurie hyjnore.

Të njëjtin nivel artistik dhe të njëjtën elegancë vargësh ndesh edhe në poezitë e tjera, si Fli Matin, Pse u vrej Drinalda, Njolla mbi përparëse, V - e patave të egra etj etj. Shoqërizimi i ideve me figura dhe simbolikë të perceptueshme nga moshë e lexuesve të vegjël ka qenë qëllimi parësor i kësaj autoreje të talentuar. Kjo e bën leximin e tyre të këndshëm dhe me shumë interes.


Tek "Samanta në bibliotekë", autoren e ngacmon loti i pastër i një vajze të vogël, që ka humbur librin. Futja e detajit artistik të engjëllit, që mund ta ketë marre atë, i jep krijimit një kthesë të papritur dhe interesante: Përse qan Samanta / Kërkoj të ma thotë / Tek syri i saj i bukur / Pikoka një pikë lot / Pikon loti i saj / Përmby syn e bukur / I them shpirt mos qaj / Se libri s'ka humbur/

Edhe pse të natyrave të ndryshme, heronjtë e këtij libri, frymorë dhe jo frymorë, janë të prirur për të fantazuar dhe për t'i zhbriuar me këmbëngulje viset dhe ambientet e tyre respektive. Si të tillë shumë pyetje të tyre meritojnë nga një përgjigje nga autorja, të cilave ajo nuk ua përton asnjëherë. Herë duke iu drejtuar imagjinatës së ndezur poetike dhe herë të tjera, duke përdorur dijet e saj të plota shkencore që zotëron bashkëbisedimi i saj me ta, vijon me intensitetin e duhur.

Ndërsa lexoja poezinë "V - e patave të egra" me emocionoi fryma e ndjerë lirike dhe aftësia që ka kjo autore për t'ia përcjellë atë sa më të plotë tek kategoria e lexuesve që u drejtohet. Të njëjtat emocione provon edhe mbas leximit të poezisë "Lojë matematike". Kjo e fundit është në lloj, shumë pak e lëvruar në poezinë tonë dhe si e tillë meriton interes. Të tillë ndjesi të ngjall edhe poezia "Personazhet e përrallave në natën e vitit të ri", "Borëbardha" etj., ku penelatat e autores lëvizin gjithmonë të orientuara nga drita.

Kjo gjë jo vetëm u ka dhënë jetë portreteve, por edhe i ka nxjerrë ato nga velatura e njohur misterioze me të cilat kanë qenë të mbuluar gjer më tash. Veprime të tilla artistike janë jo vetëm tregues mjeshhtërie, por edhe tregues të kulturës së gjerë që zotëron ajo. Bota e kafshëve dhe sendeve është gjithmonë një objekt i preferuar i shumë autorëve të letërsisë për fëmijë. Ka, që ia kanë dalë me sukses, ka që kanë mbetur ne mes të rrugës. Autorja jonë bën pjesë tek të parët.

Bleta, Harabelat, Germat O, F, B, Bora etj., shquhen jo vetëm për trajtimet e tyre origjinale, por të befasojnë për humorin e këndshëm dhe frymën edukative që përcjellin tek fëmijët. E dukshme në këto lloj poezish është fakti që emocionet që ngjall veprimi i tyre shoqërohet ndërkaq edhe me atë të autores. Parë në këtë kontekst them se "Libri i yjeve", është një sprovë e suksesshme e kësaj autoreje dhe një thirrje për të mos u mjaftuar vetëm me kaq. Dalja në dritë e këtij libri, sa të thjeshtë, të pasur dhe të bukur është një pasurim dinjitoz i letërsisë sonë për fëmijë.



DY SHKOLLAT LETRARE SHKODRANE

"A ka send ma të mrekullueshëm në këtë botë se me i sjellë qytetnimitin një kombi zhytë n' errsin e padijes" Doda (Ernest Koliqi "Hija e Maleve", Gjaku)



Adriatik ZEQIRI

Koliqi, shfaqja e ideve

Autori i "Dy shkollat letrare Shkodrane", Ernest Koliqi, është prej atyre autorëve, i cili duke parë drejt ndërtimit të një historie të letërsisë (atë e bën duke diferencuar me shkolla letrare si strukturë), ka dhënë idetë më të qarta letrare (gjithmonë duke i parë idetë për letërsinë dhe krijimin, kryesisht në dy diskurse) për periudhë dhe autorë të caktuar.

Trajtesën tonë do të mundohemi ta drejtojmë në planin e ideve të Koliqit si shkrimtar, mbi letërsinë shqiptare (që, sipas mendimit tonë, është pjesë e ideve letrare dhe subjekt bazik i trajtesës), por pasi që letërsia jonë, në sytë e Koliqit është shpesh imanencë, do të trajtohet edhe konteksti kulturor; shikimi i tij si i tillë. Duke gjakuar vetë drejt fillit të konstruktit të një historie të letërsisë, Koliqi do të marrë në vete barrën e kodifikimit dhe analizës së një pjese të letërsisë shqipe, që, sipas tij, është vetëm pjesë e një tërësie të madhe, por që paraqet kriter trajtimi, të vazhdohet më pas drejt së përgjithshme duke bashkuar copëzat e ndara ("ujdhesa të veçueme").

Në pjesën e parë hyrëse kriterizon në rrafshin e metodës së punës; shfaqjen e ideve të hartimit të një historie të letërsisë gjithëpërfshirëse, me qëllimin e vazhdueshëm të krijimit të bazës së studimit dhe paraqitjes për një letërsi të përgjithshme kombëtare. "Mbas mendjes s' erte, kriteri themeltar për të rrjeshtue vlerat letrare t'

ona në një vepër ku çdo kontribut i dhanun të gjëjë vendin e peshën e njimendët, jo pajambajtas por paans, duhet të perpilohet me një kriter kronologjik pa marrë parasysh vendin e gjymtyrën e fisit shqiptar ku lulzuen auktorët që na e dhuruen". E, për të bindur në këtë tezë, na sjell përpara shembuj si revista "Albania" e botuar nga Faik Konica ("Orvatja qi vërtët krijoi platformë kombtare e shkrimi për të parën herë në mënyrë pozitive rrymbat e ndryshme letrare t' ona, parashtrroi prodhime të spikatuna ne dy djalekte, aviti e bashkoi shkrimtarë veriorë e jugorë me atë të qendrave të diasporës shqiptare qe, mbas mendjes s'onë ajo e se përkohshme Albania qi Faik Konitza qiti më parë në Bruxelles më 1897 dhe ma vonë në Lonër deri më 1909." E. Koliqi "Dy Shkollat Letrare Shkodrane" SHB Shpresa, Prishtinë 1998), një shkrim të Eqrem Çabej ku bën fjalë pikërisht për zhvillimin e letërsisë shqipe, "Për gjenezën e literaturës shqipe" dhe një tekst tjetër në vetin "Antologia d'ella lirica albanese" (Milano 1963) ("Kët kriter ndoqa unë n'Antologia d'ella lirica albanese (Milano 1963). Toskë, gegë, arbreshë, kosovarë aty njehen të gjithë pjestarët një përpjekjeje letrare pa dallime visi e rrethi. E. Koliqi "Dy Shkollat Letrare Shkodrane" Hymje, fq 25, SHB Shpresa, Prishtinë 1998).

Së pari, sipas Koliqit është e domosdoshme që letërsia të shikohet brendapërbrenda "ujdhesave të veçueme", në nivel të shkrimit, të diskursit, të strukturës së tyre që në vete reflektojnë prapavijë kulturore të ndërtimit, të ndryshme nga strukturimet e

tjera të llojit; dhe pikërisht pasi të jetë bërë një gjë e tillë të kalohet në nivel të studimit dhe botimit të një letërsie të përgjithshme kombëtare. Si rezultat të drejtpërdrejt të kësaj ideje, kemi daljen në pah të atij teksti që Koliqi do ta quajë "Dy shkollat letrare Shkodrane"; ku do të trajtohet krijimtaria e dy grupeve kulturore të qarkut të Shkodrës (që përfaqësojnë gjithashtu dy rryma të klerit katolik të Shkodrës, atij Jezuit dhe atij Françeskan), shkollës Jezuite me në krye Dom Ndre Mjeden dhe asaj Françeskane, me në krye At Gjergj Fishten.

Jezuitë / Françeskanë

Në leximin që i bëjmë Dy shkollave të Koliqit, orientimi që na bën të përcjellim një kahe të veçantë dhe të mos kemi shumë mundësi që të dalim jashtë tij (kur flasim për interpretim të tekstit jashtë kontekstit), është shtresa kulturore e cila vjen si nënshtrësë civilizimi dhe e cila komentohet dhe analizohet. Në tekst kemi përballë dy "rrymba" kulturore së pari, e letrare gjithashtu, atë të jezuitëve dhe atë të françeskanëve, që vijnë nga një edukim dhe formim kulturor i ndryshëm, por me bazë të njëjtë, formimin e krishterë, pavarësisht se njëra priret të shihet si përfaqësuese e artit finok, me stil të lartë, tipik klasik, gjuhë të veçantë të shkrimit që korrespondon me veprat model të artit letrar të ngritura në nivel klasike (art që buron nga mësimi empirik skolastik që kanë pasur autorët e tyre, nga filozofia që përfaqëson si grupim, shkolla Jezuite); "Xanoni, Mjedja, Thaçi shkruen e vjershuen me ton e stil të naltë. Ata gjuhën shqipe e caktuen ta përdorin si mjet për t' i shprehë mendimet e ndiesit si mbas modeleve t' auktorëve të huej qi mbarë bota nderon si shembuj përsosjeje letrare. Krenija e tyne i shtynte t' orvateshin qi gjuha shqipe e palavruet t' arrinte në naltësin e hartimit letrar ku hapen kombet tjetra. Prandaj, deshtas, trajtat popullore i lejshin mbas dore. Ata shkrueshin për një elitë". Kurse rryma tjetër, e quajtur nga Koliqi si "Shkolla letrare e Françeskajvet", të vihet në interpretim nëpërmjet idiomës popullore, me pretekst bazën në kulturën popullore të rajonit të caktuar (Shkodrës dhe Malësisë së saj). Ata do t'i kthehen gjuhës popullore dhe të krijuarit me bazë në oralitetin popullor (të nxitur nga filozofia e edukimit të tyre në shkollën françeskane të kohës) dhe duke portretizuar e duke hyrë brenda socmentalitetit dhe psikës së njeriut shqiptar, me të gjithë kompleksivitetin e shtresimet e natyrës së personalitetit të tij të veçantë dhe të "pa civilizuar", struktura të cilat nuk do të dilnin të tilla të "rrymbat" e tjera të krijimit letrar dhe nuk kishin ndërë madhëstinë e tyre në vetvete si në këto struktura krijimtare letrare; "Françeskajvet, jeta shqyptare jo vetëm nisë m' u pasqyru me shfaqjet e me zhvillimet e veta më karakteristike, por m' u pistallë e me admriue vetveten. Shqiptari, me mendsin e vet plot kontraste, tash krenar, e tash i shtruet, herë i rrëmbuem në shkase bujarie dhe herë i ngujuem në paragjykime të dâmshme, këtu gati me dhânë jetën për t' i ndëjun besnik një tradite stërgjyshnore aty gati me e prishë vetin e fisin për një trill idhnaq, hov hov i ngutëshëm e i kadalshëm pa mendue mirë ku lypet ngutsija e ku kadalija, guximtar i matun, kruekcyem e i urtë, del i pikzuem për mrekulli në veprat e Françeskajvet përgjithsisht e të Fishtës veçanërisht"

Koliqi klasik/Koliqi idiomatik

Megjithatë, përfytyrja më e veçantë do të ndodhë brenda vetë Koliqit si shkrimtar dhe si kritik, gjë që na jep mundësinë të shohim më qartë se në çfarë rrafshi lundrojnë idetë e tij si të krijimit, si mbi krijimin. Në një formë e përcakton veten në rrethin e

Jezuitëve si model krijues dhe pasues i po asaj shkolle (për arsye se ishte nxënës jezuit në Itali) dhe letërsinë që ai priret ta krijojë e përafrohet në mënyrë deklarative me të Lasgushit, duke pretenduar që ky i fundit krijimin e kishte të bazuar në modele letrare më të hapura dhe larg asaj që do ta quajmë ndikim i idiomës, duke pëlqyer që të ketë në përdorim një gjuhë të stilit të lartë, një gjuhë elitare, të latuar e të përpunuar, me një qasje tjetër figurative dhe me lëvizje të brendshme strukturale tjetër prej asaj të traditës të krijuar gjer në atë moment kohorë, e kjo sidomos në gjininë letrare që ka për shpirt ai – prozën (tregimin); " Ai pohon se rreth vitit 1930 u përvijua një kthesë me rëndësi në prozën shqipe. Është koha kur pëlhura e prozës nuk krijohet më me "frazat idiomatike", por në të "ngadhënen adjektivit". Ky ndryshim bëhet i domosdoshëm, sipas Koliqit, kur shtjellohet tregimi si gjini, që lyp gjallëri e imitim përshkrimesh dhe larmi fjalësh për t' u ikur përsëritjeve. Kjo do të thotë që tematika tjetër kërkoi stilin e ri. Koliqi shton që "Frazat idiomatike e shprehin gjenerikisht mendimin dhe nuk munden kurrë të shfaqin me qartësi valavitjet e ndjesive". Pra, ndryshimi i metodës krijuese është parë në thellin e saj, nëpërmjet ndryshimit të stilit." Dhe ky do të jetë stili i Koliqit si krijues, përbrenda "adjektivit" në prozën e tij, e cila gjakon të sjellë kulturë dhe civilizim të popullit i tij, gjë që do ta shfaqë haptas në veprën e tij të parë me tregime të vitit 1929, "Hija e maleve", te tregimi Gjaku nëpërmjet personazhit të Dodës: "A ka send ma të mrekullueshëm në këtë botë se me i sjellë qytetnimitin një kombi zhytë n' errsin e padijes", që do të marrë pak a shumë nuancën e motos krijuese të gati gjithë krijimtarisë së Koliqit.

"Koliqi, sipas teorisë së vet fillestare, mendon që kultura është esenca e themelimit të kombit, dhe këtë e provon thellë në historinë ilire-shqiptare".

Por, përfytyrja e madhe është te Koliqi kritik, pikërisht në botimin e tij që kemi vënë si objekt trajtese në këtë shkrim, "Dy shkollat letrare Shkodrane". Ndoshta dëshira e tij që të shohë letërsinë shqipe në një rrafsh të zhvillimit si tërësi dhe jo të zhvilluar si e fragmentarizuar, duke qenë i rritur me ëndrrën për një letërsi kombëtare të zhvilluar, e ku nocioni "kombëtare" do të jetë kryefjalë, dhe pjekja e tij përbrenda një ambienti idealist e romantik do ta shtyjë atë që të vijë në gjykimin se çdo gjë fillin duhet ta ketë në kulturën e traditën popullore, që pastaj të mund të zhvillohet shëndosh. Letërsia si e tillë duhet të fillojë te diskursi i përpunuar popullor që të mund pastaj të zhvillohet drejt niveleve të modeleve klasike. Dhe ideja zhvillohet deri në nivele të civilizimit të gjithëmbarshtëm, ku do të dalim në kontekst të mohimit dhe pohimit, përballje mes nacionale dhe universales, një kontrastopolitizëm, në favor të qenësisë etnike nacionale (dhe pjesa më e çuditshme është momenti kohor në të cilën pohohet kjo, kur Koliqi ishte i dëbuar nga atdheu prej sistemit komunist, dhe është pikërisht jashtë atdheut); dhe si i tillë është në mbështetje të plotë e "fanatike" të veprës së françeskanëve që për bazë të krijimit të tyre do ta kenë "frazën idiomatike", duke shkruar aq larg sa të shpallë poet kombëtar Fishtën.

(...)

Si përfundim do të shohim Koliqin në dy rrafshet në të cilat përpillet gjithë kohën, në atë të Jezuitëve (ku është edhe vetë pjestar i kësaj shkolle në nivel të krijimtarisë letrare dhe pse në tekst nuk priret që ta fusë veten, por vërehet gjakimi i tij për stilin dhe gjuhën) dhe të Françeskanëve që arrijnë t'i dhurojnë kombit në vete shqyptarin pikësëpari dhe ta kthejnë atë nga vetja e vet, e kjo e fundit është në "platformën" e zhvillimit kulturor nacional të Koliqit.

POEZI ME UNITET TË BRENDSHËM

(Rreth vëllimit poetik "Ndonjëherë")

Nuri PLAKU


Agim Bajrami është një emër i njohur në poezinë e sotme shqipe, krijimtaria e të cilit rrezaton gjerësisht vlera të mirëfillta artistike. Së fundi na erdhi me vëllimin e ri poetik titulluar "Ndonjëherë", ku shfaqet sërish mjeshtëria e tij që të bën të ndalesh e të ndiesh së afërmi e së largëti, zërat joshës të kësaj poezie. Ai është një lirik i vrullshëm që shkruan me varg të rregullt e të rimuar dhe e mbush poezinë e tij me emocion të hollë që e bën sa noprane aq dhe lozanjare, elemente të denja këto për një lirikë prekëse e të ndierë. Por, ajo që është më e rëndësishme te kjo poezi është stili i tij, nëpërmjet të cilit ai shfaqet me një un të plotë poetic, duke zhvilluar disa veçori specifike që e bëjnë atë, të njihet nga lexuesi edhe pa e parë emrin e autorit.

Agim Bajrami është poet linear. Gjithë poezia e tij ndërtohet mbi një fabul me shtrirje horizontale, ku ndërthuren të gjitha elementët esencial të ngjarjes. Ato janë gjetje artistike, të thjeshta në dukje, por në thelb jo të tilla. Janë origjinale, të veçanta dhe vilen nga realiteti i përditshëm i jetës apo përjetimit e tij individuale. P.sh. përshtypja që i bën autorit një grua që ecën në bulevard, një mëngjes i prishur nga një njeri i keq, një pritje e zgjatur nga një ardhje e munguar, një udhëtim me urbanin e linjës, një shi i zymtë, situatë pandemie etj, etj. Kjo lloj poezie e bën mjaft të vështirë trajtimin artistik pasi duhet mbushur me elemente të përditshmërisë, të cilët kan brenda tyre "kurthin e Circes" që lidhet me rrezikun e poetizimit të gjithëshkaje, me vargëzimin e rëndomtë dhe degradimin e saj në bejte. Por, Agimi i shpëton këtij kurthi pasi, në laboratorin e tij, ka një "solucion" të veçantë që e realizon mjaft bukur poezinë. Ky është talenti dhe pa atë, nuk mund të ket shkëlqim artistik asnjë poezi.

Nëse do ta analizonim në mënyrë grafike poezinë e tij, do vinim re se ajo shtjellohet në formën e një trekëndëshi. Çdo brinjë e tij mbart ngarkesa energjike të caktuara që manifestojnë të tërën e saj. Në brinjën e parë të këtij trekëndëshi shtrihet hyrja e fabulës që shpesh autori e prezanton në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe rrezatuese. Kjo hyrje hap "portën" e fabulës dhe prezanton lexuesin me klimën e "stinës poetike" dhe shijen e saj që ai do të përjetojë në vazhdim:

Ka ditë, që s'ndihem si më parë
Dhe kjo mendoj, e ka një shkak. (Ka ditë)
Shpesh në thelbin e tyre, fabulat marin
ngjyrim dramatik. Autorit i shkojnë shumë ngjyrimet e trishtat të ndodhive dhe kjo i jep një lloj veli aristokratik. Dramat e mëdha shfaqen tek indet e shoqërisë. Poeti nuk rend pas bujës, ai ndërton poezinë duke qenë përgjithësisht aktor i fabulës, madje edhe posedues shpirtëror i saj. Posedimi lidhet organikisht me unin poetik dhe poeti e ka më për zemër këtë lloj demonstrimi. Kjo përbën brinjën e dytë të trekëndëshit dhe vihet re sidomos tek poezija erotike. Erotizmi shpesh ndërtohet në dualitet kundërvënës me femrën. Gati të gjitha poezitë e këtij vëllimi ndërtohen mbi një raport komunikimi të ndërsjelltë të dashuruarish. Kjo e mbush me jetë, i jep ngarkesë intimiteti poezisë e bën të hajdhme, interesante dhe të perceptueshme.

Tek të sjell në mendje, i turbulluar
Vetveten pyes, çfarë ngjau me ty?
Sepse sa herë unë zemërohem,
Verbohem keq nga njëri sy. (Stres!)
Pasi ndërton fabulën, poeti rrëfen ngjarjen dhe mban edhe qendrimin e tij ndaj saj, qendrim vlerësues ose ndëshkues. Kjo është brinja e tretë e trekëndëshit dhe pikërisht kjo e bën poezinë e tij sa kritike aq dhe edukative. Te kjo brinjë



shfaqet edhe nervozizmi gjuhësor, si një element teknik i shprehjes poetike. Nëpërmjet një fjalori të ashpër dhe ndëshkues, jepet nervi i revoltës së tij për të metat e njerëzve, veprimet e tyre të mbrapshta dhe energjinë negative që ata çlirojnë në kontaktet me njerëz dhe ambientet sociale. Kritika ndaj realitetit është ngritur në nivel estetik te kjo poezi dhe i jep asaj nota të theksuara morale.

Ma prishi mëngjesin ky njeri pa fytyrë
S'më la ta nis ditën i qetë,
Tashmë rrotull nesh vjen gjithçka erë
këllirë,
Që zor se pastrohet lehtë! (Njeriu këllirë)
Apo:
Një nënë e ngrirë me foshnjë në duar
(Dhe pse e vdekur, s'mi ndan sytë?)
Është një Rozafë me sy të shuar,
Legjendë që veten lind çdo vit." (Pas tërmetit)

Erotizmi tek Bajrami ka një shfaqje të veçantë gati, gati personale e cila është mënyrë të shprehur dhe karakteristike e tij individuale. Ai nuk e jep atë nëpërmjet veprimit aktual, nuk përshkruan konkretisht procesin e zhvillimit, praktikën apo rrjedhën e dinamiksë së tij. Përkundrazi, të gjitha këto, shmangen me finesë dhe

zëvendësohet me motivet e mungesës, me dramën e shkaktuar prej largimit të së dashurës, me dëshirën apo pendesën e saj.

Nuk di tek unë se ç'ke trazuar,
Nuk di ç'më ke kurdisur
Nga një njeri i qetë, i shtuar,
Të kthehem një i krisur." (E mbushur plot kjo kafe)

Gjithë krijimtaria poetike e Bajramit zhvillohet thuajse brenda këtij trekëndëshi. Pikërisht aty ndodhet edhe "syri i ciklonit", një lloj bërthame energjike që gjeneron vrullin e poezisë dhe e ngre peshë lexuesin. Kjo i bën brinjët e trekëndëshit që, nga forma statike e përfytyruar, të vibrojnë me elasticitet, e të kthehen në linja transmetimi të energjive poetike dhe ta bëjnë poetin poet. Pikërisht kjo është shtjella e poezisë, është gjurma që autori lë mbas rendjes poetike, kthesat e papritura ku e fut lexuesin, befasirat dhe momentin final tij, ku e nxjerr sërish atë, pra është një tipar strukturor i imazhit që ai ndërton. Në të kundërt të saj, poezija do të ishte përshkruese, drejtvizore, pa nerv dhe pa joshje. Është vështirë të ecësh në këtë rrugë por Agim Bajrami tashmë udhëton i sigurt nëpër të.

Një element tjetër që vihet re te kjo

poezi, është edhe kontrasti i brendshëm poetik, i cili shfaqet si një element stilistikor frekuentiv. Ky element na vjen shpesh si një lojë e zhvilluar midis dy vargjeve në kundërvënje harmonike të njëra tjetrës.

"Më masin kohën sa jam gjallë
Më ndjellin kohën kur do vdes." (Orët)
Apo:
"Që unë të bëhem sy e veshë
Dhe ti të bëhesh veshë e sy." (Gjeste dashurie)

Nëpërmjet këtij elementi, autori përdor "erashkën" për t'i bërë freskë poezisë së tij. Këto janë teknika të thjeshta, por të përvetësuara e të përdorura shpesh nga një autor dhe përbëjnë pjesë të fondit të tij poetik dhe bëhen element të pasaportës së tij identitare.

Hapësira e përshkrimit poetik tek Bajrami është gjithashtu një tjetër element stilistik nëpërmjet të cilit ai rrok gjithësinë brenda një momenti të caktuar, qofshin këto në rrafshet sociale apo individuale. Ky lloj këndvështrimi zë vend të rëndësishëm në krijimtarinë e tij dhe formon një nga tiparet stilistike më të dallueshme.

"Padashur duart tona
U prekën paksa lehtë
Pranë teje unë mësova
Se si lindin rrufetë." (Padashur)
Në këtë relacion, prejke duarësh - lindje rrufesh, autori demonstroi hapsirat e tij shpirtërore, të cilat trasmetojnë ndjesinë refraktare të shkaktuar nga një çast erotik sublim. Këtu shfaqen hapsira të gjera të demonstrimit shpirtëror e mbi të gjitha, heshtja lirike përzier me përvuajtjen e thellë të mungesës. Në këtë mënyrë, Bajrami, krijon një univers shpirtëror të dualizuar me ndjenjën dhe aktin e saj dramatik ç'ka aktivizon fuqishëm "syrin e ciklonit" dhe poezia mer gravitet, bëhet e qartë e perceptueshme, e ëmbël dhe mjaft sensible.

Një ikje pa kthim koke
Dhe pa asnjë shpjegim
S'e di, s'e di akoma
Ç'ish gjithë ai zemërim? (Lulja "mos më prek")

Metafora te Bajramit është një tjetër burim energjie, një "superstrukturë" e rëndësishme e krijimtarisë së tij, për të cilën kan folur e komentuar studjues të ndryshëm të poezisë së tij. Ajo është e freskët, origjinale dhe mjaft funksionale, por unë do evidentoja faktin e aktivizimit të saj në ca momente të veçanta, atëhere, kur ai i këndon (vajton) ikjes, largimit, ndarjes, braktisjes. Pikërisht në këto momente, metafora e tij mer dritë hënore e shfaqet me gjithë shkëlqimin e saj verbues:

"Nga ky shkak zogjtë kanë ikur larg,
Kanë marrë me vete dhe foletë." (Lirikë e djersitur)

Apo:
Unë sytë e mi i kam bërë kishë,
Ku vijnë të falen orët e mallit. (Mungesë)

Së fundi, duhet theksuar edhe faktin se poezinë e Bajramit e gjallon një unitet i brendshëm, një shtjellë logjike që bazohet mbi parimin e kronologjisë së veprimit apo rrjedhës dinamike të saj. Kjo është tregues i pjekurisë artistike të autorit, pjesë e pjekurisë së tij profesionale. Shpesh kjo poezi shfaqet si një pentagram i mbushur me nota të trishtat muzikore që kumbojnë, duke fshikur ëmbëlsisht shpirtrat e lexuesve si një fillad i freskët pranveror. Është simfonia poetike e tij dhe pikërisht këtu qendron edhe një nga arësytet e përhapjes masive të kësaj poezije dhe të reflektimit të menjëhershëm të lexuesit ndaj saj. Dhe natyrisht, për të gjitha këto, poezia e Agim Bajramit, duhet konsideruar një kapitull i nderuar i letërsisë së sotme shqipe.

MURE

Sa shumë kisha për të të thënë
sikur të mos m'i frikësonin fjalët
ata...

Më duhet t'i mbaj në duar
muret e plasaritura të jetës sime

Vonë është si duket
për mua
mbeta peng i kësaj bote
e sa shumë kisha për të thënë

KJO STINË

Kjo stinë seç më kujton
pamundësinë
për të jetuar të bukurën

Jam si zogjtë që nuk arritën
të rrisnin krahët
e që me grimca të vogla ushqimi
përpiqeshin të ngriheshin lart

KU NA SHPIE KJO RRUGË

Në pranverën e përgjakur të 99-tës
Veshur me rrobat e dhimbjes
Po ikja bashkë me njerëz të tjerë

E përhumbur
kërkoja një fytyrë
Koka më mbeti kthyer kah veriu
-O njerëz
ku na shpije kjo rrugë
A do të kemi rast t'i gjejmë ato kufoma
që lamë

ÇELËSI

Po ty kush do të të thërret
në emër
butësisht
për të të zgjuar nga gjumi

Fli e qetë
ndiqe erën e luleve në ëndërr
alarmi i telefonit është çelësi
që të kthen në zhgjëndërr

Ç'MË DUHET LIRIA

Të ndjej si kurrë më parë
Përmes qetësisë së varrit që dominon
Sonte në shtëpi

Vdekja jote athua kujt i dedikohet
A ka peshore ndjenjash diku
A ka peshore të jetës
Ç'më duhet liria
Sonte
Mua

MË LEJO

Më lejo sonte të dehem
Me kujtimin për ty
Përtej të pamundurës të arrij

Më lejo sonte një rrugë
Të pa arritshmes t'ia ndërtoj një urë
Më ndihmo
Kështu e pa krehur siç jam
Në këtë mesnatë
Të të takoj në parajsë

HARRESA

Do të bëhet mirë thonë
Ani pse ti ke humbur
Më të dashurin
(Dhimbjen tënde
Ata nuk e ndiejnë)

Befas të humba
Se Kosovës dikur
I duhej ta paguante lirinë
Me civilë të vrarë

Eh po ja që tani
Na harruan të gjallët
Mua për së gjalli
E Ty për së vdekuri

Si duket
Kurrë nuk iu ramë tamam

Neviana SHEHI

KAPITENI I ANJES

Anije e sapo kthyer nga një udhëtim i gjatë duket se ka gjurmë stuhish nëpër trup dhe vela të shqyera. Marinarët kanë zbritur në port për të pirë ndonjë birra me arragosta ose për të zënë ndonjë të dashur momenti. I ka lodhur rruga e gjatë dhe tashmë është koha për t'u argëtuar.

Është një port i shëmtuar, por ka shumë femra të bukura dhe ata duan të harrohen disi. Vetëm kapiteni s'ka zbritur. E shoh fytyrën e tij të ashpër përkulur mbi një hartë të vjetër detesh. Mjekra e bardhe dhe sytë e picërruar i dallohen menjëherë.

Kërcasin valët nën bashin e lartë dhe zogj kureshtarë i qëndrojnë mbi supë. Ai sheh diku mes ajrit për të dalluar ndonjë të njohur, por në breg s'duket kush. E njohura e tij e fundit në këtë port ishte një brune e gjatë me flokë të lëshuar që vetëm qeshte dhe tymoste cigare të lira.

- Vetëm ky më ka mbetur besnik, thoshte teksa priste prej tij përqaftimet. - Burrat që kam njohur në jetë ju kanë ngjarë valëve. Vijnë vetëm njëherë për t'u ledhatuar me ty pastaj zhduken. Pas tyre vijnë valë të tjera, ndërsa ti duhet vetëm të presësh ardhjet e tyre.

Sa bukur fliste dhe qeshte shejtania.

Befas ndjeu dëshirën për t'u takuar dhe bërë dashuri sërish me të. Por, u kujtua se ajo s'jetonte më dhe se kish vdekur nga një sulmi i papritur në zemër, duke marrë me vete në atë botë edhe një pjesë të imazhit të tij të ashpër. Kapiteni psherëtiu dhe nisi të tymos thellë.

-Ne takohemi vetëm një herë në jetë me dikë për t'i dhënë njeri tjetrit copa të tëra jete. Përtej kujtimeve ekziston vetëm toka e askujt.

Duke zbritur shkallën e fundit dëgjoji zërin e butë të një gruaje që e thërriste. Ai mbylli kujtimet dhe u nis drejt saj...

MAGJITË E PËRKUNDJES SË ANIJEVE

Drita që lëviz nëpër damarët e ujërave, i zgjon varkëtarët nga gjumi i mesditës, kurse varkave të bregut ju qep mbi kyç nga një vel të artë në formë gjeithi. Kjo ndodh pikërisht në momentin kur pasqyrat e ujërave thyhen dhe një mërmërimë e thellë qenie misterioze bëhet mbizotëruese e bregut.

-Nga cilat tablo impresioniste duhet të ketë dalë kjo mbrëmje, nga Salvador Dali apo Pikaso? - më pëshpërit një zë i brendshëm.

S' përgjigjem, sepse unë mund t'i besoj vetvetes vetëm një metaforë perëndimi, ndërsa të tjerat ia besoj këtij peizazhi enigmatik.

Tërë pasditen ujërat dhe bregu grinden keq, kurse në mbrëmje ju ngjajnë të dashuruarve që vetëm këmbëjnë puthje njëri me tjetrin.

-Shëëësh, - mos i trembni magjitë e përkundjes së anijeve, as pikturën e shkëmbinjve të bregut në pritje të zbatcës, - sërish e dëgjoj atë zë të brendshëm, i cili më duket se vjen nga thellësitë e detit.

Dhe, pastaj ia beh perëndimi. Dhe bëhet mirë, mbase akoma më magjike, sepse yjet me siguri do të fyheshin nga mospasja mundësi të shndrisin qiellit të errësuar dhe të futen në ëndrrat e të rinjve, të cilët presin të marrin rrugën e të arrijnë në ujdhesën e të dashuruarve. Anija është gati dhe varkëtarët ngrenë spirancën e lëshojnë velat.

Dikush valëvit shaminë e përshëndet-jeve...



VARKAT ME DHIMBJE

Pasditja s'mund të vinte pa e ftuar që të zgjohet nga gjumi i thellë që e kishte kapluar pas një nate të rëndë dhe pritjes që hëna të çlirohet nga retë e zeza, të cilat e kishin futur në kurth nga të gjitha anët. S'mund të vinin as jehonat që kishin ngelur shkëmbinjve të thepisur, e as zërat e gjinkallave që dinë ta prishin monotoninë e pasdites.

Në ajër kishte ende fonema të mbetura nga zëri yt i bukur. Të kisha porositur të mos luaje me cicërimat e zogjve të mesditës, as me hapat e ndrojtur të peshkatarëve, sepse ata gjithmonë i besojnë joshjeve të hapësirave...(të pata thënë se kam një hapësirë në shpirtin tim, në të cilën lëviz vetëm ngrohtësia jote), ndërsa unë përtyppja diçka nga buzëqeshjet e tua të mbetura gjithandëj nga kishim ecur bashkë me hije tona, nga të martat që ishin pa diell, por me zagushi, nga të mërkuarat pa hije dhe të shtunat pa shitës ambulant.

Derisa qëndroj duke pritur që dita t'ia lëshojë vendin natës, ndjej se valët sikur dorëzohen para këmbëve të mia dhe bindem se detit tim i mungojnë varkat e mbushura me dhimbje, që bartin dashuri të plagosura...

UDHËTIMI

Në rrugën drejt viseve të mia të përtej detit, njerëzit që takova mbanin në duar nga një erashkë verore dhe nga një algë të tharë nga vapa. Shumica kishin dalë nga hijet e tyre dhe shenjta e dritës vetëm sa ju shkaktonin alergji në lëkurë.

-Mirë se erdhe në vendin e hijeve, - më pati thënë kapiteni i anijes, me të cilin po udhëtonim.

Në atë vend distanca mes tokës dhe diellit ishte më e largët se kudo tjetër, e megjithatë bënte nxehtë, shumë nxehtë.

-Kjo gjë na ndihmon t'i avullojmë mendimet, - pati folur sërish kapiteni.

Herë - herë frynte një erë e butë. Pulëbardhat në çast ngriheshin nga vetmia e tyre për t'i zgjuar varkëtarët që kishin mbetur, sepse, siç thoshte kapite-

ni, varkëtarët këtu i hanë dallgët ose i ha bregu matanë.

Atje dukej se të gjithë diejt qëndronin me një këmbë mbi tokë, e me këmbën tjetër andej përtej dallgëve, përtej sirenave dhe këngëve të tyre joshëse.

Çdo mbrëmje binin ca shira të çuditshme dhe fill pas tyre njerëzit merrnin trajta lilliputë. Pikërisht këta mbanin erashka verore dhe alga të thara. Udhëtimi akoma nuk ka përfunduar...

MËNGJESI NË PORT

Mëngjeset e mia janë dy krahe të bukur drejtuar nga deti dhe një pafundësi petalesh të bardha, si ftesë për përqaftim në çastin kur dielli zgjohet nga përgjumja dhe i vendos atij mbi ballë një kravatë të artë. Ky është çasti kur edhe valët nisin para meje vallëzimin e tyre ekzotik.

Një muzikë e çuditshme zgjohet nga thellësitë që më bën edhe mua të lëviz.

Mëngjeset vijnë gjer në lartësinë e kraheve të mi, duke më prekur butësisht fustanin të gjithë të artë me nuanca të kaltër rreth trupave dhe me një shije molusqesh të veçantë.

Trupi im drithërohet nga prania e tyre. Dikush ka ardhur nga larg, nga brigjet përballë, sepse ka dëgjuar për kujtimet e mia të dikurshme. Një përqaftim me to është më tepër se mall.

Edhe pse me sy të mbyllur nga drita e lindjes, i njoh ato. Janë shoqet e mia të kthyer në valë. Përlotemi dhe rrimë kaq kohë të përqaftuar, ndërkohë që horizonti vijon të digjet dhe anijet që kalojnë pranë nesh ju bien sirenave me tinguj të butë. Ky është një moment që nis të mendoj për rilindjen e jetëve dhe hedh përmbi trup një pelerinë enigmatike.

Anijet largohen duke marrë me vete një pjesë të mëngjesit dhe kraheve të mi drejtuar nga to si peng detar.

NATA

Cipa e tejdukshme e ditës në perëndim, dalëngadalë po i falet mbrëmjes. Banorët e territ, lakuriqët e natës, zogjtë dhe

pemët nëpër trotuare, i ndryshuan trajtat dhe emrat e përveçëm. Vetëm njerëzit lëvizin të humbur në vetminë e tyre.

Qyteti dhe deti tashmë janë nënshkrues të një pakti. Tërë natën deti do të bëjë muzikë dhe qyteti do të gërhasë dhe ëndërojë nën ritmet e tij. Më pëlqen ky pakt. Pa frymëmarrjen e detit asnjë muzikë nuk mund të ketë kuptim. Apo më saktë, nuk mund të shpjegohet...

Në mbrëmje, peshkatarët e deteve të largët më dhuruan një peshkaqen të vogël. Ishte një vogëlush deti që iu kish ikur prindërve dhe kishte rënë në rrjetë. Oh, më dhimbsej si përpëlitej. Ju thashë peshkatarëve: nuk e dua, kthejani detit dhe valëve, sepse toka dhe peshkaqenët kurrë nuk e kanë duruar njeri tjetrin. Janë dy materie të ndryshëm, skaje të të njëjtit segment, por në kahe të ndryshëm. Iki që andej, duke e lënë portin, i cili pret të kthehet edhe ndonjë anija e humbur.

Tani që po lëshohet nata, më pëlqen të jem shok me vetminë, më pëlqen t'i mbylli sytë dhe t'i ftoj ëndrrat...

PSHERËTIMË BREGU

Të gjitha historitë e mia me ty janë të tretura brenda tyre dhe kanë të njëjtin subjekt malli. Mëngjeseve kur ti del të më përcjellësh, buzëqeshja e përmalluar prej burri bëhet prolog. Vijimet e tjera janë të ngjashëm nga dita e parë deri në fundjavë.

Ndërsa unë largohem pak nga pak prej teje, ajo buzëqeshje do zhbëhet ngadalë për t'u shndërruar më pas në një psherëtimë të shqetësuar burri, e njëjtë me psherëtimën e bregut kur ndahet me varkën e tij të preferuar.

Ajo varkë do të udhëtojë nëpër dete të gjerë dhe nuk i dihet asnjëherë kthimi. Natyrisht, e kuptoj psherëtimën e tij, por nuk e kuptoj krahasimin. Kthimet e mia do të jenë të lumtura në çdo perëndim dielli dhe në çdo mbrëmje sërish do jemi bashkë, duke rrufitur çajin e mbrëmjes dhe duke folur për ditën e nesërme. Gjithmonë përtoj ta pi gjer në fund çajin...

JORGE LUIS BORGES

LEGJENDË

Abeli dhe Kaini u takuan pas vdekjes së Abelit. Po ecnin në shkretëtirë dhe e dalluan njeri-tjetrin që larg, pasi të dy ishin shumë të gjatë. Të dy vëllezërit u ulën përdhe, ndezën një zjarr dhe filluan të hanin. Qëndronin në heshtje, në heshtjen e njerëzve të lodhur kur perëndon dielli. Në qiell shfaqej ndonjë yll, që ende nuk kishte emër. Në dritën e zjarrit, Kaini vërejt shenjën e gurit në ballin e Abelit dhe lëshoi nga dora bukën që po e çonte në gojë e i kërkoi t'ia falte krimin.

Abeli u përgjigj:

- Më ke vrarë ti mua apo unë ty? Nuk më kujtohet; tani jemi këtu së bashku, si dikur.

- Tani e kuptoj se vërtet më ke falur, - tha Kaini. - Sepse të harrosh, do të thotë të falësh. Edhe unë do të mundohem të harroj.

Abeli tha ngadalë:

- Ashtu është. Sa kohë zgjat brejtja e ndërgjegjes, zgjat edhe faji.

KURTHI

Që tmerri i tij të ishte i përsosur, Qezari, i rrethuar tek këmbët e statujës prej thikave të ngutshme të miqve, mes fytyrave dhe teheve zbulon atë të Mark Brutit, të përkrahurin e tij, ndoshta birin e tij, dhe atëherë dorëzohet e thërret: "Edhe ti, biri im?!" Shekspiri dhe Kevedoja e kanë rrokur këtë klithmë patetike.

Fatit i pëlqejnë përsëritjet, variantet, simetritë; nëntëmbëdhjetë shekuj më vonë, në jug të provincës së Buenos Airesit, një fshatar sulmohet nga disa fshatarë të tjerë dhe, kur rrëzohet, njih birin e tij të adaptuar dhe, me qortim të butë dhe habi të plogët, i thotë (këto fjalë duhen dëgjuar, jo lexuar): "Pero che?!" ("Edhe ti, ore?!")

E vrasin dhe ai nuk e di se po vdes që të përsëritet një skenë.

(Përktheu Erion Karaballi)



THJESHTËSIA

Për Haydee Lange

Porta e kopshtit është hapur
aq lehtë sa faqja e kthyer
e hetuar nga devocioni i rregulltë
dhe pasi të hysh brenda, kundrimet tona
s'kanë nevojë të fiksohen në objekte
që tashmë ekzistojnë plotësisht në kujtesë.
Jam i mësuar me zakonet dhe shpirtërat
dhe me atë dialektikë aluzionesh
që çfarëdo tubimi i njerëzve thur.
Nuk kam nevojë të flas
as të pretendoj privilegje të rreme;
ata që më rrethojnë këtu më njohin mirë,
ma njohin mirë dhembjen dhe dobësinë.
Kjo është për të arritur gjënë më të lartë,
që ndoshta do t'na jepet nga Parajsa:
jo nderim ose ngadhënjime,
por thjesht për t'u pranuar
si pjesë e një Realiteti të pamohueshëm,
sikur gurët dhe pemët.

UNË JAM

Unë jam ai që njih veten jo më pak të kotë
se shikuesi i kotë i cili në pasqyrën e
xhamtë dhe të heshtjes ndjek pasqyrimin ose
trupin (është po e njëjta gjë) e vëllait të vet.
Unë jam, miqtë e mi të heshtur, ai i cili di
se nuk ka falje ose hakmarrje më të madhe
se harresa e plotë. Zoti na ka dhuruar këtë zgjidhje
të çuditshme ndaj të gjitha urrejtjeve njerëzore.
Përkundër bredhjeve të mia të mahnitshme të shumta,
unë jam ai që kurrë nuk e ka zgjidhur
labirintin e kohës, njëjës, shumësin,
ndëshkimin, të pashpjegueshmen, e vetvetes dhe të tjetërkujt.
Unë jam askushi. Unë nuk e kam përdor shpatën
në betejë. Jam jehonë, boshllëk, hiçgjë.

Përktheu: Fadil Bajraj

KANGA SKANDALOZE

Njerëzit lindin dhe vdesin, koha ecën përpara e matur me numrat që ne kemi krijuar për të perceptuar lëvizjen e sajë monotone mbi këtë planet ku koha duket po e njëjtë

(Hamdi) Erjon MUÇA

Fizikanti i madh dhe një nga kozmologët me të mëdhenj të botës, Stephen Wiliam Hawking e kaloi thujtë të gjithë jetën në kërkimin e një teorie të të gjithës: kërkoi të gjejë ekuacionin perfekt për të shpjeguar universin. E mrekullueshme apo jo?! Një ekuacion elegant, i shkurtër, që shpjegon lindjen, jetën dhe pse jo vdekjen e universit. Hawking nuk e gjeti, ndërsa përta i përket poezisë, Migjeni e kishte gjetur ekuacionin e vet: gjithçka zbërthehet me anë të titullit...

Me anë të kësaj metode do të merremi me poezinë "Kanga Skandaloze". Fjalë kangë me gjasë Migjeni e ka shtuar më mbrapa këtë term, pasi për kohën, nëse botohej me titullin "Skandaloze", do të kish qenë një tërmet social, kurse me shtojcë në fillim dukej më e kamufluar; domethënë është poezia një kangë skandaloze dhe jo subjekti...

Mbiemri skandaloze rrjedh nga skandal, dhe në gjuhën amë të vetën ka tre kuptime.

1: Turbullim i ndërjegjes kolektive nga një ndodhi, sjellje, ose fjalim që ofendon principet morale korrekte. 2: Me vlerë më të theksuar e konkrete, veprë ose veprim që ofendon shijen e mirë, sensibilitetin ose ndjenjën e turpit me anë të një moskokëçarie dhe lirije të tepruar. 3: Reklamim i padëshiruar, tronditje rreth një ngjarje të turpshme.

Një murgeshë e zbetë, që bashkë me mkatet e botës

bar dhe mkatet e mia mbi supat e vet të molisun,

mbi supat e verdhë si dylli që i ka puth hyjnia

- kaloi rrugës së qytetit si ejll i arratisun...

Për Migjenin kjo lloj situatë është skandaloze. Njerëzit lindin dhe vdesin, koha ecën përpara e matur me numrat që ne kemi krijuar për të perceptuar lëvizjen e sajë monotone mbi këtë planet ku koha duket po e njëjtë. E përpos të gjithë kësaj tymnaje të ngritur nga këto numra, koha duket sikur ka ngecur në vend.

A nuk kishte në paganizëm priftëresha, murgësia të virgjëra, të tempullit të Dianës, Afërditës, Apollonit e kështu e me radhë?! A nuk mendonin ato se sakrificat e tyre ishte pjesë e një detyrimi moral ndaj njerëzve, të afërt dhe të largët, ndaj botës, që po sipas mendimit të tyre, kishte mjaft nevojë për këtë sakrificë?! E, a nuk mendonin ato se me anë të kësaj sakrifice po mbanin mbi shpatulla fatet e njerëzimit?!

Ja pra pikërisht këtu qëndron skandali. Skandali qëndron te keqpërdorimi i besimit dhe bindjeve! Te rëndësia që ne i japim veprimeve tona kundrejt atyre të tjerëve. Te përvullësia fiktive, e jo të gjithave, por vetëm të një pjesë të humanëve që me anë të veshjes duan të shesin njeriun. Pikërisht fraza e fundit: si ejll i arratisun, këtë aspekt ka dashur të tregojë; mendjemadhësinë fshehur pas gjoja përvullës, përvullësimit, përvullësies. Skandaloze, për Migjenin, nuk është më pak kjo skenë se sa shumë skena të tjera të jetës së përditshme njerëzore. Nuk përbën ndonjë skandal të madh mosbesimi, por besimi pompoz, ai duhet të përbëjë skandal. Kjo është skandaloze; mos ndryshimi, por vetëm riciklimi i të vjetërës me veshje të reja... Prandaj vargu i parë që nëse e lidhim me artin hermetik, nga një murgeshë e zbehtë, mund të komentohet: në qenie njerëzore skandaloze...

Një murgeshë e zbetë, e ftohtë si rrasa e vorrit,

me sy boj hini si hini i epsheve të djeguna të gjallesës,

me buzë të holla të kuqe, dy gajtana psherëtimet që mbysin

- ma la deri vonë kujtimin, kujtimin e ftohtë të kalesës.

Skandaloze kjo qenie njerëzore që duket sikur nuk ka asgjë të njerëzishme brenda vetes; megjithëse si të gjitha femrat e kësaj bote ka organe femërore dhe cikle natyrale të rregullta. Ka nevoja prej mishi, më tepër se sa prej shpirti, të cilat i ka mbytur për hir të këtyre të dytave. A nuk shkruhet në bibël: dashurohuni, martohuni dhe shtohuni?! Kjo sjellje prej martireje, vullnetare, a nuk përbën një lloj fyerje për vetë thelbin e besimit të Zotit i Abrahamit?! Kur i pyet njerëzit e fesë se përse nuk martohen priftërinjtë katolikë apo për vetësyrgjynosjen e murgeshave, dhe të murgjve, ata të përgjigjen se gjithçka e bëjnë ngaqë Jezu Krishti nuk u martua. Ama, ai nuk kërkoi që njerëzit të mos martoheshin në nder të tij. Nuk ka shenjtore pa të shkuar dhe mëkatore pa të ardhme...

E mrekullueshme është se si përshkruan me imtësi çdo detaj njerëzor të shtypur nën një regjim të pakuptimtë kastiteti. Hiri i ndjesive njerëzore që kushtëzon ngjyrën e syve, pasqyrën e shpirtit, siç thonë poetët. Buzët e kuqe që në vend të thithin të gjithë nektarin e mundshëm të kësaj jete të shkurtër, mbyten nën psherëtimat e një lufte të brendshme, të përhershme, mes fiktives dhe efektives. Një qenie njerëzore e mbytur, e shtypur, me ndjenja të vrara, të ndrydhura, për nder të shenjtërisë; një çmim i madh drejt ngadhënjimit; një kamuflim perfekt i mendjemadhësisë me anë të virtutshmërisë...

Në fund e përmbyll me një metaforë hermetikisht të mrekullueshme: Kujtimin e ftohtë të kalesës. Kujtimin e diçkaje të pa sens

që kaloi para vështrimit të tij dhe që i la një ndjenjë ftohtësie kuptimore?! Apo kujtimin e kohërave të kaluara, të largëta që duket sikur jetojnë në këtë lloj mendësie. E pra, e gjithë forca e artit hermetik nën penën e Migjenit duket aq e natyrshme, saqë në vështrim të parë të largon nga mendimi se ke të bësh me art hermetik. Vetëm me përdorimin në këtë mënyrë të fjalës kalesë, tregon për largpamësinë dhe ndjeshmërinë që Migjeni kishte në gjetjen dhe përdorimin e fjalëve. Sepse në këtë lloj forme, të paktën për këndvështrimin tim, duket si diçka që iku mjaft larg pa pasur më asnjë rrugë kthimi; e shkuara e ka një rrugë kthimi me anë të kujtimeve, e kaluara duket më tepër si term historik dhe sërish i mbetet rrugë kthimi, por kalesa jo, pasi rrokja "esa" në fund të sajë të sjell në mendje fjalën harresë...

Prej lutjesh (jo tallëse!) duel dhe në lutje prap po shkoll...

Lutjet i flejnë gjithkund: ndër sy, ndër buzë, ndër gjishta.

Pa lutjet e saj bota, kushedi, ç'fat do kishte?

por dhe nga lutjet e saj ende s'i zbardhi dita.

E pra është skandaloze që qenia njerëzore, e pajisur me tru; organ që ka veti asimilimi dhe zhvillimi të ideve, eksperiencave, të kalojë jetën e vet në mënyrën më inaktive të mundshme; duke u lutur. Për çfarë lutet?

Koha në të cilën Migjeni e shkroi këtë poezi ishte perverse; një Shqipëri e sunduar

nga injoranca kolektive dhe e qeverisur nga mediokriteti, ndaj edhe ai shpejton të fusë në kllapa, që në vargun e parë togfjalëshin; jo tallëse, me një pikëçuditëse në fund. Duket si gabim drejtshkrimor ose alterim i rregullave, por ky alterim ka dy funksione, i pari atë të jopërgjithësimit kategorik dhe i dyti, pak më i fshehur, të habitës. Sot ajo pikëçuditëse ka kuptimin e fjalës sandalozë. Sepse është me të vërtetë skandaloze që njeriu zgjohet me lutje, pasi është lutur pak përpara se të flejë...

Skandaloz është fakti që këtyre lutjeve, njerëzit u japin një rëndësi më tepër se jetike. Migjeni në fund shkruan që edhe pse këta luten për botën mbarë, ajo, bota njerëzore dhe jo planeti Tokë, po e njëjtë ka mbetur, e vjetër, skandaloze, në modernizim e sipër, me spirancë të ankoruar thellë në brigjet e të dhunshmes, intolerantes, të së vjetrës së kamufluar në të re...


(...)

Unë dhe ti, murgeshë, dy skaje po të njëjtit litar;

të cilin dy tabore ia ngrehin njeni-tjetrit lufta asht e ashpër dhe kushedi se ku do të dali

prandaj ngrehet litari dhe përplasen njerëzit...

Në strofën e fundit Migjeni heq dorë nga thirrja dhe me forcën e njeriut inteligjent, liberal, njeriut që ndien se ka humbur përballë egoizmit idiot njerëzor, sikur dorëzohet, pasi e kupton që është një luftë, të cilën ai nuk mund ta fitojë, një luftë e humbur që në fillësë, nis dhe bën një analizë. Analizë e mrekullueshme në vargje, në të cilën vetëm me pak fjalë ndjen dhimbjen, habinë, vuajtjet që një ndërjegje e lartësuar provon kur analizon realitetin e përbindshëm njerëzor. Njerëzit të njëjtë, por të ndryshëm; një ndryshueshmëri e dhunshme e pamëshirshme. Skaje të të njëjtit litar; është me të vërtetë një shprehje e marrë na "Kështu foli Zarathustra", por sipas meje këtu ka një përdorim ndryshe. Litari është lidhja gjenetike njerëzore, ndërsa skajet janë kundërshtitë kuptimore, mënyrat e ndryshme me të cilat njerëzit i përqasen jetës. Madje, edhe murgësia është përdorur në këtë kryevepër; e kundërta absolute e Migjenit; besuese me verbëri absolute, femër, ndërsa Migjeni ateist mashkull. Të dy pjesë e litarit të gjatë të evolucionit njerëzor, por ndarë nga përkatësia seksuale dhe orientimi i besimit; besues dhe ateistë. Një luftë e përhershme që ka sjellë vuajtje dhe viktima të shumta, nga të dyja krahet, ndër shekujt që kanë përcjellë ekzistencën njerëzore. Një luftë në zhvillim e sipër edhe për mjaft kohë do sjellë dhunë dhe vdekje mbi tokë. Migjeni jetoj në periudhën e ngritjes së bolshevizmit; të hakmarrjes idiote ateiste, e cila i bashkoi martirë të tjerë human botës së përgjakur njerëzore. Si vëzhgues i mirë e qenies njerëzore, duket sikur jep një parashikim; nuk jep një ekuacion shkencor me një përfundim strikt, por një përfundim në infinit; një nga ata lloje përfundimesh që makinat llogaritëse i ndalin te tre apo katër numra pas presjes... Makinat llogaritëse nuk janë programuar për të vijuar në infinit. Nuk ka se si të përlogarisë botën në të cilën jeton njeriu; njerëz që armatosin njerëz për të vrarë njerëz. Migjeni jetoj në një periudhë ku mbizotëronte dydimensionaliteti; akoma nuk qe zbuluar tredimensionalja, ndaj ai mbështet tek litari me dy skaje. Shkenca evolui dhe na tregoi se monedhat mund të kenë edhe fytyra të fshehura përpos dy të dukshmeve. Njeriu ka dorën që ledhaton, dorën që godet dhe gojën me dhembë të mprehtë me të cilën kafshojnë; nuk i jemi larguar edhe aq shumë botës kafshërore ndaj nuk ka se si ta kemi harruar kafshimin...



Të shkruash në ekran

FILMA FRYMËZUES PËR GRA SHKRIMTARE DHE GAZETARE

Filmat në fjalë shfaqin një portretizim të plot grave të apasionuara pas të shkruarit, por jo gjithmonë ia qëllojnë. Ato nuk janë shkrimtare me superfuqi, por as amatore



Nada DOSTI

Në internet mund të gjenden plot filma dhe seriale rreth shkrimtareve dhe gazetarëve, por këtu do të flasim vetëm për filma të këtyre viteve të fundit dhe që janë të gjindshme lehtësisht nëpër platformat e sotme digjitale. Filma të tillë mund të jenë frymëzues sado pak për shkrimtarët e reja në karrierë, por jo vetëm.

Filmat në fjalë shfaqin një portretizim të plot grave të apasionuara pas të shkruarit, por jo gjithmonë ia qëllojnë. Ato nuk janë shkrimtare me superfuqi, por as amatore. Ato janë plot talent dhe që përpiqen vazhdimisht, edhe pse dështojnë herë pas here ato rikthehen në terren më të forta se kurrë.

INVENTING ANNA (Të sajosh Anën), prodhimi i Netflix-it i vitit 2022. Seriali me një sezon të vetëm, është përshtatur nga një histori e vërtetë, dhe flet për një gazetare e cila heton se si Anna Delvey e mashtrroi shoqërinë e lartë në Nju Jorku, duke u hequr si dikush që nuk ishte në të vërtetë. Vivian, gazetarka në fjalë, vendos të shkruajë një artikull hulumtues në lidhje me mashtruesen Ana. Projekti i saj zgjat me muaj të tërë dhe përfshin vizita të shumta, intervista, pjesëmarrje në dëgjesa të gjykatës, deri në një udhëtim përtej kontinentit për të takuar familjen e Anës në Gjermani. Gjatë kësaj kohe, Vivian është shtatzënë dhe lind fëmijën e saj, por gjatë gjithë serialit asaj i përsëritet refreni se ajo nuk është e

veçantë dhe nuk duhet ta konsiderojë veten të veçantë vetëm e vetëm se mbart një fëmijë në bark, kur nëpër botë, brenda një sekonde me mijëra gra sjellin në jetë fëmijë. Pavarësisht presioneve të shumta, lodhjes, zhgënjimeve, peripecive të shtatzënisë dhe lindjes, Vivian arrin ta çojë tregimin e saj deri në fund, dhe artikulli i përfunduar është i mrekullueshëm.

THE BOLD TYPE (Racë e fortë), gjithashtu prodhim Netflixian, i vitit 2017 dhe kategorizohet në zhanrin komedi-dramë me pesë sezone. Seriali flet për një trio vajzash të gjeneratës së re, të cilat kanë pasione të ndryshme, por të përbashkët faktin se punojnë për një revistë për gratë me famë botërore. Personazhi kryesor, Jane Sloan, kalon sfida dhe peripeci të ndryshme, duke filluar profesionin e saj si një stazhiere e thjeshtë në rolin e asistentes derisa pastaj gjen zërin e saj si shkrimtare me famë deri në çmime, rritje në detyrë dhe suksese të tjera. Gjatë serialit, thuhet në fund të çdo episodi do të dëgjoni shkrime fantastike të lexuara nga zëri i vetë personazhit kryesor teksa ajo gjendet para kompjuterit të saj, duke lexuar artikujt e shkruar plot gjenialitet, ku theksohet dukshëm përmirësimi i stilit të saj.

NOT DEAD YET (Ende s'kam vdekur) është një serial i gjindshëm në platformën Disney plus që prej shkurtit të këtij viti. Personazhi kryesor, Nell Serrano, gazetare, e cila punon për të rifilluar jetën dhe karri-

erën që la pas dhjetë vjet më parë. Në çdo seri, asaj i caktohet një personazh i famshëm i vdekur për të shkruar një nekrolog (një formë gazetareske për të folur për jetën e personazheve të famshme jo si biografi, por si një artikull me nota letrare) dhe sapo asaj i caktohet detyra e re, papritmas i shfaqet personazhi ose personazhet rreth të cilëve duhet të shkruajë. Kështu, ajo e gjen veten duke komunikuar me këtë njerëz të vdekur, të cilët e ndihmojnë jo vetëm që të rritet profesionalisht në karrierë, por edhe të përmirësohet si njeri. Të vdekurit në fjalë e ndihmojnë t'i japë atë çka i mungon shkrimeve të saja dhe nga seria në seri dallojmë një përmirësim të stilit të saj në të shkruar dhe zbulimit të këndvështrimeve të reja për të publikuar artikujt e rinj.

GINNY& GEORGIA, seriali netflixian i vitit 2021, i cili në fakt nuk flet për rrugëtimin e një shkrimtare, por që në periferi të filmit ka disa momente të vogla ku shfaqet pasioni i Ginny-t për të shkruar. Ajo nis me disa rrëfime të vogla në ditarin e saj, me një klub për lexim dhe shkrimtari, iniciativa gjatë orës së letërsisë për të diskutuar tema të ndjeshme në letërsinë amerikane, si dhe performanca e saj e suksesshme në një shfaqje ku ajo para publikut interpreton një poezi të saj. Poezi është shumë e fuqishme dhe i gjithë thelbi i asaj është se ajo ndihet e lodhur, duke mos pasur zë dhe gjithashtu e lodhur duke luftuar në heshtje:

A mos jam e madhe tashmë për t'u fsheh poshtë krevati?

*Kam ngecur në një stuhë
Por stuhia është në kokën time
Gjithçka shoh janë vetëtimat
Gjithçka dëgjoj janë bubullima
Shpërthim pas shpërthimi, dikur
isha e verbër por tashmë shoh
Palosjet e syve më kanë hapur sytë
tashmë*

*Por përpiqem sa mundem t'i mbyll
sytë*

*I shtrëngoj fortë për t'u rikthyer në
errësirë. Tek mosnjohja, tek besa
Sepse tani që njoh e di se çfarë
duhet të bëj për ty*

*Ajo në të cilën më ke kthyer
Do jepja gjithçka për ta larguar prej
vetes*

*Zhgërrij e zhgërrij për ta
larguar atë drejt njolle*

*Por s'mund të largohet një tatuazh
Sepse siç e sheh, edhe unë jam
fajtores tashmë*

*Gërrij, gërrij e zhgërrij derisa
të rikthehem e njomë*

*Telat e zërit tim dridhen
Me të vërteta vicioze dhe jetike*

*Se duhet të flas
Dhe ti duhet të dëgjosh
Gjuha ime duke valëzuar
Me plagën e paçbëshme të heshtjes
Por zëri më ngec në fyt
Gëlltis poshtë një grumbull që mezi
gëlltitet*

*Thonë se nënat e dinë më s'miri
Po por sikur të ketë gjëra që nënat
s'dinë*

*Si puna e gërshetave
Ti gjithmonë thua se jam pasqy-
rimi yt*

*Por s'mund të fshihem pas
buzëqeshjes tënde*

*Dhe prej këtu ku unë qëndroj
Jemi në kënde të kundërta të
pasqyrës*

*Unë dhe ti kundër botës?
Por bota ka ardhur të më zërë
Në mënyra që ti kurrë s'mund t'i
dish dhe ndjesh*

*E nga ta dish ti pra çka është e
vërtetë?*

*Jam lodhur duke vuajtur në heshtje
Sot do përplas këmbët, do bërtas
dhe do bërtas*

*Derisa çdo fjalë brenda meje të dalë
jashtë*

*Vetëm duke ditur, duke parë
Kjo që marrëveshja ime
Duart e mia të lagura, dikur të
pastra*

*E ndyrë me mëkate, s'e kam fjalën
Fjalë që s'i thashë kurrë, dragonj që
s'vrava dot*

*E trashëgova mëkatin
Duke u kthyer në një përbindësh
Prej nga kam lindur...*

Në shiritin e kohës

VITA ACTIVA


Leximi i biografisë politike të Z. Adem Demaçit na kthen në një periudhë kohore të zymtë, të hirtë, të pa shpresë që do të donim sa më parë të harronim. Por, nuk duhet harruar faktin se burgosjet e tija ishin në korrelacion të drejtpërdrejtë me kauzën shqiptare

Arbën XHAFFERI

Është punë shumë delikate të shkruash biografinë e një personaliteti, veçmas atë politike, ngaqë në këtë fushë, si askund tjetër zhvillohet beteja me oponentët me tërë qenien e njeriut, intelektin, moralin, dinakërinë, hipokrizinë, vizionin e tij, vendosmërinë, kapacitetin për vendimmarrje, paragjykimet, egon dhe superegon e tij. Në veprimtarinë politike ndikojnë shumë faktorë, shpeshherë edhe irracionale që vështirë dekodohen. Librat e kësaj natyre në radhë të parë flasin për personalitetin, jeta dhe veprimtaria e të cilit është bosht i librit, pastaj për shoqërinë ku zhvillohet veprimtaria e tij, për rrethanat politiko-shoqërore si dhe për motivet e autorit të librit. Z. Shkëlzen Gashi me këtë libër, me këtë biografi politike të figurës emblematike të lëvizjes politike shqiptare në Jugosllavi, z. Adem Demaçi, dëshmon jo vetëm mahnitjen e tij me fenomenin, që shumë autorë e krahasojnë me atë të Mendelës, por edhe ofron informacione të sistemuara për një periudhë dramatike të historisë së popullit shqiptar.

Duke lexuar librin konstatohet lehtë se autori e ka ruajtur distancën ndaj emocioneve që shumica e shqiptarëve kanë ndaj figurës prometheike të z. Demaçi, të sfiduesit të rendit të ri shoqëror të sllavëve të jugut që i përthante kapacitetet e shqiptarëve. Autori, me këtë libër informon deri në detaje për jetën dhe veprimtarinë e z. Demaçi, por nuk komenton. Këtë kënaqësi ia lë lexuesit. Libri kushtuar biografisë politike të z. Demaçi në vete ngërthen shumë informata, të renditura kronologjikisht dhe të përkufizuara politikisht, kështu që shërben si libër bazë jo vetëm për njoftim me biografinë e këtij tribuni që shërbente si pishtar për orientim të saktë politik për shqiptarët në terrin jugosllav, por edhe për shoqërinë shqiptare, për vitalitetin e një populli që u bë kafshatë e pakapërdishme për hegjemonizmin serb. Rrëfimi për jetën dhe angazhimin politik të Demaçit është në fakt rrëfimi për veten tonë, për segmentin më fisnik të qenies sonë. Fragmente të një përvojë sublimë politike demaçiane, me siguri do të gjejë në vete dhe në rrëfimet familjare çdo lexues, por tërësia i takon vetëm atij, theomahut shqiptar që jetonte jetën sipas idealeve që vetë i krijoi.

Në këtë pikë dallon politika e Demaçit nga ajo, jo vetëm e politikanëve të tjerë shqiptarë, por në përgjithësi. Derisa politikanët e tjerë vizionet, idealet politike ofronin të tjerëve për realizim, z. Demaçi i mishëronte në vete, në jetën e tij, e cila u shndërrua në një sagë të Vetë Mohimit, ashtu si titullohet edhe një roman i tij. Filozofja gjermane me prejardhje hebraike, Hana Arend e përkufizon politikën si veprimtari e njerëzve të lirë, si Vita Activa, një angazhim aktiv i vazhdueshëm. Ky përkufizim i politikës plotësisht e shpjegon jetën dhe angazhimin politik të z. Demaçi. Nacionin njeri i lirë duhet kuptuar si liri prej çdo interesi. Duke lexuar librin për biografinë politike të z. Demaçi gjen argumente për këtë konstatim. Ai së pari e liron politikën nga vetja, nga interesi i tij vetjak, jo vetëm në kuptimin material, por shumë më thellë, në atë jetësor. Për ta mundur frikën, për të qenë sa më i lirë në vendimet e tija politike, ai kupton si rrallë kush, se, për të zhvilluar një politikë koherente duhet ta suspendohet vetja, të lirohet nga frika e vdekjes. Pas arriti ta "vrasë" instinktin për jetë, përkatësisht autoritetin e pakontestueshëm, Jetën, frikën nga vdekja, ai arriti të suspendojë çdo autoritet, qoftë ai konkretisht kërcënues, kriminal apo në trajtën e autoritetit moral. Ai, gjatë tërë jetës së tij vetëmohuese, disa herë i theu barrierat mentale të vendosura në qenien njerëzor nga frika e vdekjes, qoftë në ballafaqim me gjykatësit, me bandat paramilitare, ose gjatë bombardimeve të NATO-s kur e sfidonte kërcënimin me vdekje. Këtë ai e bënte pa



shtërzime, me një qetësi, urtësi tipike shenjtorësh. Në ato ditë të vështira dhe të rrezikshme, njeriu që e jetonte idealin e vet, refuzoi ofertën që të largohet nga Kosova, ose të ikë në zona më të sigurta dhe i dha detyrë vetes që dy herë në ditë të dalë të shëtisë në rrugët e Prishtinës. Ai këtë e bënte për të dëshmuar se liria buron në qenien njeriut dhe jo nga autoriteti i jashtëm, ashtu si edhe morali.

Vetëm njeriu i lirë (nga vetja) mund të shkojë deri në fund, vetëm ata që shkojnë deri në fund hapin shtigje të reja për realizim të idealeve për barazi dhe jetë dinjitoze. Këtë gatishmëri për të shkuar deri në fund, në planin ideologjik e përuroi z. Demaçi, ndërkaq në plane të tjera e vazhduan theomahët e tjerë në krye me Adem Jasharin: dy Adema, dy të parët të historisë moderne shqiptare. Vendosmëria për të shkuar deri në fund ishte mënyra e vetme e testimit të kapacitetit të regjimit të okupatorit, i cili me vrasje të pakontrolluara vendoste frikën në vetëdijen e njerëzve të rëndomtë që bënin çmos për të mbijetuar. Këtë test, si dihet, regjimi i degjeneruar militarist i Millosheviqit nuk e kaloi. Pasi e liron politikën nga vetja, z. Demaçi e liron atë edhe nga familja e tij, që detyrimisht bëhej peng i politikës së tij. Në këtë mënyrë ai u bë i pashantazhueshëm nga të gjithë, i lirë nga çdo autoritet dhe i gatshëm që të ballafaqohet me çdo problem. Hetuesve dhe gjykatësve që i bënin pyetje banale lidhur me shpërndarjen e trakteve ai përgjigjej duke hapur temën e vërtetë, aneksimit, okupimin e Kosovës. Këtë e bënte në të gjitha periudhat e historisë së Jugosllavisë së dytë,

pa marrë parasysh nivelin e trysnisë si dhe moshën e tij.

Edhe kur ishte i ri, i panjohur edhe kur u bë i njohur, ligjërimi politik i tij ishte i njëjtë: viset shqiptare në Jugosllavi duhet t'i takojnë Shqipërisë. Suspenduesi i vetvetes, Vet Mohimi, moralisht fitoi të drejtën për kontestim edhe të opsioneve të ndërkombëtarëve që i ndihmonin çështjes shqiptare. Këtu nuk duhet të krijohet konfuzion. Për të nuk ekzistonte asnjë autoritet, as jeta, pos lirisë së kombit. Ai ishte thellësisht i bindur se Kosova dhe viset tjera të Jugosllavisë, të banuara me shqiptarë, është e okupuar, se kryengritësit nuk mund të jenë në asnjë variant terrorist dhe se çlirim i plotë i Kosovës nuk ka alternativë. Pikërisht për këto bindje, ideale ai e nxori në rrah të goditjeve serbe jetën dhe lirinë e tij, mirëqenien e familjes së tij. Ai kështu kaloi 28 vjet në burg real, në kushte të rënda, duke e bindur veten dhe të tjerët se ideja e çlirimit është e mundshme. Tani, kur më në fund u hap kjo çështje, diplomatët, sado qofshin miq, kërkonin nga ai të pamundurën: ta mohojë atë për çka ai vuiri peng jetën dhe lirinë e tij. Ai hyri në këtë fushë të veprimit që të mos bëjë kompromise. Këtë e bënin të tjerët më mirë se ai, gjatë gjithë jetës së tij. Ishin të palogjikshme kërkesat që edhe ai të rreshtohet në këtë listë, aq më parë nëse merret parasysh se pakënaqësinë e tij e shfaqte me mjete demokratike, në mënyrë transparente dhe qytetëruese. Politika e kuptuar si vita activa, e shtynte atë që gjithmonë të ndërmarrë iniciativë, duke e vënë veten në pozita antagoniste me klasën politike që tregonte shenja të molisjes, të frikës, të

defetizmit, të humbjes së motivacionit. Këtë e bënte me devocion dhe pa motive hakmarrëse. Ai, politikën e vet arriti ta lirojë edhe nga urrejtja, nga hakmarrja. Këtë e dëshmonte si në raport me ish kundërshtarët e tij politikë, që mbase kishin gisht në burgosjet e tija, ashtu edhe në raport me shkaktarin kryesor të katandisjes së tij dhe të popullit shqiptar, serbët. Në momentin e antagonizmeve më të thella shqiptaro-serbe, kur urrejtja ndër-etnike pat marrë përmasa patologjike, ai i quante "vëllezër".

Këtë nuk e bënte me cinizëm, por me një ndjenjë humaniste, tipike për ata që janë burrëruar, që e mbrojnë tjetrin nga vetja. Popujt që i zbulojnë dhe jetojnë me këto vlera, lehtë gjejnë emër për këto virtyte. Nacioni burrë, pothuajse nuk ekziston në gjuhët e popujve të tjerë të botës. Biografia politike e z. Demaçi njëherësh është edhe rrëfim për popullin shqiptar, për misterin e mbijetesës së një populli që, sipas konstelacionit të forcave ka qenë i destinuar për zhdukje. Ai lindi në një familje me halle të mëdha, që ka përjetuar trerret e politikës ekspansioniste serbe, në një familje të braktisur edhe nga vetë zoti. Janë rrëqethëse rrëfimet e nënës së tij për vrasjen e xhaxhallarëve të saj, për gatishmërinë e shpërnguljes në Turqi, për vizitat në burgjet jugosllave për ta parë djalin e saj, i cili, në momentet kur mendohej se populli shqiptar ishte përfundimisht i gjuhëzuar, dërgonte mesazhe se kapitulli i historisë nuk është mbyllur, se ai, bir i një familjeje të plandosur nga barra, padrejtësitë e jetës, sapo ka nisur ta hapë kapitullin e ri historik, atë të kontestimit të Jugosllavisë, përkatësisht të një politike globale që e ringjalli këtë krijesë artificiale, e destinuar për shpërbërja që nga fillimi i formimit të saj. Por, dalja në skenë të theomahëve të këtij formati nuk mund të jenë rastësi, por janë farkuar në mikrostruktura morale që me shekuj kanë mbajtur gjallë dinjitetin e njeriut tonë, në kushte tejet të rënda. Kërkesës së Demaçit që nëna e tij të mos vijë në gjykim dhe në vizita, ngaqë do të mërzhitet, ajo përgjigjet: "Edhe në konop me të qitë, nana nuk jep pesë para". Shqiptarët që qenë të detyruar të pranojnë sundimin e huaj në territoret e tyre nuk kishin asnjë kapacitet tjetër për kundërvënien, pos atij moral.

Simbol i këtij kursi politik, që nuk frikësohej nga asnjë variant i kërcënimit ishte Adem Demaçi. Është vështirë të shpjegohet forca morale e një të riu që në periudhën më të errët të komunizmit, në vitet e 50-ta, kur shpërngulja e shqiptarëve në Turqi kishte marrë hov, kur për Kosovën pak kush dinte se ku gjendet, kur depresioni kishte depërtuar në çdo shtëpi, në atë terr të plotë, në ato qeli të ftohta, në duart e hetuesve të egër, me zjarr rinor e mbarëshkonte doktrinën e anatemuar për krijimin e shtetit etnik të shqiptarëve. Morali dhe e drejta shpeshherë arrijnë të ngadhënjëjnë mbi makinerinë represive, që i shkel të drejtat e njeriut. Elita politike dhe intelektuale serbe sot e kësaj dite nuk arrin të kuptojë se ç'ndodhi me ta, si u përmbysën planet e tyre, si erdhën në pozita antagoniste me Evropën, me SHBA-të. Njëri prej tyre shkaku e gjen pikërisht te faktori moral: "Evropa di fare mirë se të gjithë shqiptarët e Kosovës janë të gatshëm të vdesin për Kosovën si dhe të gjithë serbët, të Kosovës dhe gjetiu nuk janë të gatshëm të vdesin për të". Leximi i biografisë politike të Z. Adem Demaçit na kthen në një periudhë kohore të zymtë, të hirtë, të pa shpresë që do të donim sa më parë të harronim. Por, nuk duhet harruar faktin se burgosjet e tija ishin në korrelacion të drejtpërdrejtë me kauzën shqiptare. Hyrja e tij në agjandat e organizatave ndërkombëtare për mbrojtjen e lirisë dhe të drejtave të njeriut, njëherësh ishte edhe afirmim i çështjes së Kosovës në forumet, institucionet ndërkombëtare. Pa vendosmëri për të shkuar deri në fund, këto procese nuk do të zhvilloheshin. Adem Demaçi e kishte atë.

DUKE QENË TË PRANISHËM, KUPTOJMË

Një roman jo vetëm rrëfen, porse na lejon të jemi të pranishëm në një histori, apo në disa ngjarje a në një mendim, dhe duke qenë të pranishëm, kuptojmë

Javier MARIAS

Ndoshta nuk është shumë e mirë-peshuar nga ana e një shkrimtari dhe sidomos e një shkrimtari që shkruan romane, të pohojë se gjithmonë e më shumë i ngjan e çuditshme jo vetëm të shkruajë romane, por edhe gjer t'i lexojë. Jemi mësuar me këtë gjini hibride dhe të epshme që prej të paktën treqind e nëntëdhjetë vjetësh, që kur më 1605 doli pjesa e parë e Kishotit në qytetin tim të lindjes, në Madrid dhe jemi mësuar aq shumë me këtë, sa që e marrim si krejt të natyrshëm gjestin e hapjes së një libri dhe leximin e asaj që nuk na e kanë fshehur se është rremtësi (fiksion), pra diçka që nuk ka ndodhur, që nuk ekziston në realitet.

1.
Filozofi rumun Cioran, që ka vdekur kohët e fundit, shpjegonte se nuk lexonte romane pikërisht për këtë arsye: kur kanë ndodhur kaq shumë gjëra në këtë botë, e si mund të interesohej për gjëra që as nuk kanë bërë vaki; parapëlqente kujtimet, autobiografitë, ditarët, korrespondencat dhe librat e Historisë. Po ta mendojmë dy herë, ndoshta Cioran-i kish të drejtë e ndoshta mbetet i pashpjegueshëm fakti që njerëz të rritur dhe pak a shumë kompetentë janë të gatshëm të kridhen në një rrëfim, për të cilin i paralajmërojnë që në çastin e parë se është i shpikur. Është a më e çuditshme akoma, po të kemi parasysh faktin se në kopertinën e librave tanë tani shfaqet dukshëm emri i autorit, shpesh fotografia e tij dhe një shënim biografik, herë një përkushtim a një thënie, dhe e dimë që të gjitha këto janë sërish të autorit e jo të rrëfyesit. Duke nisur nga një fletë e caktuar, sikur të na qe ngritur sipari i një teatri, bëjmë sikur e harrojmë tërë këtë informacion dhe i vihemi dëgjimit të zërit tjetër – në vetë të parë a të tretë – që pa dyshim e dimë se është zëri i maskuar apo i shkërbyer i autorit. Kush na e jep aftësinë e këtij gjasimi? Përse vazhdojmë të lexojmë romane, t'i vlerësojmë, t'i marrim seriozisht dhe madje t'u japim çmime, në një botë përherë e më pak naive? Duket qartë se burri – ndoshta gruaja më shumë – ka nevojë për një dozë rremtësi, po kështu ka nevojë për imagjinaren, përveç asaj që ndodh e që është reale. Nuk do të guxoja të përdorja shprehje që më ngajnë të dalë kohe e të pakëndshme, siç do qe për shembull që njeriu ka nevojë të "ëndërrojë" apo të "arratiset" (një folje, kjo e fundit, që nuk shihet me sy të mirë që nga vitet '70). Parapëlqej më mirë të them që njeriu ka nevojë të njohë të mundshmen përveç të sigurtës, hipotezat dhe probabilitetet dhe dëshitimet përveç ndodhjeve dhe asaj që mund të qe, përveç asaj që ishte. Kur flitet për jetën e një burri a të një gruaje, kur bëhet bilanci a përmbledhja, kur rrëfëhet biografia apo historia e tij, qoftë në një fjalor, në një enciklopedi a kronikë, apo duke folur mes miqsh, zakonisht përmendet ajo që ky person ka arritur dhe ajo që ka ndodhur vërtet.

2.
Në thelb, të gjithë priremi ta shohim veten në etapat e ndryshme të jetës sonë, si rezultati i asaj që na ka ndodhur dhe i asaj që kemi arritur apo kemi realizuar, sikur vetëm kjo të konfirmonte ekzistencën tonë. Dhe pothuaj përherë harrojmë se jeta e njerëzve nuk është vetëm kjo: çdo trajektore përbëhet edhe nga humbjet tona, nga mosarritjet dhe dëshirat e papërmbushura, nga ajo që ndonjëherë e lëmë mënjanë, apo nuk e zgjedhim, apo nuk e arrijmë, nga



mundësitë e panumërta që në më të shumtën e rasteve nuk arrihen të realizohen – të gjitha përveç njëjës, në fund si ëmbëlsirë, – nga mëdyshjet dhe ëndërrimet tona, nga projektet e dështuara dhe nga dëshirat e rreme apo të vakëta, nga frikët që na paralizuan, nga ajo që e braktisëm a që na braktisi. Në fund të fundit, ne ndoshta pranojmë që ekzistojmë po aq në atë që jemi, sa në atë që nuk kemi qenë, njëlloj si në atë që është e vërtetueshme, e matshme, e kujtueshme, edhe në atë që është më e pasigurt, më e pavendosur dhe e megjullt, ndoshta jemi bërë në të njëjtën masë nga ajo që ishte dhe nga ajo që mund të ishte. Dhe guxoj të mendoj se është pikërisht rremtësia që na e rrëfen këtë, a më mirë të them, ajo që na shërben për të kujtuar këtë dimension, të cilin zakonisht e lëmë mënjanë në çastin kur bëjmë bilancin e shpjegojmë vetveten apo jetën tonë. Dhe ende sot e kësaj dite është romani forma më e përpunuar e rremtësisë, ose kështu e besoj unë.

3.
Në njëfarë mënyre, libri që juria e nderoi me Çmimin Ndërkombëtar Romulo Gallego trajton këtë çështje. Në tekstin e romanit "Nesër në betejë mendo për mua" flitet për gënjeshtërën në kuptimin më të gjerë të fjalës; po citoj një frazë nga libri: "të jetosh me gënjeshtër është e lehtë dhe ca më shumë akoma, ky është kushti i jetës sonë, andaj nuk duhet të na dhembë kaq fort". Aty silltet në vëmendje se të gjithë jetojmë në mënyrë të njëanshme, por vazhdimisht duke gënjyer a duke u gënjyer, duke treguar vetëm një pjesë, duke fshehur pjesën tjetër dhe asnjëherë të njëjtën pjesë personave të ndryshëm që na rrethojnë. E, megjithatë, nuk arrijmë të mësohemi me këtë, siç duket. Dhe kur zbulojmë se diçka nuk qe ashtu siç e jetuam – një dashuri a një miqësi, një situatë politike a një çështje e përbashkët e gjer kombëtare, – na shfaqet në jetën reale ajo dilemë që mund të na torturojë aq shumë dhe që në një pjesë të saj të madhe është territori i fiksjonit: tani nuk e dimë se si ishte vërtet ajo që ngjante e sigurt dhe nuk e dimë se si e

jetuam atë që jetuam, nëse ishte ajo që besonim ndërsa qemë të gënjyer, apo nëse duhet ta hedhim në thesin pa fund të imagjinare dhe të rrekemi t'i rindërtojmë hapat tanë në dritën e zbulimit të tanishëm e të zhgënjimit. Biografia më e plotë nuk përbëhet veçse nga fragmente të çrregullta e copëza të çngjyrosura, gjer dhe ajo e jona. Mendojmë se mund ta rrëfejme jetën tonë në mënyrë pak a shumë të arsyeshme e të plotë, por kur nisim ta bëjmë, i biem më të se është e mbushur me zona të errëta, me episode të pashpjeguara dhe të pashpjegueshme, me alternativa të pazgjedhura, me elemente që nuk dimë se përse lidhin të tjerët. Gënjeshtër e zbulimi i saj na bëjnë të shohim se edhe e shkuara është e pasigurt e rrëshqitëse, se as ajo që ngjan e fortë dhe nën strehë brenda saj nuk është përgjithmonë, se ajo që ishte, është gjithashtu pjesë përbërëse e asaj që nuk ishte, dhe se ajo që nuk ishte ende mund të jetë.


4.
Gjinia e romanit e jep këtë, ose e nënvizon këtë, ose e sjell në kujtesën dhe në ndërgjegjen tonë, me këtë shpjegohet fakti që romani nuk ka vdekur, ndonëse e kanë paralajmëruar shumë herë shuarjen e tij. Andaj, ndoshta, nuk është e drejtë ajo që thashë në fillim se romani nuk rrëfen atë që ka ndodhur. Ndoshta në të vërtetë romanet ndodhin nga fakti që ekzistojnë e lexohen dhe, po ta shohësh me kujdes, pas kaq shumë kohësh është më real e i vërtetë Don Kishoti se bashkëkohësit e tij historikë të Spanjës së shek. XVII; Franca e fillimishtekullit të shkuar, pa dyshim, shfaqet më e vërtetë dhe më e "vizitueshme" në veprën "Në kërkim të kohës së humbur"; dhe përfytyroj që edhe për ju imazhi më autentik i vendit tuaj është i përzier me faqet e shkruara nga don Romulo Gallego. Një roman jo vetëm rrëfen, porse na lejon të jemi të pranishëm në një histori, apo në disa ngjarje a në një mendim, dhe duke qenë të pranishëm, kuptojmë. T'i dish të gjitha këto, – të duash t'i besosh më saktë, – shpesh nuk rezulton e mjaftueshme për shkrimtarin, ndërsa është duke shkruar. Ka çaste kur ngre sytë nga makina e shkrimit dhe

habitem me botën nga buthtoj, dhe pyes veten se si, duke qenë i rritur, harxhoj tërë këto orë e mund për diçka pa të cilën bota mund të jetoj për bukur, madje edhe unë vetë; se si vihem të rrëfej një histori që unë vetë e vërtetoj ndërsa e ndërtoj, se si mund të kaloj një pjesë të jetës sime i zhytur në fiksjon, duke bërë të ndodhin gjëra që nuk ndodhin, me idenë ekstravagante e mendjemadhe dhe kjo mund t'iu interesojë të tjerëve një ditë. Njëlloj siç e përcaktoi aktivitetin letrar romancieri, eseisti e poeti Robert Louis Stevenson, mund të jem "duke luajtur në shtëpi, si një fëmijë, me letër".

5.
Çdo shkrimtar është edhe lexues dhe ka për të qenë gjithmonë i tillë: kemi lexuar shumë më tepër libra nga sa mund të shkruajmë ndonjëherë, dhe e dimë se ky interes, ky pasion, është i mundur sepse e kemi provuar me qindra herë; dhe se me raste e kuptojmë më mirë botën a veten tonë nëpërmjet këtyre figurave fantazmore që mbushin romanet, apo nëpërmjet përsiatjeve të bëra nga një zë, që nuk duket të jetë i tëri as i autorit e as i rrëfimitarit, domethënë i askujt tërësisht. Vërtetojmë edhe se ndoshta shkruajmë ngaqë disa gjëra mund t'i mendojmë vetëm ndërkohë që i bëjmë, ndonëse kur më pyesin, dhe kjo shpesh, se përse shkruaj, parapëlqej të përgjigjem se ngaqë nuk dua të kem shef mbi kokë apo të ngrihem herët nga gjumi. E vërteta është që të marrësh një çmim si Romulo Gallego, supozon, përveç faktit që është një nder dhe një gëzim i madh, një lloj përkujtimi për të ardhmen. Kur të shkruaj romanin tim të ardhshëm dhe kur të ngre sytë nga imagjinaria, në të cilën kam qëndruar zhytur për një kohë të gjatë, do kem mundësi të mendoj se, ndryshe nga parashikimet dhe parandjenjat e mia, dikur, shumë larg prej vendit tim, ishin disa lexues bujarë, të cilët jo vetëm ndajnë me mua gjuhën me të cilën shprehem, porse arrihen të interesohen për atë që shpika dhe që e trupëzova në grumbullin e pafundmë të asaj, që në të njëjtën kohë nuk ndodh dhe ndodh, apo njëlloj, të asaj që mundi dhe mund të jetë.

KRIMET MBI ARTIN

Lakmia e hajdutëve nuk joshet vetëm nga veprat e Rembrandit dhe Pikasos. Menjëherë pas pushtimit të Bagdadit, në vitin 2003, plaçkitësit grabitën Muzeun Kombëtar të Irakut, duke marrë prej andej një koleksion të jashtëzakonshëm antikash të Mesopotamisë.



Joshua KNELMAN

Shumë prej këtyre punimeve, ku përfshihen edhe koka e një gruaje sumere e gdhendur në mermer, mbi 5000-vjeçare dhe me një vlerë të paçmuar, ishin zhdukur për t'u shfaqur më vonë në pragun e derës së ndonjë koleksionisti privat, muze dhe dyqane antikuarësh. Disa vepra artizanale të vogla, por shumë të vlefshme mbërritën në Muzeun Mbretëror të Ontarios në Toronto. Një fenomen i pazakontë për skenën e krimeve artistike në Kanada do të ndodhte në janar të vitit 2004: Pesë statuja prej fildishi të shek.18-të, të gdhendura nga artizani David le Marchand, të cilat i përkisnin manjatis të medias, Ken Thomson, u vodhën nga Galeria e Artit të Ontarios në Toronto.

Të tjera bëma

Hajdutët thjesht ngritën kasën prej xhami ku ruheshin statujat me vlerë 1.5 milionë dollarë dhe u larguan. Një kompani sigurimesh ofroi një shpërblim prej 150.000 dollarë dhe dy javë më vonë një avokat në rolin e ndërmjetësit ia riktheu statujat pronarit të tyre.

E gjitha kjo ngjan me një fund pa dhimbje si për galerinë ashtu edhe për Thomson, i cili ndjehej aq i çliruar kur policia i riktheu statujat e tij të fildishta sa i vendosi ato me përkujdesje në krevatin e tij. "Ato kishin një domethënie të madhe për mua", do të shprehë Thomson asokohe. "Vetëm ata që janë koleksionistë dhe kanë një afinitet të veçantë me gjërat që zotërojnë dhe bëhen pjesë e tyre mund ta kuptojnë gjendjen në të cilën ndodheshin". Por aktualisht, a konsiderohen paratë e shpërblimit të marra nga hajdutët si një haraç, i cili i lejon ata që t'i shmangen drejtësisë duke vjedhur përsëri? Një gjë e tillë nuk do të habiste aspak ata që kuptojnë

sofistikimin e hajdutëve të klasit si dhe dëshirën pothuajse patologjike të galerive dhe koleksionistëve për të siguruar kthimin mbropst të zotërimeve të tyre të çmuara.

Luftërat kanë qenë gjithnjë në favor të hajdutëve të veprave të artit. Në një prej listave të Czeglédit vihet re rruga e gjatë e zhvendosjes së qindra pikturave të Matise, Monet, Chagall, Rubens, etj. nga Evropa drejt destinacioneve transoqeanike si Havana, Nju Jorku, Uashingtoni dhe Otava, gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ajo i kishte gjetur dokumentat ndërsa kryente një kërkim prejardhjeje për llogari të një klienti në Arkivat Kombëtare të Uashingtonit. "Mënyra më e mirë për të shkatërruar një kulturë është duke i vjedhur shpirtin e saj", thotë ajo. "Nazistët e kishin kuptuar mjaft mirë këtë gjë".

Më vonë, Czeglédi kaloi ditë të tëra duke gurmuar pronarët e ligjshëm të veprave të artit, të cilat u ishin shitur koleksionistëve të paskrupullt nga nazistët. Ajo arriti gjithashtu të katalogonte qindra vepra që ishin zhdukur gjatë periudhës së pushtimit të Polonisë nga gjermanët. "Mes tyre ka vepra të Rembrandit dhe mjeshtërive të mëdhenj polakë, të cilat unë nuk i kisha parë ndonjëherë më parë". Një pjesë e koleksionit artistik personal të Hitlerit, ku bën pjesë edhe një portret i Benito Musolinit, duzina me portrete të vetë Hitlerit si dhe kartolinat e tij të firmosura të Krishtlindjeve, janë shfaqur gjithashtu në Kanada. Dy vite më parë, një grua nga Ontario, shkoi tek Czeglédi dhe i tha asaj se në përfundim të Luftës së Dytë Botërore, bashkëshorti i saj, asokohe një ushtar britanik, ishte dërguar në Berlin si pjesë e një brigade pararojë. Rusët kishin arritur në qytet të parët dhe nuk e kishin kursyer atë nga plaçkitja dhe djegia. Në kohën kur oficeri britanik mbërriti në kryeqytetin gjerman, ai e gjeti Kancelarinë e Rajhut krejtësisht të ngjashme me një kosh

plehrash. Duke u endur nëpër dhomat e ndryshme të shtabit të përgjithshëm të Hitlerit, ai gjeti një pjesë të koleksionit privat të Fyhrerit, të fshehur mes një pingu hedhurinash në dysheme. Atëherë ushtari bëri pikërisht të njëjtën gjë që do të kishte bërë edhe Hitleri, ai e vodhi koleksionin. Ish-ushtaraku më vonë do të emigronte drejt Kanadasë, ku kishte marrë me vete edhe koleksionin. Tanimë bashkëshortja e tij kërkonte që ta hiqte qafe. Czeglédi pasi e kishte shëtitur koleksionin në të gjitha muzetë më të mëdha të vendit, vendosi që t'ia dërgonte atë një galeri në Bavari, që është edhe rajoni nga ku e ka prejardhjen koleksioni.

Avokatët e mbrojtjes

Gjatë një dreke në bistrionë franceze vetëm pak metra larg Parkut Avenue në Nju Jork, Lorenc Kaye dhe partneri i tij, Hauard Spiegler, dy nga avokatët më të njohur në botë për sa i përket mbrojtjes së veprave të artit, bisedonin mes tyre për të gjetur mënyrën se si koleksionet e veprave të artit të periudhës naziste, do t'u ktheheshin pronarëve të tyre të ligjshëm. Së fundmi Kaye kishte pranuar të merrte përsipër një çështje ku përfshiheshin më shumë se 1.300 vepra artistike, më së shumti punime të Mjeshtërive të Vjetër Holandezë, nën pronësinë e Zhak Goudstikker, një koleksionist i pasionuar, i cili kishte mundur të arratisë nga Holanda e pushtuar nga gjermanët në vitin 1940, pa mundur të merrte me vete koleksionin e tij.

Kaye kishte arritur disa suksese jashtë: Muzeu i Izraelit në Jeruzalem kishte pranuar të kthente një vizatim në karbon nga Edgar Degas, "Katër Valltare Lakurique duke pushuar" (1898). Ndërkohë që Muzeu i Arteve të Bukura në Montreal të Kanadasë kishte qenë më pak dobipurës. Muzeu

kishte pranuar që të kthente një nga pikturat e Goudstikkerit, "Adhurimi i Eneas", një pikturë e shek.17-të nga Çarls Le Brun, vetëm nëse do të provohej pronësia e tij. Përpjekjet për kthimin e pikturave si dhe masat ligjore në Shtetet e Bashkuara janë ndihmuar edhe nga vendimet e gjykatave. Kaye citon si një precedent të rëndësishëm dënimin në vitin 2002 të Frederick Schultz, një matrapaz nga Madison Avenue, i cili tregtonte relike të çmuara egjiptiane. Schultz zotëronte një numër veprash të rralla dhe mjaft të çmueshme, ku përfshiheshin edhe koka e Faraonit Amenhotep III, të cilën ai e kishte shitur për 1.4 milion dollarë. Skulptura ishte gërmuar nga plaçkitësit e varreve dhe ishte transportuar ilegalisht drejt Shteteve të Bashkuara. Schultz u dënua me tre vjet burgim.

Pavarësisht eksperiencës së Kaye me pikturat e Le Brun, nga Kanadaja vijnë disa sinjale inkurajuese. Fakti që asnjë prej muzeve kanadeze nuk kishte pranuar të blejë vepra nga koleksioni privat i Hitlerit është mjaft domethënëse. Duhet kujtuar gjithashtu se simpoziumi i parë mbi Artin e Humbur gjatë Luftës së Dytë Botërore, është zhvilluar në Galerinë Kombëtare të Otavas në nëntor të vitit 2001. Sikurse shumë institucione të tjera në Kanada dhe Shtetet e Bashkuara, Galeria Kombëtare ka hartuar një listë në faqen e saj zyrtare të Internetit ku nënvizohen veprat më të diskutuara brenda koleksioneve të saj. Në këtë listë përfshihen 100 piktura, skulptura dhe vizatime, të cilat kanë mangësi në informacionin që shoqëron prejardhjen e tyre gjatë periudhës nga 1933 deri në vitin 1945.

Ndryshimi i mentalitetit

Majkëll Pantazzi, muratori i Koleksioneve Evropiane dhe Amerikane, shprehet se Galeria Kombëtare ishte institucioni i parë në Kanada që pranoi të kthejë në mënyrë vullnetare veprat e grabitura. Mes veprave më të njohura ajo ka kthyer tek pronari i ligjshëm, "Salloni i Madam Aron" (1904), një pikturë nga artisti francez Édouard Vuillard, e cila ishte vjedhur në Francë gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe ishte blerë nga galeria në vitin 1956. Në një tjetër rast kthimi të suksesshëm përfshihet një statujë kineze e një shenjtori budist. Ajo iu kthye qeverisë kineze në vitin 2001 gjatë një ceremonie zyrtare të zhvilluar në Pekin.

Por a kanë mësuar muzetë diçka nga historia? A kanë bërë ata gjithçka kanë në dorë për të parandaluar që muret e tyre të bëhen streha e veprave të vjedhura të artit? Rahimi është i mendimit se muzetë dhe galeritë duhet të refuzojnë të gjitha punimet që duken sadopak të dyshimta. Një veprim i tillë do të thotë të braktiset praktika e "strehës së mirë", e cila i lejon një institucioni të blejë një vepër arti me kredenciale të dyshimta në mënyrë që të parandalojë dëmtimin apo shkatërrimin e saj të mëtejshëm. "Sido që ta shohim, kjo nuk është një gjë e mirë", thotë ai. "Ne e kuptojmë që është false dhe nëse nuk është e tillë atëherë pa dyshim ajo është përvetësuar në mënyrë të paligjshme". Por, edhe nëse muzetë dhe galeritë do të pastrojnë sjelljen e tyre, tërheqja ndaj veprave të vjedhura mbetet e fortë mes koleksionistëve privatë. Czeglédi e konsideron këtë si një bashkëveprim të egoizmit, pasardhës dhe pushtetit. "Koleksionimi i veprave artistike", shpjegon ajo, "mund të kthehet në një fiksim. Këta koleksionistë dhe tregtarë veprojnë si një kult". Kjo shpjegon faktin se si mundet që një pikturë aq e reklamizuar, e cila nuk ka asnjë mundësi rishitjeje, sikurse "Britma", arrin gjithsesi të vidhet. "Nëse zotëron diçka që është e veçantë, edhe ti ndjehesh i veçantë", shprehet Czeglédi. "Ky është pushtet", thotë ajo. /Përkthyer nga Entela Bajraktari/

NUMRI I ARDHSHEM ME 20 QERSHOR

HEJZA

10 QERSHOR, 2023

Kryeredaktor i Hejzës: **Avni Halimi** (avni65halimi@gmail.com)

Editon Produksioni **TAKAT STUDIOS**

Drejtor: **Genc Halimi** (genc@takat.tv)

Rruga e Kaçanikut nr. 208, Shkup, 1000